

MENELAOS LUDEMIS

BIBLIOTEKA

8H-31

L 92

# RETË DENDËSOHEN

ROMAN



84-31  
L 92

# Menelaos Ludemis

## RETË DENDËSOHEN

*Roman*

*E përktheu: Spiro Mitrushi*



Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja e Parë"  
Tiranë, 1999

**Redaktor :**  
**Korab Hoxha**

**Përgatiti për shtyp:**  
**Gaqo Bushaka**

**Art.grafik:**  
**J. Marjanaku**

**Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja e Parë"**  
**Botues: Përparim Xhixha**

---

**Adresa: Rr. "Asim Vokshi" Vila 25**  
**Tel/Fax: + + 355 42 563-97**

## ROMANI "RETË DENDËSOHEN" DHE AUTORI I TIJ MENELAOS LUDEMIS

### PARATHENIE

*"Unë u largova. Humba fare midis pemëve të rrugës. Ecja duke kërcitur këmbët mbi fletët e rrëzuara të pemëve. Mbeta i vetëm si dallëndyshja, që nuk kishte arritur të fluturonte së bashku me motrat e saj dhe të cilën e kishe zënë dimri. Edhe pak dhe do të sundonte nata. Unë dridhesha, si të isha qullur në mes të shiut. Dridhesha dhe ecja përpara ..."*

*Kështu e mbyll romanin e tij Menelaos Ludemis duke paralajmëruar simbolikisht edhe përmes titullit stuhinë që do të shpërthente si pasojë e zemërimit popullor. Ludemis ish një nga ata që do t'i paraprinte kësaj stuhie si luftëtar dhe do ta pàsqyronte atë si krijues.*

*Vepra e tij e parë, e cila e shqoi atë si shkrimtar, është përmbledhja me tregime "Anijet nuk kanë zbritur". Më pas nis rruga e tij e gjerë krijuese. Në periudhën e Rezistencës, të luftës heroike të popullit grek kundër pushtuesve, Ludemis e bashkoi zërin e tij të protestës me atë të luftëtarëve të lirisë. Në këtë kohë ai shkruan vjersha e këngë si "Këngë për lirinë", të cilat pushtonin zemrat dhe mendjet e njerëzve nëpër qytete, fusha e male dhe i frymëzonin për luftë. Po ashtu shkruan vepra të tilla si vëllimet*

- *Pse ia ke vënë samarin, o gjysh?*
- *Ha! Po ti pse mban xhaketë?*
- *Që të mos ftohem.*
- *Ha-ha-! Ja dhe ai njëlloj ... Ai është plak ...*

*Gomari më vështroi disi shtrembër, i fyer dhe vazhdoi rrugën e vet. Plaku diçka i pëshpëriti në vesh, siç dukej, duke u mburrur, dhe gomari eci krenar."*

*Menelaos Ludemis gjatë gjithë jetës së tij nuk e reshti punën dhe luftën si qytetar dhe shkrimtar. Do të qenë pikërisht aspiratat e tij për liri dhe drejtësi shoqërore, si dhe dashuria për t'iu përkushtuar njerëzve të thjeshtë të popullit, njëkohësisht duke i gdhendur artistikisht, ato që do ta bënin emrin dhe veprën e Menelaos Ludemis të njohur në mbarë Greqinë.*

***Korab Hoxha***

## **Pjesa e parë**

## KAPITULLI I PARË

E ftuan njëherë shiun në dasmë, por ai nuk pranoi. «Doni të talleni. — tha ai. — Ç'i duhet breshkës te nallbani? Jo, miqtë e mi, nuk do të vij! Më lini këtu, se kam punët e mia boll». «Ç'punë ke ti, o shtrigan?» — e pyetën atë. «Ha, ha, ha! Ç'punë? Do të shkoj të përmyt të korrat atje poshtë!»

Ashtu si tha, ashtu dhe bëri. Vajti, nuhali tokën dhe për pak sa nuk e mbushi me llucë — ashtu si i pëlqeu atij. Pastaj, papritur u largua dhe u krodh brenda në retë. Edhe ato, retë, se mos janë më të mira. E mbajnë veten për pëllumbesha të pafajshme, sikur janë të lehta si push, kurse përbrenda ziejnë gjithë të zezat e botës. Sepse janë pikërisht ato —

dhe askush tjetër — që sollën gjithë këtë fatkeqësi. Shëtiten ato përmbi kënetë si buaj të dehur, e shprazën gjithë ujin që mbartnin me vete, dhe pastaj, të lehtësuara, u kthyen tek era. «Tani merrna, ja ku na ke!» Dhe ajo i rrëmbeu si leckë dhe i çoi tutje.

Shiu binte mbi gropa dhe ugare, mbi kodra dhe lugina, mbi arat e mbushura plot. Binte atje, ku mezi lëviznin qerret që tërhiqnin buajt, dhe mbi ballin e djersitur të bujqve. Atje ku lartësoheshin drejt qiellit, si të ishin minare, duajt e drithrave dhe kuajt ngrinin shtëllunga pluhuri...

Ai ra si një hajdut, pa u ndier, si një qen i tërbuar, që mezi pret të të kapë nga prapa.

Ne as nuk e vumë re si na zuri kjo e keqe. Gjer në çastin e fundit, qielli i lartë, krenar, ishte i kaltër dhe krejtësisht i pastër. Ai ngrihej sikur të ishte një parashutë e rrumbullakët madhështore, e fryrë nga poshtë, mbi kryet tona. Dhe vetëm njëra, e vetmja re e shndritshme, që i ngjante një vocrraku qurrash, u kap pas majës së malit fqinjë dhe po punonte atje. Nuk e di a mori pjesë ky vocrrak në fatkeqësi, apo fatkeqësia ishte e madhe.

Në mesin e luginës. të mbytur nga shiu, ndodheshim ne, një grup i madh fshatarësh. Ne ishim trembëdhjetë; katër pleq, tre çunakë, pesë djem dhe padroni ynë. Petër-biska, që në gjuhën tonë donte të thoshte Petër-derri. Ditë të tëra kishim ne që piqeshim në diell, duke djersitur për bukën tonë — bukën e ashpër prej elbi. Ne bënim tulla. Tulla për shtëpitë e larta, që donin të ishin edhe më të larta.

Kisha dy muaj që punoja atje. Unë isha një fëmijë i vockël, i imët, por kjo nuk e shqetësonte pa-



dronin tim. Atij i duheshin tulla. Tulla të cilat ktheheshin në dhrahmi<sup>1)</sup>) për të dhe në rrudha për ne.

Punë jo për t'u pasur zili. E lodhshme. Po ç'të bënim?

E ndieja veten ngushtë, prandaj hyra në këtë punë dhe u lidha me botën e baltës dhe hiqja këto tortura!

Më parë unë merresha me tregti. Blija një shportë të madhe me fruta, e hidhja në shpinë dhe për dy orë ecja drejt fshatit Vertekop, në stacion, dhe atje ua shitja pasagjerëve të trenit. Por pastaj ndodhën ngjarje të dhimbshme dhe e lashë, sepse me të u përzjenë dhembja dhe gjaku.

Dhe ja tani... por, më falni. Unë nuk mund të vazhdoj, pa ju treguar për ato ngjarje të dhimbshme.

Ja se si ndodhi. Atje, në Vertekop, puna më shkonte mbarë. Tani Vertekopit ia kanë ndërruar emrin në Skidra.

Ditë pas dite, shportë pas shporte, — dhe një mëngjes të bukur unë u gdhiva pasanik. Sikur t'i kishit parë ato para! Shtatëdhjetë dhrahmi rrumbullak! As edhe një monedhë më pak! Një pasuri e vërtetë. I vështron dhe sytë të dridhen! Si e kisha grumbulluar atë pasuri? O, kjo është një odise e vërtetë prej mundimesh të vockla feminare; kapërcimi i gardhit të stacionit, grindjet me blerësit e shturur, gjurmimet dhe sharjet e kalimtarëve, gurët pas shpine dhe policët që s'më linin rehat... Dhe më e tmerrshmja — pëllëmbët dhe gjithfarë poshtërsish nga bashkëzanatçinjtë e mi, prej të cilëve

---

1) Monedhë.

më i vogli ishte dy herë më i madh se unë. Po si munda atëherë ta grumbulloja atë thesar? Ja se si: unë mora një ndihmës. Një ndihmës të ndershëm. Ia lija atij grumbullin e frutave, kurse vetë merrja dy shporta gjysmëkilëshe, jo më tepër, dhe futesha nëpër vagonë... Po pse të tregoj për ndihmësin? Pse të provoj përsëri atë hidhërim, pasi kanë kaluar kaq vjet? Ç'të bësh... Po e provoj ta pi këtë helm.

Atë e quanin Shyqyri. Ishte një turk dhjetëvjeçar, që më respektonte dhe më çmonte mua. I bindur dhe besnik. I ndershëm, por edhe pak i druajtur. Ne u njohëm bashkë njëherë në mesditë, kur ai vërtitej stacionit në kërkim të një letre të hollë, letër cigari për të gjyshen, e cila ishte duhanxhie e madhe, kurse unë në kërkim të ndonjë frute të hedhur për të shuar urinë. Ai i përkiste një prej atyre-familjeve të shumta turke, të cilat kishin shumë muaj që rrinin mes fushës, duke pritur trenin, që duhej të vinte për t'i çuar në atdhe.

Atje, në Vertekop, ndodhnin takime të çuditshme. Vagonë të tërë me grekë dhe greke shkonin në fushat turke të Karaxhovës, kurse vagonë me turq dhe turkesha — në brigjet e Anadollit. Turku kishte zili grekun, kurse greku — turkun.

— Ju vaftë mbarë! Veçse mos e mundoni shumë tokën tonë...

Dhe vinin duart në sytë e përлотur. Kurse trenat fërshëllenin, fërshëllenin dhe suleshin përpara si të marrosur, duke marrë me vete zemrat e njerëzve të mbushura me hidhërim. Thua se ishin pemë pa shpirt, të shkullura pa mëshirë në një vend për t'i mbjellë në një vend tjetër, në një tokë të huaj, të hidhur.

— Ne nuk kemi faj, arkadash<sup>1)</sup>, ne nuk e deshëm këtë.

— Dhe ne nuk e duam këtë, o vëlla Qamil! Na, merre këtë shami... Merre dhe lidhe si një shami në arën me misër.

— Ah! Dhe ti, o Vangjel... na merre këtë feston, vare këtë në gardh për të trembur sorrat.

— Kuji i ra ndër mend t'i bënte këto punë? Njeri i pashpirt!

— Bilmen<sup>2)</sup>.

... Dhe prej syve të tyre rridhnin lot të nxehtë dhe nga lokomotivat — ujë i nxehtë. Dhe lokomotiva nxirrte re avulli, që ngjiteshin drejt reve qiellore.

Familja e Shyqyriut ishte rregulluar në një çadër dhe priste me brengë, kur të vinte treni dhe t'i merrte. Një muaj të tërë kishin që rrinin mbi sënduket e përgatitur për rrugë, kurse nisja vazhdonte të shtyhej. Gjyshes i qenë skuqur sytë. Fajtorë për këtë ishte brenga, fajtor ishte edhe tymi. Po fajtorë janë edhe uria dhe varfëria. Në shtëpi nuk kishte burra dhe gjithçka i drejtonin dy duart e thara të nënës. Kurse tani s'kishin as shtëpi.

Shyqyriu kishte një respekt jashtëzakonisht të madh për tregtinë time, që nga dita që unë e nisa këtë zanat në stacion.

Ai rrinte atje, përkundrajt shportës sime me «inxhi», dhe i vështronte ato, kurse nëpër buzët e tij të trasha dhe jo të pashme rridhnin jargë. Dhe ato lëpiheshin. Sytë e tij hanin, kurse buzët lëpiheshin.

---

1) Arkadash — shok (turq). Këtu dhe më tutje shënimet janë të përkthyesit.

2) Bilmen — nuk e di (turq).

Atëherë unë, tregtari, por që nuk veproja si një tregtar i vërtetë, meqenëse më vinte keq për të, një ditë, i thashë:

— Hajde këtu, o djalë. Na, merre këtë, haje...

Unë mora frutin më të madh dhe ia zgjata.

— Jo këtë! — Dhe nuk e merr, por zgjat dorën e zezë dhe zgjedh atë më të voglën dhe më të papjekurën. — Ja, këtë, po! — E fut me të shpejtë nën bluzë dhe më falënderon.

Po ç'është kështu? Unë vështroj veten dhe më vjen turp. Shyqyriu, si zotëri serioz, shkon te gjyshja e vet.

Ditën tjetër ai vjen përsëri tek unë, pisë i zi, dhe me një pamje të vendosur më pyet:

— A do që unë të jem shërbëtori yt? — Dhe skuqet.

I vështrova duart — ishin të pista, por kjo e keqe mund të ndreqej. E vështrova në sy — ata tregonin ndershmëri dhe besnikëri. Ishte i aftë për çdo punë që kërkon ndershmëri.

— Mirë... Si të quajnë?... Mirë, Shyqyri... Vetëm mos e përmend më atë fjalën shërbëtor. Në qoftë se do, hajde të tregtojmë së bashku, mirë? Kurse tani ulu të hamë. Nesër do të flasim për këtë. Bujrum, Shyqyri!

Ne ndamë një copë bukë të zezë, që kisha me vete, dhe frutat e pjekura. Me këtë rast unë shko-va te shitësja e zarzavateve me mustaqe, hallë Katerina, dhe bleva një domate dërdënge.

Hëngrëm një drekë mbretërore. Pastaj morëm nga një kunj shkrepëse dhe nisëm të pastronim dhëmbët, njëlloj siç bënte zoti Avgerinos, pasaniku i fshatit (unë s'e honepsja, fare atë), që hante gjatë

ditës aq herë, sa i deshte e bardha zemër — dhe i deshte shumë.

Kur nga kruarja e gjatë e dhëmbëve nisi të na dilte gjak, ne shkuaam te çezma e stacionit. Atje e mbushëm barkun me ujë dhe barku na u fry e na u bë si i zotit Avgerinos, pastaj shkuaam nën një hije për të pushuar. Po ne zumë të bisedonim dhe harruam gjithëcka. Biseduam për gjithfarë gjërash. Për tregtinë, për kostumet, për trenat... Dhe për varkat, për ca varka prej hekuri, që quhen vaporë, në të cilët mund të futësh një fshat të tërë.

— Po... megjithatë, çfarë është varka?

— Varka?... A keni atje tej ju, Shyqyri, lugje të punuara prej druri, ku lajnë rrobat?... Keni?

— Ëhë...

— Epo, ja kështu, merr një nga ato dhe bëj një magje të madhe sa një shtëpi... Vër në të një tub që të fërshellejë... Dhe e ke gati anijen.

— Aaaa! Po kush do ta tërheqë?

— Këtu është e gjithë puna — askush nuk e tërheq! Ecën me tym, Lëshon tym dhe ecën.

— Domethënë, digjet!...

— Hëëë... jo, jo. Po diçka i ndezin në zorrë dhe e inatosin. Kështu dhe... ecën.

— A... dhe ku shkon ajo varka? Rrugës?

— Fjalë është ajo që thua! Nuk shkon rrugës, po lundron nëpër det.

— Heu, po kjo punë kështu?

— Deti? Gjej, Shyqyri, një kënetë të madhe, të madhe... që nuk ka fund. Mbushe atë me ujë të kaltër; po, uji duhet të jetë i kaltër...

— Pastaj?

— Pastaj, Shyqyri, do të duhet kripë. Dhjetë

thasë, jo më pak. Morre atë me grushte dhe hidhe, hidhe, hidhe.

— E pastaj?

— Pastaj, ja ku e ke dhe detin. Por me detin duhet sjellë me kujdes. Nganjëherë, papritur e pakujtuar, ai fryhet dhe i mbyt varkat!

— Oh!

— Për besë!

— Oh! Ç'po thua kështu!

— Po, po. Shyqyri...

Ne heshtëm dhe ramë në mendime. Fillimisht për atë djall uji, që papritur e pakujtuar zemërohet, pastaj për magjen metalike, vaporin, i cili, sikur të ishte ndonjë përbindësh, shtrihet mbi ujë dhe tymos llullën.

— Ja... do të shkoni me të në fshatin tim. Shyqyri.

— Po si quhet ai?

— Fshati im? Engeri... Stamboll.

— Atje thonë se ka shumë dyqane, vërtet?

— Ëhë! Gjithandej dyqane!

— Edhe atje ka djathë, sallam, pastërma, bukë të bardhë?

— Po... po... po. Sa të duash, sa të duash. — Shyqyriut i lëshoi goja lëng. Unë e zura për dorë.

— More... Shyqyri?

— Ë?

— Do të të lutem për diçka. Atje te ne, në shtëpi, në dritare do të gjesh një gjinkallë floriri.

— Gjinkallë?

— Po. Ajo është e varur në një fill po... bashkë me qerrën e saj — me një kuti shkrepësesh. Ne nguteshim shumë kur u nisëm, dhe unë harrëva ta

merrja. Të lutem, Shyqyri, çele për mua, të lutem, Ajo besoj do të jetë mërzitur që ka kaq kohë që rri e kyçur... Mirë, Shyqyri?

— Mirë, do ta bëj.

— Falemnderit.

Në atë çast, nga një cep i fshehur doli plaka. Çfarë po kërkonte ajo? Ja ku u përkul dhe ngriti nga toka bishta cigaresh. Ajo kishte një veshje të çuditshme... shallvare, të cilat i mbajnë gratë atje larg, në Anadoll, dhe një shami të zezë të lëshuar mbi sy, në të cilët kishte ngrirë vuajtja. Ajo ecte duke u penguar nëpër gurët dhe trastat që kishin lëshuar të ikurit në mes të rrugës. Askush nuk i kushtonte vëmendje. Burrat ngrinin supet dhe thithnin cigaret e tyre. Shyqyriu nuk më kishte treguar gjë as për shprehitë e gjyshes së vet, as se si vishej ajo, por unë e njoha menjëherë.

— Shyqyri, po të kërkojnë.

Turku u kthye. Vështrimi i munduar i plakës ndriti, në të shkëlqeu gëzimi.

— Kurban, — thotë ajo dhe e shtrëngon djalin në gjirin e saj tërë kocka. — Zemra ime, jeta ime! (Sa thellë dinë të duan këto plaka fatkeqe...)

Shyqyriu, me duart e tij të pista, kapet pas shallvareve të saj, fshihet në to, si të ishte zog, i cili më së fundi mundi të gjente një strehë.

Pastaj ai tregoi me dorë nga unë.


— Ja, shiko... e sheh?

— Kush është ai, zemra ime?

— Padroni im.

— Vërtet? — dhe plaka më shikoi me vëmendje.

— Nuk jam fare padron, ne jemi shokë.



— Kjo është një gjë e mirë. — u qetësua plaka. Ajo do të më përkëdhelë, po kujtohet për gishtërinjtë e saj të zverdhur dhe bën mënjanë e hutuar. Vetëm se më shikon me përkëdheli. Por kjo përkëdheli për mua është edhe më e shtrenjtë. Plaka përkëdhel me gishtërinj kaçurrelat e dendur në kokën e fëmijës.

— Shkojmë. Shyqyri. Nëna është bërë merak. Ajo edhe vetë dridhej e tëra. Kurse për mua s'kishte kush të shqetësohej. Ah, sikur të gjendej qoftë edhe një njeri i vetëm që të shqetësohej për mua! Sa keq është ndërtuar jeta! Të mos kesh njeri fare!... Asnjëri që të shqetësohet për ty...

Djaloshi u kap fort pas shallvareve të plakës dhe dy krijesat u shkrinë në një. Ata nuk mund t'i ndaje as me thikë — do të plagosje si njërin, ashtu dhe tjetrin. Sa mirë është kur të duan kështu dhe të mbajnë kështu për dore! Shyqyriu tani ishte më i pasuri nga të gjithë; ai lundronte në këtë dashuri të pakufishme. Ai nuk merakosej që duart e gjyshes qenë të verdhë. Ai ishte i kënaqur që ato e mbanin fort, donte që ta shtrëngonin ato duar.

Pas pak, plaka dhe Shyqyriu u bënë gati për rrugë.

— Jarëjn!... — tha turku dhe më zgjati doçkën e tij të fëlliqur. — Mirupafshim nesër...

— Mirupafshim nesër. Shyqyri. Mbage fjalën.

---

1) Jarëjn — mirupafshim (turq.).



## KAPITULLI I DYTË

Ai e mbajti fjalën. Dhe që nga ajo ditë unë pata një shok pune, shok bisede, me të cilin ndaja kafshatën e gojës. Shyqyriu ishte arkadash i vërtetë, mik dhe vëlla — unë i dhashë atij krodhën, kurse ai më dha shpirtin e tij. Mbrëmjeve ne numëronim fitimin, fërshëllenim si pasanikët, të cilët, pasi kanë ngrënë e kanë pirë, nuk kanë ndonjë kundërshtim të argëtohen me muzikë.

Shyqyriu i jepte nënës së vet gjithë të hollat e fituara, kurse prej saj merrte me bollëk urime, që më binin në pjesë edhe mua. Sytë e gjyshes së tij nuk u bënë edhe aq të kuq. Njëherë, për ta gëzuar

atë, ne i blemë duhan dhe i përgatitëm një cigare të madhe.

Po, megjithëse ne ishim dorëlëshuar me të tjerët, me stomakët tanë mbetëm kopracë të pamëshirshëm. Fruta aguridhe dhe bukë të ashpër, bukë të ashpër dhe domate të vrara! Ja, ky ishte ushqimi ynë. Përndryshe, a s'më thoni, a mund të ngrihesha unë atë mëngjes me xhepat mbushur dënga? Dhe unë kisha shumë për të bërë atë ditë me këtë xhep të mbushur plot. Para së gjithash, unë kisha ndër mend të shëtitja fshatit, për të shkëlqyer përpara të gjithëve me pasurinë time dhe të lija pa gojë këdo. Unë i kërcitja më sa fuqi që kisha xhepat e mi dhe, me sa mundja, më gjatë. Për darkë kisha kurdisur një plan tjetër: të shëtitja si duhej përpara dyqanit të zotit Avgerinos, i cili ishte i etur të tregonte se sa para kishte. Në darkë, përpara gjithë njerëzve, unë do t'i jepja një mësim të mirë, që të mos e harronte për një kohë të gjatë. «Sillmë, — do t'i thosha, — një racion mish të pjekur. Po shpejt! Sa kushton? Aq -- «një pesëshe», të themi, siç kanë qejf të shprehen ata zotërinj, që udhëtojnë në klasën e parë. «Pesëshe thua? Po ti ç'bën, lëmosha mbledh, apo tregton? Na, merr shtatëdhjetë dhrahmi! Përkulu, i dashur, ngreji, nuk i sheh se si u shpërndanë! He, he!»

Por as edhe një prej këtyre dëshirave të bukura dhe burrërore nuk u përmbush. Qysh në mëngjes më pllakosën stuhitë dhe fatkeqësitë.

Po, herët në mëngjes erdhi tek unë Shyqyriu, i kërrusur si një plak dhe më solli një lajm të hidhur. Ata po i nisnin. I kishin urdhëruar të përgatiteshin për udhë. Do të vinte treni i mallrave,

hamalli, siç e quanim ne, dhe do t'i merrte me vete. Në fushat përreth kishte një rrëmujë të madhe. Njerëzit e ngutur thërritnin e shaheshin, rriheshin, qanin, çoheshin. Shyqyriu të kujtonte një kafshë të sëmurë. Ai nuk donte të largohej... Por ja ku për dreq vjen i panjohuri me bilbil dhe thërrret:

— Hajde, turq! Pas drekës do t'ju çojmë në Turqinë tuaj.

E dëgjojnë këtë pleqtë, e dëgjojnë baballarët, tezet, motrat.

E dëgjon këtë edhe Shyqyriu dhe diçka kërcet në gjoksën e tij të vogël. Po pse? E mirë ishte kësollja — pallat i vërtetë! Kurse tani shkon në fund të botës, hajde gjej një shok dhe provo të ngresh shtëpi e të bësh hajër! Ku? Në një vend ku nuk dihet se ç'tokë është. — mund të jetë e kuqe ose e kripur. Nuk di si është atje uji, i kthjellët, apo si, fluturat a janë të shkruara, pastaj a ka të tilla, apo jo... Thonë se ajri atje është i rëndë si hekur. — i qëllon fëmijët në vend... Kush është ai që mund të thotë me bindje se atje ka stërçoka, se dardhat nuk janë kaq të shijshme sa patatet e freskëta të teze Katerinës, se kuajve nuk u rriten brirët, me të cilët ata u çajnë barkun fëmijëve? Le të na thotë ndonjëri për të gjitha këtë gjëra dhe ne do t'i heqim kapelën!

— Nuk do të më harrosh?

— Uaaa!... Për besë nuk do të të harroj.

Unë mbaja me dorë xhepin e rëndë — ai më pengonte. Tani nuk kisha as edhe një dëshirë ta për-qeshja në turi zotin Avgerinos. E kush do të më

thoshte tani mua «bravo»? Unë nxora nga xhepi një shuk me monedha.

— Shyqyri... Si thua, do t'i marrësh këto para?... Merri, merri! Atje tek ju shiten feste të kuqe. Blej një dhe vëre në kokë, që të të përshëndetin. Vetëm shiko ta vësh mirë, që mos të ta marrë era.

Shyqyriu fërkon kokën e vet të rruar. Unë ia vë paratë në xhep. Ai nuk di ç'të bëjë dhe e copëton shkopin që mban në dorë. Ah, sikur ai të mos ishte kaq i zi, do të dukej se si u skuq. Vështrimi i tij i druajtur tani u bë edhe më i druajtur se i një qengji.

— Arkadash, — shqiptoi ai me thjeshtësi. — Është mirë në Stamboll? Thonë se atje është shumë mirë.

— Po... Shumë mirë, Shyqyri... Shumë, shumë mirë.

— Pse po qan?

— Atje është mirë, Shyqyri... aq mirë...

— Atëherë të shkojmë së bashku.

— Unë nuk e di rrugën. Dhe pastaj... sikur s'më bën zemra.

— Pse? Ti këtu ke shokë?

Unë vura re se si nga kasollja fluturoi një shishe me vaj trëndafili.

Në stacion mbretëronte një kaos i vërtetë. Treni, hamalli siç e quanim, kishte ardhur dhe kishte qëndruar te platforma duke tymosur. Njerëzit vërtiteshin rreth vagonëve si bletët, herë duke dalë, herë duke hyrë. Dhe sa i pistë që ishte ky hamalli, sa i shëmtuar! Megjithatë, atij nuk i mungonte një-

farë madhështie. Germat e mëdha të rrumbullakta në faqet e vagonëve të gëzonin syrin. Në çdo vagon shkëlqente një fjalë e panjohur nga greqishtja e vjetër, aq e ngatërruar, saqë, sado ta vritje mendjen, nuk e merrje vesh, madje dhe kapteri që kishte ardhur me lejë, i biri i zarzavateshitëses, edhe ai nuk mund t'ia nxirrte kuptimin dhe vetëm se fërkonte zverkun. «Apovaron»<sup>1)</sup> — ja çfarë fjale që ishte. Dhe nën të: «Njerëz 32, kuaj 6». Siç dukej, hamalli nuk kishte ndonjë mendim të mirë për njerëzit. Tri-dhjetë e dy njerëz — gjashtë kuaj! Dhe kaq, mirë!... Pleqtë e fshatit, që shihnin se kuajt udhëtonin në tren, luanin mendsh.

Në disa vagonë, në vend të fjalës «kuaj», ishte shkruar «mushka». «Mushkat. — më shpjeguan mua, — janë gjysmë gomarë, gjysmë kuaj». Gjepura!... Mua ma treguan një mushkë të tillë dhe unë nuk e kuptova se si ata që flasin për ngjashmëri të tyre me gomarin, nuk kanë dy para mend. Nuk kishte asgjë prej gomari aty. Po dhe ato, për nga vlera, barazoheshin me disa burra.

Ja, të lutem, se si i emërojnë ndryshe vagonët pa asnjë marrëdhënie me katërkëmbëshat, «jo për kuajt» dhe «jo për mushkat»: «Të zënë» — ja si i quajnë. Mbase ju e dini se ç'kuptim ka kjo? Natyrisht, jo... Ata «vagonë të zënë» ishin të ngjashëm me shtëpitë e sapolyera, me ballkon. Kolltukë, krevatë, perde me tyl — gjithçka që ju mund të gjeni në çdo shtëpi arhondi.

---

1) Apovaron = darë (greq).

Shyqyriu, të cilin kishte kohë që e mundonin dyshimet, një herë më pyeti:

— Arkadash... Ç'u ka ndodhur këtyre njerëzve, pse shtëpitë e tyre i çojnë nga një vend në tjetrin?

Unë nuk e dija. U mendova, i shtrydha trutë, po nuk nxora gjë në dritë.

— Nuk e di, Shyqyri...

— Tani po jua tregoj unë. — Matanë gardhit nxori kokën një njeri.

Ne vështruam andej dhe pamë Dhimitrosin, një punëtor të linjës. Ai gjithmonë nxirrte ca gjëra të pakuptueshme...

— Nuk ia vlen. — kundërshtova unë.

— Jo, jo, — nguli këmbë Dhimitrosi. — Unë do t'jua them që ta dini dhe ju. Ti kërkon të dish, Shyqyri, ç'ndodh me këta njerëz, pse nuk i lënë rehat në shtëpitë e tyre?

— Po, dua ta di.

— Ata vuajnë nga dhjamët, Shyqyri, nga dhjamët. Ja ç'kanë ata.

— Nga dhjamët?... Po kjo ç'është, sëmundje e keqe?

— E keqe, Shyqyri, shumë e keqe për ne, të varfërit.

— Po si shërohet ajo, Dhimitros?

— Me punë, Shyqyri.

— Dhe... ata punojnë?

— Punojnë, the? Po, punojnë: Me duart e mia.

Ja, e sheh! Nuk thashë unë se ai gjithmonë të fut në qorrrokak!

— Ne nuk e kemi të qartë. — thashë unë pre-razi.

— Nuk ka rëndësi, picirruk. Do ta kuptoni më

vonë. Këto fjalë janë si violina e Nastradinit: i dëgjon kur je i ri, dhe i kupton kur plakesh.

Jo, askush në Vertekop nuk mund të merrej vesh me Dhimitrosin, me këtë punëtor....

Prej këtej, nga ana e kasolles, gjithçka dukej e qetë dhe e butë. Hamalli nxirrte tym, shkante përpara dhe prapa, mblidhte vagonët, sikur të ishte një anije e vogël me vela. Dhimitrosi, punëtori, e hodhi mënjanë lopatën dhe zuri të vërtitej si i çmendur. Dikë po kërkonte. Ai bile po e thërriste, por në stacion kishte një zhurmë të tillë, sa që atë askush nuk e dëgjonte.

Ne çohemi. Erdhi koha për t'u nisur. Heshtim. Vështrojmë të mërzhitur dheun dhe qëllojmë me këmbë gurët, sikur ta kishin ata fajin për gjithçka.

Në gjysmë të rrugës takuam Dhimitrosin. Duke iu marrë fryma, ai vraponte fushës. Kur na pa ne, nuk e përmbajti më veten.

— Ej, ti, Shyqyri! — thirri ai si i çmendur. — Jot ëmë ka vënë kujën! Gjyshja është pa ndjenja, kurse ti.... Gjete kohë për të shëtitur, që të humbtë vula!

— Po pse, Dhimitros?

— Pse? Dëgjo ç'thotë! Si pse? Ec e mos luaj mendsh! Po hamalli po niset. Niset! Dëgjon? Sulu tani me vrap. Akoma këtu je? Sulu, të them, përndryshe nuk do të arrish!

Ne u sulëm poshtë si sorkadhet që nuhasin erën e barutit. Lokomotiva kishte ardhur dhe ishte lidhur me vagonët. «Shkojmë? — pyeste ai. — Fr-rr! Gjithçka gati?» Shoqëruesit e vagonëve u bien bil-

bilave dhe tundin kapelat. «Puf... puf». Hamalli luajti vendit. Sapo kaluam nëpër barrierën e stacionit, kur...

Shyqyriu u sul pas trenit, thua se ishte një viç pa tru, që kishte mbetur prapa kopësë. Po hamalli është i pamëshirshëm. I bie të njëjtit avaz: «puf-puf». Shyqyriut i merret fryma nga vrapi.

— Ah! Mama, nënoke.... ndalo!

Filloi ndjekja.

— Shyqyri! — thërritnin të gjithë, të varur jashtë vagonëve. Duart e zgjatura të nënës u ngjanin degëve të përkulura nga era.

— Ah, i shtrenjti im.... ah, zemra ime!

Dhe të gjithë thërritnin:

— A... a!... A-a!...

— E, Shyqyri! Jepi, luan!

Edhe pleqtë, edhe të rinjtë i zgjatnin duart, grushtet.... Gjyshja tërhoqi njëfarë unaze për të ndaluar trenin, i lutej dhe e shante atë:

— Dur!), bre! Dur, bre! Ndalo, more, ndalo!  
Tmerr...

E bëri me qëllim, apo jo, nuk e di, por hamalli e ngadalësoi shpejtësinë jo për të mirë, por sepse, siç dukej, ngaqë shkoi te shigjetat, ku i duhej të ishte më i kujdesshëm. Shyqyriu e arriti. Zgjati doçkat e tij të vogla të zeza me shpresë për t'u kapur pas parmakut të derës. Po nuk ia arriti dot. U dëgjuan shumë fërshëllima njëherësh. Dhe një thirrje e tmerrshme e çmendur doli nga mijëra gjokse.

— A - a - a!

---

1) Ndal.



Hamalli humbi nga sytë. Në stacion u afrua një tren me rrotat e lyera me gjak... Copat e gjakosura të mishit kishin mbetur nga djaloshi dhjetëvjeçar turk, i cili nuk ishte më turk, nuk ishte më djalë, por ishte vetëm një xhelatinë gjaku në rrotat e trenit kalimtar...

Kurse Dhimitrosi, fshin me mëngë djersën nga fytyra dhe, fshehurazi, që mos ta vë re unë, e çon mëngën nga sytë. Ah, pse janë kaq pa zemër këta trena!...

Gjyshja besoj se tani nuk merr më frymë. E ëma, që nuk gjen ngushëllim, e qan me zë të birin. Vajtimi i saj do ta shoqërojë vazhdimisht trenin. Dhe për të nuk do të ketë fare rëndësi se ku shkon dhe se kur do të mbërrijë... Shpirti i saj mbeti prapa, në Vertekop, ai është çarë më dysh nga dhembja për coprat e mavijosura të trupit të shtypur. Kurse hamalli do të fërshëllejë dhe do të sulet përpara si një shpirt i keq, i ndjekur nga mallkimet, do të çirret dhe do të sulet fushave, derisa t'i merret fryma.

Kurse unë... Unë, që e kisha lidhur fëmijërinë time të hidhur me ëndrrat e porealizueshme me turkun prej Karaxhove, unë ka disa orë rresht që jam lëshuar, mbështetur në gardhin e stacionit, dhe nuk shoh gjë përpara vetes, nuk shoh asgjë, sepse sytë e mi janë plot me lot....

## KAPITULLI I TRETË

Unë nuk mund të qëndroja më gjatë në Vertekop. Mua më dukej se të gjithë trenat që kalonin, ishin të spërkatur me gjak. Duhej t'ia mbathja!... Turku i vogël më regëtinte përpara sysh midis kalimtarëve. Në veshë më jehonte kërcëllima e rrotave të trenit. Fërshëllimat, thirrjet e nënës... Duart e zgjatura dhe pashirmat joshëse. Rripat e shpalosur, thua se ishin flamurë. Festet e shndritshme si lulëkuqe, hequr prej kokëve dhe çuar tutje larg-larg, në fund të botës. Doçkat e shtypura nga hekuri...

Do të kalojnë shumë vjet dhe mua nuk do të më thahen dot lotët. Unë do të qaj, sepse unë të le-

jova ty të largoheshe nga kjo botë lakuriq... Pse nuk ta dhurova ty xhaketën time? Ti do ta vishje atje, në Stamboll, kur të shëtitje me vapor...

Tani unë po iki, o vëlla. Do të çohem dhe do të shkoj nga kodrat. Unë s'po mund të ngjitem në trenin që të shtypi ty kockat. Do të shkoj në këmbë.... Dhe do të gjej një punë tjetër — unë nuk do të shërbej më si shitës, jo, nuk do të shërbej më!

Unë do të bëhem ....ja, të themi, do të bëhem ....po çfarë do të bëhem unë?

Nga Vertekopi zënë fill shumë rrugë. Ca të çojnë në male, të tjerat në det. Disa humbasin në pyll, të tjerat të çojnë në ndonjë kënetë dhe treten atje.

Ka edhe një rrugë, e cila, duke u përthyer, shkon luginës, pastaj ngjitet nga Vodena. Qytet i bukur është Vodena. E shikon dhe habitesh, kush e ka veshur me ato stoli? Së largu ajo i ngjan një vajze krenare. Ajo është mikpritëse dhe e mirë, pavarësisht nga kostumi i saj i hijshëm. Ajo dikur ka qenë fshat. Po, pikërisht kështu.

Unë u nisa për rrugë, t'i dilja përpara saj. Unë dua të qetësohem nën hijen e pemëve atje, pranë lumit, të heq pluhurin nga vetja.

Por lumi është larg dhe, sa të mbërrish gjer atje, të ka dalë shpirti. Unë u ula mbi një gur në kodër. Unë nuk bëja asgjë. Rrija palëvizur dhe nuk mendohesha për asgjë. Për asgjë.

Vodena hedh lart ujërat e veta, si një anije që s'ka ç'të bëjë tjetër veçse të hedhë shkumë. Duhet të kesh këmbë të forta që të mbërrish gjer atje.

Po, dy orë rrugë duhen... Por, duhet të kesh këmbë, të forta e të fuqishme. Dhe duhet ta kesh dhe shpirtin të qetë, që të mos rrish mbi gur në station dhe të qash.

— Ç'ke kështu, djalkë? Pse qan?

Unë po rrija atje në kodër. Domethënë isha unë ai që qaja. Përndryshe, ç'e detyronte këtë njeri flokëndritshëm të më afrohej dhe të më bënte pyetje të tilla?

— Na — na. — e ndalon ai gomarin. Tjetri kthen kokën të marrë vesh se ç'kërkojnë prej tij. Sytë e mirë të fshatarit veprojnë paralelisht me duart e tij.

— Hajde të të ngjit këtu mbi gomar.

Fëmijët u besojnë syve të mirë. Ata sy i përkitnin një fshatari të rritur — një njeriu të ëmbël prej atyre, të cilët, kur ecin rrugës, ruhen mos shkelin ndonjë milingonë. Unë i fshiva sytë dhe iu afrova.

Gomari ishte në qejf. Ai më pranoi me kënaqësi mbi kurriz dhe u nis i gëzuar. I zoti i tij ia bënte «çk-çk-çk...» dhe ata ecnin pranë e pranë si dy miq.

— Do të hash? Do babotël?

Po a mund të kisha oreks unë?

— Jo.

— Pse?

— Nuk dua.

— Mos je i sëmurë?

— Jo.

— Ç'ke kështu?

— Asgjë....

Fshatari u zemërua:

— Ho — ho — ho! Ç'burrë kryelartë! Mua në quajnë Kristaq Maqedoni. Po ty? Ho — ho! Sa mendjemadh që je!

Unë do të desha ta falënderoja atë për zemrën e tij të bardhë. Desha t'u përgjigjesha pyetjeve të tij, po, sapo përpiqesha të çelja gojën, mua nishin të më mbytnin lotët.

— Falemnderit, Kristaq, — e nxora më së fundi llafin dhe mbylla sytë me dorë.

— Oh.... Përsëri qan.... Po pse, o xhan? Të ka rrahur mamaja?

— Jo.

— Oh, oh, oh, përsëri lot. Çfarë burri që më je! Po pse, qajnë burrat, ë?

Unë nuk u përgjigja. Rrija i heshtur. «Çk-çk-çk», — e shponte gomarin fshatari.

— A shkon në shkollë?

— Jo.

— Pse? Se je i varfër? Edhe unë i varfër jam. Ha, ha, ha! Ma jep dorën. Hajde, mos qaj, zevzek!

Zemrën flori e kishte ky Kristaqi. Ai më dha një copë kalli misri dhe nisi të fërshëllente. Ishte veshur ashtu siç vishen njerëzit e këtyre anëve. Pantallonat qillota ngjyrëkaki. Çorapet të gjata deri në gjunjë, të qëndisura me degëza dhe yje. Këpucët i kishte të çuditshme; me lëkurë gjedhi me push nga jashtë. Ato përqafoheshin paq me thembrën, kurse më sipër ishin të mbërthyer me një litar të fortë, si kulmak, dhe ngjanin me varka të vogla, me hundën ngritur përpjetë. Brezin e kishte të thurur, kurse nga nyja e pullave varej një zinxhir

i shndritshëm, që zgjatej lozonjar nga xhepi, ku mbante një thikë të mprehtë.

— Kristaq...

— Hë?

— Çfarë di të bësh ti?

— Gjithçka.

— Gjithçka?

— Po.

— A mund të jesh shkrues?

— Shkrues? Ha — ha — ha! Po pse, punë është kjo?

Dhe ai më shpjegoi se puna që nuk të djersit, është mërzi e madhe.

— Dimrit. — më tregoi ai, — unë sillja dru nga mali. Tani bëj kuni. Punë e nderuar, punë bu rrash.

— Po a fiton, Kristaq?

— Po punove mirë...

— Po thuamë, të lutem, Kristaq, a nuk gjendet punë atje, punë për djem?

— Gjendet.

— Mirë atëherë, merrmë mua me vete.

— A — a .... ti je akoma i vogël, o xhan. Rritu njëherë, pastaj e shohim.

— Po kush do të më rritë, Kristaq? Unë rritem vetë.

Kristaqi ia bëri i zemëruar:

— Oh, o nënë! Oh — ho — ho!

Dhe me një greqishte të çalë, nisi të më shpjegonte, se ç'rrogë të fëlliqur paguajnë atje dhe ç'pardon i lig që ishte ai atje... «E pamundur».

— Ç'të bësh, Kristaq? Punë tjetër nuk gjendet!

Ai ofshani:

— Mirë, u bëftë ashtu si thua ti. Do që të shkojmë qysh tani?

— Më mirë pas një jave.

Pastaj ai nisi të më shpjegonte se nga ç'rrugë duhej të shkoja. Ma shpjegoi me hollësi dhe me ngadalë, si një mësues, si një baba. Pastaj më tregoi se nga duhej të shkoja tani.

## KAPITULLI I KATËRT

Dhe ja ku unë ndodhem përsëri te tarraca mah-nitëse shkumëzuese e qytetit tonë. Lumi bën kërcime të larta dhe përhapet si një pluhur i bardhë në ajër. Qytet i mrekullueshëm. Në Vertekop, kartolinat me pamjen e tij i shitnin një dhrahmi copa, po askush nuk e kthente kokën për t'u hedhur sytë. Megjithatë, shitësja nuk i humbiste shpresat. Ajo ishte rrobalarëse, mesogrua, e cila kujdesej për rregullin e gjithë beqarëve të stacionit të trenit. Çdo herë, kur dëgjonte fërshëllimën e trenit, ajo pushonte së lari rroba, kapte kutinë me kartolina dhe sulej tutje.

Ditët e para, ky zanat i ri i rrobalarëses të gjithëve na u duk i çuditshëm: askush nuk e dinte



ç'kishte në kuti, çfarë shiste ajo. Po teze Katerina e zbuloi sekretin.

— Këto janë peizazhe nga Vodena, — tha ajo.

— Po ç'i duhen asaj, teze Katerina?

— Pse — ashtu, pse — kështu. Po ajo merr nga tri monedha për secilën.

— Po ç'është peizazhi, teze Katerina? A mund të ma thuash?

— Ç'është peizazhi? Katarakti! Ja ç'është.

Pa këta dijetarë, pa teze Katerinën, do të kisha mbetur qorr.

Po, ashtu ishte, siç tha ajo. Katarakti ishte bukuria dhe krenaria e qytetit tonë. Kur ai gjëmon, kur përplaset me gurët, dëgjohet zëri i qytetit. Zëri i qytetit është zëri i ujit.

Kristaqi më la midis gëmushave dhe iku. Durrë më të fortë se në Vodenë nuk ka. Lartësia dhe dendësia e tyre të kallin frikën. Qershitë e mëdha sa një lis dhe arrat të bëjnë padashur të mendosh për fantazmat. Fiqtë janë aq të lartë, sa, sikur të flasë ndonjëri lart, në majë, poshtë nuk dëgjohet gjë. Kurorat e ullinjve u ngjajnë lustrave, mollët i kanë kokrrat flakë të kuqe. Pemët janë plot me fruta aromatike. Ujërat e shumta lagin rrënjët e pemëve dhe ato lartësohen lart e më lart, që të mos qullen.

Ka aty pemë që lartësohen gjer në qiell. Ato janë mbushur me fruta të vockla, të zeza dhe të ëmbla. Ato quhen karabubu<sup>1)</sup>. Mund të hash sa të duash, ato janë pa zot. Degët e karabubuve janë ndërthurur me rremba hardhish, me të tilla, që

---

1) Karabubu — caraca (turq.)

nuk duan të kenë asgjë të përbashkët me rrushin. Ato ngjiten lart, për të nxjerrë frutat larg syrit të njeriut. Kurrë nuk më ka takuar të provoj një vesh rrush nga këto hardhi. Unë trembesha, kur zgjatnin rrembat e tyre si litar, se mos më lidhnin dhe mua në rrënjët ajrore të pemës së zezë. Miqësi shumë të ngushtë ka karabubu me rrembat e rrushit — nga e kanë gjetur këtë miqësi?

Banorët e Vodenës kanë një pasion: gomarët! Shtëpi pa ikona mund të gjesh akoma, po pa gomar — në asnjë mënyrë. Oborri pa «krr-krr» është njëlloj si kafazi pa zogj. Duhet shkuar në mulli? Me gomar. Për dru? Me gomar. Bile edhe në shëtitje, banori i një lagjeje të varfër nuk shkon pa gomar.

Ti mund ta quaje Vodenën jo qytet, po disi ndryshe, dhe do të kishe të drejtë.

E si mund ta quash këtë qytet, kur në vend të rrugëve këtu ka lumenj dhe në vend të automobilit gomarë? Si është e mundur të jesh qytetar dhe të bredhësh rrugëve me benevrekë! Pranë gjelldoreve, zyrave, kafeneve, institucioneve tregtare — gjithandej, bile edhe në teatër, janë rreshtuar grumbuj të tërë gomarësh në pritje plot durim të të zotëve të tyre. Në qoftë se ti kalon aty pranë dhe fyen gomarin dhe këtë gjë e vë re i zoti i tij, prit vdekjen më mirë.

E gjithë Vodena është një shkallë, që ngjitet në qiell. Shkalla është pak më lart — më saktë, ajo është motra më e vogël e Vodenës — Vlladova. Dhe nga këto dy shkallë, sikur të ishin vela, varen ujërat e bardha shkumuese. Harbojnë ato

nga një shkallë në tjetrën, rrjedhin dhe treten në detin e Selanikut. Pranë ujëvarave, në një kodër të gjelbër, ndodhen varrezat. Ato janë aq të bukura, aq të ngopura nga lagështia, aq të ngjashme me një park, sa që habitesh pse vodenasit nuk e lënë qytetin e tyre dhe nuk transferohen në varreza.

## KAPITULLI I PESTË

Fatkeqësitë dhe vuajtjet, të këqijat dhe prapësitë ecin pranë e pranë në këtë botë. Vjen njëra dhe menjëherë pas saj troket në derë tjetra dhe pastaj vijnë të gjitha bashkë. Grumbull. Thua se janë sorra shtegtare. Sapo mendon të qetësohesh pas njërës, kur të pllakos tjetra.

Kështu ndodh edhe me mua — gjithçka bie mbi kurrizin tim. Nuk ishin tharë akoma qerpikët e syve nga lotët e djeshëm, kur sot rrodhën lumenj të tjerë. Një kambanë më zuri kur isha në mes të rrugës për në qytet dhe më njoftoi për vdekjen e dikujt. E çfarë i mbetej kambanës të bënte?

Qyteti ndodhej në thonjtë e vdekjes, por mos vallë ajo kishte zgjedhur ndonjë njeri të afërm?

Njerëzit e morën me mend që nga gjëmimet e para të kambanës.

-- Kush është?

— Pejosi?

— Sahati?

— Sahati...

— Ouuuu...

Po, ishte ai. Plaku Pejos, me nofkën Sahati.

Lajmi i kësaj vdekjeje më gjeti në rrugë.

-- Vdiq Pejosi...

Zemra ime trokiste mbytur-mbytur. Vdiq Pejosi, njeriu me zemër të artë, me shpirt engjëllor, sahati i qytetit. Ai ishte miku më i mirë i fëmijëve, kambanarënesi më i mirë. Më të mirë nga ai nuk mund të kishte në botë. Po cilës kambanë i binte ai? Asaj të sahatit. Po, qyteti ynë kishte sahat dhe ai krenohej shumë me të. Vërtet se ai dallonte shumë nga sahatët e vendeve të tjera.

Në qytetin tonë kishte një kambanel, kurse mbi të qëndronte një kambanë e vjetër çjerrëse dhe litari që zgjatej gjer përdhe. Përsa i përket kambanelit, nuk do ta mburrim shumë, pasi ai ishte tamam si një xhami gjysmë e rrëzuar... Po sahati? Ku ishte vendosur ai? Ai ngrohej në xhepin e xha Pejosit. Çdo mesditë, plaku fjalosej fshehurazi me sahatin e tij, shkonte te xhamia, i pështynte duart dhe kapte litarin. Dëgjoheshin dhymbëdhjetë goditje të forta dhe njerëzit nxirrnin përfundimet e tyre. Po, ai duhej t'i binte dymbëdhjetë herë rresht. Kështu thoshin rregullat... Po thoni të drejtën, a e pat arritur ai qoftë edhe një herë këtë?

Ju kujtoni se pikërisht këtu ishte lezeti, vetëm ky ishte shkak i gëzimit, i shpresës së fëmijëve? Jo, kryesorja ishte në punën e gabimit.

Të gjithë fëmijët e kësaj lagjeje dhe shpesh edhe të tjerët, ata të lagjeve të largëta, e pritnin Pejosen qosheve. Dhe, sapo plaku ngrihej nga vendi i vet, mengadalë e solemnisht, e drejtohej për nga litari, gati për të lajmëruar njerëzit se sahati i tij thoshte dymbëdhjetë (plot dymbëdhjetë, as edhe një sekondë më pak), fëmijët i suleshin prapa dhe gjithçka shkonte sëprapthi.

Një gëzim i papërshkrueshëm gëlonte atje, pranë xhamisë, çdo ditë në ora dymbëdhjetë. Bile edhe lejekët në foletë e tyre shqyheshin së qeshuri: «Të-ëk, të-ëk, të-ëk».

Deri në dy numërimi ecte normal.

— Një-ë, — thoshte Pejosi.

— Një-ë, — përsëritnin fëmijët, qetë, si në klasë me mësuesin.

— Dy, — thoshte plaku.

— Dy, — ia bënin fëmijët, me duart e kryqëzuara në gjoks.

Plaku fryhej nga krenaria, sepse ishte tingëlilla e tij që shkaktonte një entuziazëm të tillë.

— Tre! — fërshëllente ai, si një top i shpuar, që po i ikën ajri.

Dhe aty topi shfrynte.

— Pesë! — ia bënin me një zë, si në kor, fëmijët.

Dhe më tej gjithçka shkonte për lumë.

— Gja-shtë... — thërriste plaku në atë rrëmujë dhe e humbiste fare fillin.

— Nëntë!... — çirreshin fëmijët, thua se i fry-  
nin ndonjë bilbili, nga ata që punojnë arixhinjtë.

— Dhje-të! — vazhdonte pas tyre plaku, duke  
e humbur përfundimisht numërimin e drejtë.

— Tre! — thërritnin papritur fëmijët. — Jepi!...  
— Dhe gjithçka niste nga e para.

Plakun e tërhiqte lumi i aritmetikës dhe ai  
ia linte veten tërësisht pushtetit të fëmijëve: më  
çoni ku të doni.

Aty zakonisht rregulli vente për dreq, përfu-  
ndimet arriheshin nga më të ndryshmet, kurse fë-  
mijët kërcenin nga gëzimi. Thoshin se gjatë dyzet  
vjetëve, as edhe një herë ora nuk kishte rënë plot  
dymbëdhjetë herë. Por ai nuk donte t'ia dinte. Për të  
s'kishte rëndësi, ai ishte i qetë, ndërgjegjen e kishte  
të larë — ai bënte detyrën.

Po nuk mbaronin me kaq kusuret.

— Sa është ora, xhaxha? — Fëmijët me çdo  
kusht donin ta shfrytëzonin gjithçka, deri në hol-  
lësirat më të vogla.

— Jeni shurdhuar, apo çfarë? — thoshte ai,  
duke bërë sikur ishte zemëruar. — Aq sa herë  
i rashë.

— E, domethënë, njëzet.

— Mos flitni budallallëqe. Sahati nuk ka më  
tepër nga dymbëdhjetë.

— Po ne që numëruam njëzet?

— Po ju mund të numëronit edhe njëqind! Sa-  
hati e di punën e vet. Sahati nuk ka më tepër nga  
dymbëdhjetë, kurse ju mund të numëroni sa të doni.  
Duhet të jetë dymbëdhjetë.

«Për sot mjafton, — vazhdonin fëmijët. — Kur-  
se nesër ne do të vijmë përsëri këtu».

— Ju bëftë mirë, xha Pejosi!

— Edhe juve ju vafshin mbarë lodrat, o bijtë e mi, — thoshte me përkëdheli plaku.

Dy-tre prej tyre i afroreshin dhe i puthnin dorën.

— A do të bjerë nesër sahati?

— Po` pse, a mund të ndalojë koha? — Ai e tregonte veten të fyer. — Po ju nuk do ta trembni më gjyshin, ë?

Kështu fliste gjuha e tij, kurse sytë thoshin: «Hajdeni, hajdeni, të vegjlit e mi... Më ngatërroni që të mos i bie ndonjëherë tamam dhe ky rast do të jetë për mua i fundit».

— Mirupafshim!...

— Rrugë të mbarë, o kecërit e mi... Shikoni mos pengoheni, bijtë e mi.

— Faleminderit, gjysh... (Tani ata e quanin gjysh). Ai që nuk ia kishte puthur akoma dorën, nxitonte ta bënte këtë.

Dhe fëmijët, duke kënduar e duke kërcyer, vraponin rrugëve për t'u shpërndarë nëpër shtëpi.

Kurse plaku... Fshehurazi fshinte sytë, lidhte i qetë litarin te grepi i xhamisë dhe kthehej te miqtë e tij për të vazhduar punën — të numëronte tes-pihet.

— Çfarë bënë prapë ata çamarrokë, Pejosi? — e pyetnin miqtë.

— Ç'ke me ta. Sahati argëtohet bashkë me ta. Ata numërojnë dymbëdhjetë, kurse sahati u thërrret: «Ki-ki-ri-ku! Dymbëdhjetë». Le të mendojnë ç'të duan.

— Po ti mendon së sahati është në rregull?

— Ku e ke fjalën? Sahati gjithmonë është në



rregull. Mund të gabojnë, siç i thonë fjalës, të shko-  
luarit, priftërinjtë, po sahati — kurrë.

— Po sikur të të ngatërrojnë fëmijët? — Ata  
ngatërrojnë vetveten. Sahati e di mirë punën e vet.  
Hesht më mirë.

Me asgjë, me asnjë arsyetim nuk mund t'ia  
ndërroje mendjen plakut, sikur t'i futje në kokë  
gjithë urtësinë e Solomonit!).

— Do të doja të di, — i thoshte më i ashpri  
e më gjaknxehti i shokëve, — a nuk kanë prindër  
këta të prapë, që t'ua shkulin veshët dhe mos t'i  
lënë të të torturojnë dita-ditës?

— Lëri ato, lëri, — thoshte me një ton pajtues  
Pejosi. — Edhe ata kanë hallet e tyre të vockla.  
Le të argëtohen pak.

— Kur të dëgjoj ty, më vjen për të vjellë!  
Do marr këtë shufrën dhe...

— Si? — kërcente nga karrigia plaku. — Ve-  
tëm provoje... Rri mirë aty ku je ulur. Shih çfarë  
trimi na paska sahati!

— Mirë, o mirë, qetësohu... Bëra shaka.

— Lëri këto, kumbarë, — vazhdonte me da-  
shmirësi Pejosi. — Mos më thuaj gjëra të tilla  
dhe mos guxo t'i prekësh ata, përndryshe, shiko  
se...

Aty pranë kalonte nganjëherë, për te burimi,  
shitësja e zarzavateve Janothisa, që të shpëlante  
mallin e vet. Edhe ajo nuk ia përtonte të tallej me  
plakun:

— Orët sot janë shtuar, o plaku Pejosi. Dita u  
zgjat.

---

1) Filozof i Greqisë së lashtë.

— Të janë shtuar ty budallallëqet.

Kështu, nga dita në ditë kalonin vitet, si uji rrjedhës, kurse plaku Pejosi — Sahati gabonte dhe thinjej, gabonte dhe i afrohej varrit. Vite të tëra zgjati kjo punë. Fëmijët u bënë burra, vajzat nëna, po sahatët ishin po ata! Të tjerë fëmijë dilnin në dritë, me të vetmin qëllim për të ngatërruar plakun. Ndërkohë prindërve të tyre kjo nuk u dukej e dënueshme, sepse ishin ata të parët që e kishin bërë me shëndet këtë punë. Pastaj kujt i prishte punë? Sahati binte dhe binte fiks në orën dymbëdhjetë. Po sa herë binte, nuk ishte njëlloj? Kujt i prishte punë kjo?

Prandaj dhe e lejonin atë të gabonte. Le t'i bjerë kambanës dhe të gabojë për kënaqësinë e fëmijëve... Nga ajo punë ishin skuqur faqet e tyre — dhe me kaq të falem nderit! Një-ë, jepi!... Le të bjerë sahati më tepër nga sa duhet! Kush mund t'i bënte të kuqëlonin ashtu faqet e fëmijëve?

Po sot faqet e fëmijëve u zbehën. Sytë i kanë të mavijosur dhe plot me lot. Xha Pejosi kishte vdekur.

Sot në mesditë, për herë të parë gjatë dyzet vjetëve, njerëzit dëgjuan se si kambana ra plot dymbëdhjetë herë.

## KAPITULLI I GJASHTË

Përgatitjet për rrugë mbaruan për dy ditë. Më pengoi pak mballomaxhiu, që djersiti shumë me këpucët e mia. Ai më vuri ca shoje, që s'kishin vdekje. Dhe për këtë nuk kërkoi as edhe një qindarkë më tepër. Tani gjithçka ishte në rregull. Të hënën unë mund të nisesha për rrugë. Fshati Vlladovo, për të cilin më kishte folur Kristaqi, dukej nga Vodena. Tani ai quhej Agra, Shtëpitë e fshatit shtriheshin deri në majën e kodrës.

Unë e lashë qytetin me keqardhje. Atje ndodhej Siika. Ajo banonte në një qoshe të shurdhët, me shtëpi prej guri. Shtëpia në të cilën banoja unë, e meremetuar me gjithfarë hedhurinash dhe

me një çati të përkohshme, ndodhej kundruall shtëpisë së saj.

Ajo ishte flokëverdhë. Mësonte në klasën e tretë. Duart i kishte gjithë bojë. Çështë e vërteta, njollat e kaltra në duart e saj më tepër ishin të pëllëmbëve të mësuesit të saj, sesa të bojës.

Kishte dhe ca njolla të tjera të kaltra. Jo nga sëmundje dhe jo nga boja, por nga njerka. Ajo ishte një shtrigë. Po, po! Një shtrigë e pamëshirshme, ndryshe s'ke si e quan. Sapō dëgjonte hapat e mi, ajo kthehej në një djall të vërtetë. Shtatlartë dhe kaba, si një arushë, ajo duhej të ulte kokën kur hynte në derë.

— Siik-a! — thërriste ajo me zë të çjerrë, si një sirenë vapori. — Ti përsëri më shoqërohesh me këtë të prishurin? Përsëri me këtë këmbëzbathurin? A — ah, do të ta bëj petën e kurrizit më të butë se të barkut! Do të të var! — Dhe ajo e mbërthen-te Siikën dhe i binte me se të mundte. Thirrmat e Siikës përhapeshin në gjithë rrugicën.

— Oo — oj, mami, nuk bëj më, — qante ajo. — Nuk bëj, nuk bëj më!

Ditën tjetër ajo më tregonte shenjat e thonjve të njerks, duke thënë pa të keq:

— Kjo s'është gjë! Vërtet që s'është gjë!...

Dhe ajo qeshte e tallej.

— Ti ke dhembje, — i thosha unë. — Ti po më gënjen, Siika. Të dhemb?... — Nuk më dhemb fare, për fjalë të nderit. As

— asnjë çikë! — dhe godiste, për të provuar ato që thoshte, në vendin e vrrarë. Unë qetësohesha.

Atëherë ne ziheshim për dore dhe vraponim fushave.

As asaj as mua nuk na interesonte të dinim nëse kishin zotër kopshtijet? Për ne, kudo që t'i hidhnim sytë dhe akoma më tej, gjithçka ishte jona. Gjithçka që rritej mbi dhe, gjithçka që vështronte nga lart dielli, na përkiste neve.

Dhe sa më të bukura të ishin pemët, sa më të shijshme frutat, më me bindje i quanim ato tonat.

Po njëherë ne na dhanë të kuptonim se ato nuk ishin tonat dhe ne u mërzitëm aq shumë, aq shumë u mërzitëm! Siika dhe unë! Ja se si ndodhi.

Ne u ngjitëm mbi pemë — një man i lartë — dhe nisëm të hanim, duke zgjedhur frutat më të ëmbla. Ne ishim aq të sigurt, saqë Siika ia mori këngës. Përreth nuk kishte asnjë të rritur, të cilët mund të na pengonin, dhe unë iu luta të këndonte më fort:

Mami më bleu mua,  
çorape të qëndisura,  
la-la-la-la,  
la-la-la-la.

Dhe aty, si në një përrallë arabe, thua se doli nga poshtë dheut, nxori kokën një njeri i tmerrshëm, i armatosur.

Zemrat tona u drodhën, aq i tmerrshëm ishte i porsaardhuri i armatosur. Mund të kujtoje se dikush e kishte krijuar atë qëllimisht që të trembte fëmijët.

Zëri i tij na é mori fare edhe atë fije burrërie që na kishte mbetur. Ai urdhëroi që ne të zbritnim, kurse ne u ngjitëm akoma më lart, me shpresë që t'i shpëtonim gjuaajtjes së tij.

— Zbritni, ej, ju, fëmijë, atje!  
 Mustaqet e tij ishin si furçë.  
 — Jo, jo, jo!  
 — Ah, ju, të mallkuar!  
 Siika qau. Më erdhi radha të tregoja burrë-  
 rinë time!  
 Unë vështrova mes degëve.  
 — Hidhe armën, — thashë unë, — dhe ne do  
 të zbresim. Unë do të zbres me siguri.  
 — Moo-s, — qahej Siika, — ai do të të godasë  
 në kokë!... Mooo-s, jo, jo! Mooo-s.. .  
 — E, ç'qurravecë që më qenkeni!  
 Njeriu u çmend fare. Aty unë u përzjeva për-  
 sëri:  
 — Xhaxhi, dëgjo! Lermë të zbres, të të them  
 dy fjalë. Pastaj më pushkato! Vetëm më lër të flas.  
 — Mirë, hajde.  
 Unë zbrita dhe ia nisa bisedës me të. Po më  
 tepër gëlltitja pështymë, sesa flitja.  
 — Çfarë do na bësh?  
 — Do t'ju lidh me tërkuzë.  
 — Sa herë do na godasësh? Njëzet? Njëqind?  
 — Dyqind.  
 — Po më pak nuk ka mundësi?  
 — Jo!  
 — Mirë... — Unë thitha sa munda më shumë,  
 ajër. — Atëherë goditëm vetëm mua.  
 Unë shtrëngova dhëmbët, u përkula dhe prita.  
 — Jo!! Mua! Vetëm mua! — çirret Siika gjys-  
 më e varur mbi degë. Ajo është ngjitur aq lart, saqë  
 nuk guxon të hidhet, kurse të zbresë ka frikë. Ashtu  
 rrinte e varur me fustanin e saj thua se ishte një  
 kabanë mbi kolonë.

Rojtari e kapi për këmbe dhe nisi ta tundte para-prapa, thua se po i binte kambanës. Pastaj iu dhimbs, e zuri për beli, e vuri në tokë pranë meje — ne të dy ishim flakë të kuq; na i kishte ngulur sytë në mënyrë të tillë, sa ne i shikonim vetëm kokërdhokët e bardhë.

— Xhaxhi, — mërmëriti me zë lutës Siika, — xhaxhi... — ajo dridhej e tërë. — Xhaxhi, ti je i mirë, pse kërkon të na vrasësh me pushkë? Unë po të jap karamete, ja shiko. — Ajo nxori nga shamia një karamete. — Na, xhaxhi, hajje... Sa e ëmbël... që është! — Dhe ia zgjati atij.

Ne të dy po e shikonim drejt në sy. Dhe pamë se si dalngadalë po i zvogëloheshin kokërdhokët, se si morën ngjyrë të zezë, pamë se si lëvizën mustaqet e tij, lëvizën dhe qeshën. Edhe vetë ai qeshi i tëri!

Na përkëdheli me dashamirësi në kokë dhe hodhi vështrimin përreth. Ne e kuptuam nga sytë se të gjitha kopshtijet, të gjitha pemët përsëri qenë tonat.

Që nga ajo ditë, ne i shëtitim pa frikë gjithë kopshtijet tona dhe i mbushnim futat me frutat më të mira.

Dhe natyra gjithë ato ditë qeshte.

E vetmja njollë e errët ishte shkolla e Siikës.

— Ti do të shkosh nesër në shkollë, apo jo? — i thosha unë me ton lutës. — Tani duhet shkuar, Siika!

— Jo! — përgjigjej ajo kokëfortë. — Nuk do të shkoj, përsëri do të shëtit!

— Po unë nuk dua që të të shëtitësh. Dua që ti të shkosh në shkollë.

— Atëherë hajde të shkojmë së bashku.

— Atje ka vajza dhe mua nuk më pranojnë. Pastaj unë nuk mundem, tanimë jam i rritur dhe më duhet të punoj, të nxjerr bukën e gojës.

— Unë do marr bukë fshehurazi dhe do të ta sjell ty.

— Jo, jo, nuk bën!

— Po unë do ta bëj! Mund ta bëj!

— Po mua më duhen dhe gjëra të tjera.

— Do t'i sjell dhe gjërat e tjera.

— Mua më duhet shtëpi, rroba, këpucë, libra...

Aty Siika heshti e çarmatosur. E ku mund t'i gjente ajo kaq shumë gjëra dhe të shtrenjta?

Dhe ja, sot erdhi çasti për t'u nisur: tullat!

— Mos harro, Siika, se ne duhet të punojmë e të fitojmë. Është një punë serioze.

Ajo më uroi natën e mirë dhe shkoi në shtëpi më parë sesa ta vinte re e ëma.

Unë i urova natën e mirë dhe gjithashtu shko-va në shtëpi para se të më pushtonte keqardhja.



## KAPITULLI I SHTATË

Unë u nisa për rrugë në agim, në acarin mëngjesor. Më shoqëronin pëllitjet e qeve, që u ngjanin sirenave të vaporëve, që ngrinin spirancat përpara lundrimit. Siç e shikoni, unë nuk isha një udhëtar dosido. Urdhëroni, ju lutem. Bile dhe qetë vuajtën kur më dhanë lamtumirën mua për në vende të huaja.

Rruga nëpër të cilën unë lëvizja, zgjatej si një shirit i bardhë. Ajo zbardhëllonte nëpër shpatet e gjelbra, shkante tutje, ngjitej gjer në luginën e Vlladovos. Fshati Vlladovo në një farë shkalle është një Vodenë në miniaturë; ai është po aq i gjelbë-

ruar, po ashtu i vendosur në një vend të hapur dhe atë e zbukuron gjithashtu një lumë dhe ujëvara. Atë që sapo hyn në fshat e pret pamja joshëse e një ndërtese të sapolyer: «Shkolla fillore e përzier e Agrës».

— Si mund të shkoj në kënetën, ku bëjnë tulla?  
— pyeta unë një vlladovas, që po lyente këpucët me sallo.

Ai fshiu duart për pantallonash dhe tregoi shinat hekurudhore, të cilat shndritnin dhe shtrihe-shin tutje fushës.

— Do të shkosh deri në stacion, atje ke për të parë furrat. Në atë vend ndodhet.

— Është larg?

— Jo-o. Sa të ndezësh dy cigare.

Të lezetshëm shumë janë këta fshatarët me masat e tyre. Të thonë «një vrap pele» dhe ty të del shpirti. Të thonë «sa të ndezësh një cigare», kur të duhet të pish një qeskë të tërë.

Unë mbërrita te vendi aty afër mesditës. Kumorxhinjtë punonin me sa kishin fuqi, me një sforcim të tillë, me të cilin hanë bar në kullotë qetë e uritur. Të gjithë ata ishin të rreckosur, të lyer gjithë baltë. Po ku ndodhej Kristaqi?

Unë u erdha qark të gjithëve me radhë. Kristaqi nuk dukej asgjëkundi. Mos vallë ai njeri i artë ishte gënjeshtar? — Si kishte mundësi?

Askush nuk e mori mundimin të ngrinte kokën të më shihte. Ata punonin të etur, ashtu -si pinë të eturit ose hanë të uriturit.

As edhe një fjalë si përgjigje për «mirëmëngjesin» tim. Ata nuk treguan as interesimin më të vogël ndaj një fëmije. Unë u kollita nja dy herë, kurse

ata vazhdonin të tyren. Punë e bukur! Unë u zemërova.

— Mua më duhet të takoj padronin, — iu drejtova më të rriturit prej tyre, një buzështrembri, me një turi prej qeni dhe të përgjumur.

Ai rrinte mbi një arkë dhe me një pamje triumfale largonte mizat.

-- Më duhet padroni, — thirra unë më fort.

Ai luajti vendit. Sapo ngriti vetullat e ngrysurat (ata i mbulonin sytë si çati), i ra ballit dhe shtypi një mizë.

Por gjumi e palosi përsëri.

— E-e-j! — thirra unë. — E-e-j! Unë dua të takoj padronin, padronin.

— Ç'e do? — mërmëriti ai me përtim dhe me mospërfillje. → Ti hyzmeqar je?

— Po.

— Unë jam.

Pastaj ai foli për pagesën.

— Dy dhrahmi e gjysmë deri në fund të javës. Do? Në qoftë se jo (në qoftë se unë nuk dua!), — ai s'kishte fjalë shumë, — ik. Në qoftë se do, kap kallëpin!

Unë isha një fëmijë i shkurtër, i dobët, po zëllin e kisha të madh. Mora pozën e një fshatari që del në fotografi, dhe thashë: «Dakord». Pastaj mora kallëpin, ofshana thellë dhe ia nisa punës.

Kohën tonë e tereziste treni. Sikur ai të mos fërshëllente gjithë ditën, ne do të punonim gjithë ditën. Ai tren dilte nga një birë e madhe që poshtë malit dhe, sapo shihte dritë, fluturonte nëpër linjën e rrethuar nga pemët dhe shfrynte në mënyrë të tillë, thua se po i merrnin shpirtin. Atëherë dhe

Pjetër biska, padroni, vendoste të largonte mizat dhe të «bënte pushim». Ne menjëherë shkoni nga sytë këmbët, i hidhni tutje veglat tona dhe kri-dheshim në lumë.

Kumia rrinte e qetë në pritje që të mbaronte argëtimi ynë. Kjo kumi midis pemëve ishte një ndër-marrje jo më e keqe dhe jo më e vogël se të tjerat. Bile dhe sirena e saj nuk dallonte fare nga sirenat e uzinave të qytetit. Padroni ynë i përgjumur vetëm sa dukej dembel, përbrenda tij vlonte. Në trurin e tij të dhjamosur vazhdimisht rrëmihte një djall i pangopur.

Po, po, pa shaka! Edhe kumia edhe shpirti kri-jues i padronit — biska, edhe dhjamuria e tij nuk vlenin gjë pa ujë. Uji është motor. Dhe çfarë uji! Memec, siç i thoshin. Sepse lumi që e sillte atë, ishte pa fjalë, njëlloj si varrezë.

Lumë i çuditshëm. E vështron atë dhe kujton se ai është prej qelqi ose i vizatuar. Kur tretet fu-shës, ai duket i përgjumur që prej kohësh të her-shme.

Nga ai lumë merrnin ujë përzierësit. Po mos kuj-toni se ndokush prej nesh lodhej duke e sjellë aty. Në asnjë mënyrë! Edhe ne kishim përzierës. Njëri prej përzierësve, një njeri tepër i zgjuar, e shpë-toi gjendjen. Mori një hu të madh — e çfarë nuk bën mendja e njeriut — dhe e mati me kujdes thellësinë e lumit. Bëri një llogari në fillim me sy, pastaj me gishta, mërmëriti nëpër dhëmbë diçka si «xë-xë», mbeti i kënaqur, pështyu duart, mori në dorë kaz-mën... Dhe uji na erdhi vetë në vend. Kurse përzierësi me kazmë vetëm sa i tregoi rrugën. Duke bërë zhur-më, si vraponte për në lug dhe derdhej në grumbu-

llin e baltës, duke e kthyer atë në qull. Kur nuk duhej më ujë, njëri prej nesh shkonte dhe e ndalonte atë.

Siç e thamë, balta, e ngopur me ujë, kthehej në qull për tulla. Dhe më tej, gjithçka varej nga arti ynë... Përzierësit nisnin përpunimin e qullit. Kur ai bëhej si mastiç, atë e hidhnin në kallëpe. Atje e merrnin formuesit dhe e përzienin me kujdes, si të ishte brumë mielli. Aty ia behnin transportuesit. Përpara se të mbusheshin kallëpet me baltë, ne i lagnim ato me ujë. Pastaj një xhaxho, i lyer i tëri me baltë, që të kallte datën, i spërkaste ato me rërën që ishte aty grumbull. Tani e kishte radhën për të treguar mjeshtërinë e tij kallëpxhiu. Ai vështronte kallëpin, e kontrollonte, njëlloj si mësuesi fletoren e nxënësit. Priste me një lopatë druri copra përzierjeje dhe, duke e ngritur lart, mbi kokë, e hidhte me forcë në kallëp, pastaj e rrafshonte me mistri dhe thërriste:

— E-ëj, muhaxhir! Mos të zuri gjumi? Gati!

Dhe transportuesit, punëtorët më pa vlerë, bindeshin. Që nga ai çast, puna kalonte në duart e pjekësit. Ai mbledhte tulla disa ditë rresht, i vinte në radhë në furrë dhe niste nga pjekja. Kohë ndër kohë, pjekësi përziante zjarrin, duke kontrolluar tullat, i nuhaste ato, i këqyrte. Sa kohë që vazhdonte pjekja, ai ishte i heshtur. Ai e lejonte veten të pushonte dhe të bënte shaka vetëm kur mbaronte pjekja.

Pastaj, kush ishte ai që nuk kishte respekt për punën e vet? Kush nuk punonte me frymëzim? Megjithatë ishte njëri mes nesh, që sillej ndaj punës tepër i përdëllyer. Përdëllehej si shumë përpara saj dhe e ngrinte hundën përpjetë. Ai ishte fis me

derrat dhe spiunonte për të gjithë. Thoshin se ai i ndante fitimet përgjysmë me padronin. (Mua më vinte pështirë kur ia shihja surratin). Atë e mbanin si kryepunëtor. Atë e quanin Vaxhe — emrin gjithashtu e kishte të pështirë. Sapo e mora vesh se ç'njeri ishte, unë e fshiva nga defteri. Ai përpiquej për të mirën e padronit më tepër se ai vetë. Krimbi! (Unë e urreva atë).

## KAPITULLI I TETË

Në mes të pislëkut të kënetës, përzier me djer-sën tonë dhe veglat, më ra rasti të ndieja jehonën e miqësisë sime me turkun e vdekur. Thashë se më kishin futur në grupin e kallëpxhinjve. Një punë pa bereqet dhe e lodhshme. Shokët e mi ishin një kuqo i rreckosur, djalë i shkathët, dhe një arixhi, moshatar me mua. Kuqoja kishte fituar ca shprehi të një të rrituri. Ai fërshëllente njëlloj si ata, po ashtu përpiquej ta mbante veten me të madh dhe tallej me lodhjen. Arixhiu ishte i imët e i dobët si një kec.

— Ej, gyfka!¹) — i thërritnin atij. Dhe unë nuk mund ta kuptoja pse kjo quhej sharje. Sepse, sikur mua të nisinin të më quanin helenas, pse do të zemërohesh?

Po edhe arixhiu nuk e prishte qejfin. Përkundrazi, ai i shkreti përpiqej t'ua bënte qejfin të gjithëve, duke qenë tepër i turpshëm nga ngjyra e zezë e lëkurës së vet. Kushedi sa vjet të jetës së tij do të jepte ai që të zbardhej!

— Gyfka! Ha-ha-ha!

Gyfka edhe vetë qeshte me veten e tij. Po ç'do të fitonte sikur të niste të zemërohej? Vetëm se do të talleshin edhe më shumë me të. Prandaj edhe ai bindej. E ulte kokën poshtë dhe u bindej të gjithëve. Ai ishte nga lloji i njerëzve të thjeshtë e të nënshtruar. Një engjell i dliurë i zi... «Shyqyri!» dëgjova unë zërin në gjoksin tim dhe sytë m'u ligështuan. Djaloshi nuk kuptoi gjë. Ai ecte mes baltës me këmbët e tij të holla, duke na shërbyer neve. Ai nuk e çelte gojën as për t'u përgjigjur, as për të pyetur. Ai nuk thoshte asgjë, vetëm qeshte, dhe ajo ishte një fjalë tepër e këndshme.

— Gyfka, ujë! — dëgjohej prej dikund. Dhe ai merrte kanën e vraponte për ujë, gati për t'i shuar etjen të zhuriturit.

Unë nuk i bija në qafë. Njëherë në mëngjes, vendosa ta pyetja kuqon:

— Pse nuk e honepsni dot? Thuamë, pse?

— Si, çfarë?

— Unë të pyes, pse nuk e doni?

---

1) Gyfka — arixhi (turq.)



- Kë? Atë arixhiun?
- Po.
- Ai... është arixhi.
- Dhe pastaj?
- Si çfarë? Ha! Po është arixhi ai...
- Unë e dua atë!
- Atë?
- Po.
- Edhe ti arixhi je?
- Jo.
- Po si atëherë?
- Ja kështu... Unë e dua atë.

Ej. djema! — u thirri ai të tjerëve. — Ai do që të kthehet në arixhi!

- Kush? Muhaxhiri?
- Po.

Ja, të kam rixha! Bile edhe ky, ky i fëlliquri Tole, ky turiqen ka nisur t'u shkundë pluhurin të mëdhenjve. Nuk di gjë tjetër vetëm fjalët zevzek dhe muhaxhir. Dhe ai shan. I zemëruar, unë ngjishja lëmshe balte. Një arixhi doja, tjetërkënd, jo. Unë e fërkova me dashuri atë. E ç'gjë të përbashkët mund të ketë njeriu midis mendjes dhe ngjyrës së lëkurës?

— Hë! — ia përplasa unë në turi. — Ja, kështu. unë e di emrin e tij! Atë e quajnë Shyqyri!

- Ç'do të thotë kjo?
- Ajo që po dëgjon!

Kuqoja e çapëleu gojën dhe po më vështronte i skuqur në fytyrë, si një tullë e pjekur, i ngrirë në një pozë të palëvizshme.

Kurse unë hapa krahët dhe... prisha dy tulla. Pjetër-biska të tilla gjëra nuk i honepste. Ai shpërtheu menjëherë si barut, si një sallo në prush.

— Ej, muhaxhir! — thirri ai. — Një mandalinë<sup>1)</sup> — një drahami.

Unë e kuptova se ç'erë binte kjo, megjithëse nuk i kuptova shkoqur fjalët. E mora vesh se ai do të më mbante nga një drahami për çdo tullë të prishur. Pastaj përsëri gjithçka heshti.

Arixhiu, sikur të mos kishte ndodhur gjë, vazhonte të bënte punën e tij, i nënshtuar dhe me mospërfillje. Biska përsëri u kot në gjumë. Kuqoja vërtitej i gëzuar për fatkeqësinë time. E la kallëpin mënjanë dhe u shkri së qeshuri. Po pas pak dhe ai e mori racionin nga biska.

— Ej, Tole! — shpërtheu padroni, pa i çelur sytë. — Kallëp! Kallëp!

Mirë e pësoi. Po tani mua nisi të më shqetësonte diçka tjetër: si mundej ai, derkuci, ndërkohë që flinte, t'i shikonte të gjitha?

Një kumaxhi i zbyrdhulët, që vërtitej tutjetëhu përreth tullave që thaheshin në diell, ma shpjegoi si ishte puna:

Biska shikon me veshë. Si? Ja kështu: ai e ka regjistruar në veshë gjithë zhurmën e punës. Dhe vetëm kur dallon pauzat, nis të shajë. Këtu është i gjithë sekreti.

Tani, pasi hodha sytë përreth, vendosa të pyetja për mikun tim. Kristaqin. Unë e mora vesh se si e quanin kuqon dhe kjo ma lehtësonte shumë punën.

---

1) Mandalinë — tullë (moqedonisht).

Gjeta rastin kur ai e ndërpreu fërshëllimën dhe e pyeta:

— Tole...

— E?

— Ku është Kristaqi?

— Kristaqi?... Ha — ha!... Shkoi në fshat të martohet. Jo, është shpejt akoma për t'u martuar. Shkoi të rregullojë.... të përgatisë fejesën e vet.

— Dhe do të vijë?

— Ehë, do të vijë.

— Kur?

— E-e, mos u ngut, lëre të bëjë njëherë fejesën.

— Mirë....

Unë u qetësova. Ja, do të vijë Kristaqi dhe gjithçka do të ndryshojë. Do t'i paguajnë shtrenjtë kumaxhinjtë talljet që më bëjnë mua. Herës tjetër do ta mësojnë mirë se si të më quajnë mua muhaxhir dhe zevzek. Do t'ua tregojë mirë qejfin Kristaqi. Mrekulli! Ai i ka duart, na! Do ta shohin...

Dhe ja, Kristaqi erdhi.

— Urime! — thirri kumaxhiu i parë, që e vuri re, dhe e goditi me baltë me sa i hëngri krahu.

— Urime! — e pasoi dhe një tjetër dhe gjithashtu e goditi me një shuk balte.

— Urime!

— Urime!

— Urime! — dëgjoheshin nga të gjitha anët.

Kristaqin e mbuluan krejt me baltë.

Unë u fsheha pas furrës dhe ngriva. Pse, ky ishte mbrojtësi im? Krenaria dhe shpresa ime tani ishin mbuluar të tëra me baltë. Kristaqin e mbër-

thyen dhe — një — dy — tre! — e hodhën në lumë.

Uji i rridhte çurk, kur ai doli në breg. Kurse prej syve të mi akoma më fort rridhnin lotët. Përzierësi i squllur, më i shëmtuari i përzierësve në gjithë botën, më nguli sytë me habi, duke i çapëlyer sytë.

— Pse vepruan kështu me Kristaqin? — pyeta unë. — Pse?

— Ë-ë, mos qaj, djalosh. Kështu është zakoni, kështu.

— Po, i tillë ishte zakoni! Sepse, kur Kristaqi doli nga lumi, të gjithë i dolën përpara dhe i shtrënguan dorën me përzemërsi dhe triumfalisht.

— Falemnderit, — përgjigjej ai. — Falemnderit, falemnderit.

Nuk dëgjohej gjë tjetër, veç falemnderit. Pastaj, pasi e mblodhi pak veten, Kristaqi u interesua:

— E, djema, mos erdhi gjë këtu për të kërkuar punë një djalë i vogël jabanxhi? Mos është dukur gjë këtej një njeri i tillë?

Unë isha te gropa, ku mbusheshin kallëpet, dhe ai nuk më vuri re.

— Ha! — i thanë atij me një zë të gjithë. — Ja ku e ke! — dhe treguan me dorë nga gropa.

Një kërcim dhe Kristaqi u gjend pranë meje. Më zë prej koke dhe më shtrëngon në gji; ai nuk di ç'të bëjë më tepër me mua. (Sa erë të mirë që ka balta, çfarë arome të ëmbël që ka palikari)<sup>1</sup>).

---

1) Palikar — shok, mik, njeri i shkathët (greq.).

Pastaj më rrotullon sikur të isha një tablo, dhe ua tregon të tjerëve.

— Djalë i mirë — thotë ai.

— I mirë, i mirë, — pohojnë të tjerët dhe vështrojnë të çuditur nga ne. Ç'është kjo miqësi e çuditshme — një djalë, muhaxhir!

Biseda jonë papritur u ndërpre, sikur ta kishin prerë me thikë. Pjetri, pasi u zgjua, thirri:

— E, bargo, bargo!)

Unë u sula për te kallëpi.

— Sh-sht! — më ndaloi Kristaqi, duke qeshur. — Më ngadalë, mos u ngut!

Ja ai, miku! Erdhi çasti t'i tregoja për të gjitha poshtërimet që më kishin bërë.

— Dëgjo, Kristaq, mua më shajnë këta këtu...

— Kush? — pyet ai me interesim dhe menjëherë lartësohet dyfish para syve të mi. Duart e tij u bënë gati menjëherë të mbytnin dy-tri vetë. — Kush? — përsëriti ai dhe lartësohej edhe më shumë.

— Të gjithë.....

Ai flak baltën dhe afrohet te njerëzit.

— Kush?! — çirret ai dhe i shikon me ashpërsi ata, si të ishin këlyshër.

— Askush, askush, — thanë disa me një pamje trashanike.

Kristaqi nuk di kujt t'i besojë. Ai përsëri kthehet nga unë dhe më pyet se si më shajnë.

— Po ja, më quajnë muhaxhir.

---

1) Bargo — më shpejt (maqedhonisht).

- Muhaxhir!
- Dhe zevzek.....
- Dhe zevzek?!
- Ëhë, herë muhaxhir, herë zevzek.
- Dhe muhaxhir dhe... A-a-ha-ha!
- Pse?
- A - ha . - ha!

Kaq e pat! Unë nuk kisha më mik. Kristaqi, i miri Kristaq, i drejti Kristaq, doli më i keqi prej tyre. Unë i përfshiva me sy kumaxhinjtë me shpresë mos gjeja midis tyre ndonjë mik të ri. Po ata po shqyheshin së qeshuri. I hodhën mënjanë veglat dhe qeshnin, duke e mbajtur barkun nga gazi.

«Gjithçka mori fund, — më thoshte zemra, që po rridhte gjak. — Tani gjithçka mori fund». Unë shkova të lidhja trastën, me mendje që t'i braktisja këto vende.

Kristaqi, i shembur së qeshuri, m'u afrua.

— Eh, ti, zevzek! Kush të tha se fjala zevzek është sharje?

— Po pse, nuk është sharje?

— Jo!

— Po muhaxhir?

— Edhe muhaxhir gjithashtu! Ti je i ardhur apo jo?

— Po.

— Kurse unë jam maqedhonas. Kjo është gjë e keqe?

— Jo. (Muhaxhir domethënë muhaxhir, i ardhur, vetëm kaq!)

— Ja, e shikon? Tani hajde këtu. Më jep dorën, zevzek!

— Dorën! — tha dhe përzierësi i shëmtuar.

Ne i shtrënguam dorën njëri-tjetrit. Ma shkundën dorën dhe kumaxhinjtë e tjerë.

Atë gjë bëri dhe kuqoja.

Ma shtrëngoi dorën dhe arixhiu i vogël me sytë ngjyrë bakri.

Vetëm kryepunëtori s'u tund nga vendi. Po kjo mua nuk më bëri përshtypje. Punë e madhe, pse ta prish gjakun unë, në qoftë se një tullaxhi dosido nuk ma dha dorën e tij të fëlliqur. E ç'më duhet ajo? Edhe unë di të fërshëllez. Ja!

## KAPITULLI I NËNTË

Jovanisi, një xhaxho që nuk rruhej kurrë, ishte i fortë dhe i shkathët si një tigër. Ai e urrente punën tonë. Ai kishte ardhur tek ne nga një fshat malor, me një thes plot me bukë të zeza në krahë. Ai hante në një vakt një karvele të tërë dhe pastaj e çonte barkun e tij të mbushur në lumë, ulej në gjunjë dhe niste e pinte. Unë njëherë munda të numëroja gjer në njëqind, kurse ai akoma vazhdonte të pinte, si një bidon i shpuar.

Drekën e kishte të pasur, kurse përpara drekës patjetër që kishte njëfarë mezeje. Para syve të të gjithëve ai i shtronte ushqimet me radhë: specia



të njomë, domate, patëllxhane. Ditën tjetër (po, po, unë nuk tallem) radha ndryshonte: patëllxhane, domate, speca të njomë.

Jovanisi ndizte zjarrin dhe i hidhte të gjitha këto mbi thëngjij pastaj u qëronte lëkurën, u hidhte kripë dhe i hante.

Një njeri që e mbush barkun në këtë mënyrë, duhet të bëjë diçka për të tretur ushqimin më pas.

Natën ne luanim mendsh.

Jovanisi, i shtrirë mbi brucën e leshtë, gërhinte me sa fuqi kishte. Vetëm zjarrmëtari, që kishte shtruar pesë hapa më tej nga ai, mund të flinte si i vrarë. Për të marrë vesh nëse merrte frymë, duhej të përkuleshe gjer te hunda e tij.

Po nganjëherë edhe ai zgjohej nga fërshëllima që fluturonte nga vrimat e hundës së Jovanisit, e shante në dialektin e vet.

Jovanisi zgjohej me zogjtë.

Ai e kishte parë agimin e diellit aq herë, sa ditë kishte në jetën e tij dyzetepesëvjeçare. Rrezet e agimit dhe zogjtë e qiellit e takonin Jovanisin. Dukej sikur dikush i pëshpëriste në rrëzë të veshit me bori: «Çohu, Jovanis, dielli po del!»

Dhe ai çohej, hidhte mënjanë brucën dhe vraponte te lumi.

Larjen e tij mund ta kishte zili dhe macja. Ai vraponte me kërcime deri te lumi, lante duart, pastaj i shtrydhte ato që të rridhte uji; me të majtën fërkonte fytyrën, kurse me të djathtën lante flokët. Pastaj me mëngën e majtë fshinte flokët, me të djathtën fytyrën dhe, pasi kryqëzonte këmbët, ulej mbi barin e freskët. Pështynte gishtërinjtë, dridhte një cigare, e ndizte dhe tymoste. Kë-

shtu ai tymoste pa u ngutur dhe me shije njërën cigare pas tjetrës.

Në qoftë se Jovanisi kishte pirë cigaren e gjashtë dhe akoma nuk i kishin rënë çangës, ai nxehej. Dhe sillej njëlloj si kali, që hedh shqelma nga padurimi dhe fërgëllon.

Kurse atë mëngjes, kur u dha urdhri që të mos punohej gjer në mesditë, ai shkoi në fushë dhe, ngaqë s'kishte ç'të bënte, nisi ta rrëmihte dheun me këmbë. Pastaj, i mbështetur në një shelg, me një pamje të mundur, nisi të pështynte. Në drekë nuk kishte oreks dhe ai nuk hëngri as edhe një kothere. Po, sapo u dha urdhri për të punuar, ai iu sul si një kalë punës. Dhe në darkë e përllau ushqimin e vet.

Duart e Jovanisit, gri në të kuqe, në ngjyrë tulle, me gishtërinj të fryrë, të kujtonin oktapodhin me kthetrat e tij.

Lart, mbi supe, mbërthyer mirë mbi qafën e nxirë nga dielli, rrinte koka e tij madhështore dhe vështronte nga ne. Përbri saj këndonin erërat, fluturonin zogjtë. Ishte një kokë fshatare krenare, e bindur në drejtësinë e saj. Aty përziheshin urtësia dhe bukuria; kishte dhe paragjykimet e saj. Ti i thoshe një gjë, kurse ai ngulte këmbë në të tijën.

Qielli na dërgonte rrezet e arta. Diku, atje larg, në koriye, dëgjohej vajtimi i vetmuar i një fyelli, kurse tufa nuk po dukej. Dukej sikur era këndonte një këngë me një fyell prej kallami, por erë nuk kishte. Kumaxhinjtë e dëgjonin këngën të qetë — kjo nuk i habiste. Kurse unë dridhesha nga një drithërimë e lehtë, duke trembur vetveten. Mbyll veshët

— ah, sa mirë! Fyelli hesht. I çel — përsëri ata tinguj. Kristaqi nxjerr nga goja tym dhe dëgjon...

— Kristaq...

— Çfarë ke?

— Kristaq, o Kristaq....

Ai përgjigjet zvarrë-zvarrë:

— O-o-oh, si e ke hallin?

— Po ti, e dëgjon këngën?

— Ëhë, e dëgjoj.

— Çoban është?

— Çoban. Plaku Mitris. I çmenduri.

— Po ku janë delet e tij? Unë nuk ia kam parë kurrë.

Kristaqi kësaj radhe e lëshon tymin lart.

— Ja ato.

— Yjet?

— Po, yjet. Ai është budalla.

— Si ka ndodhur, Kristaq? Si ndodhi?

Kristaqi ulet mbi një grumbull bari dhe me kënaqësi, si një gjysh i mirë, tregon historinë e atij çobanit.

— Plaku Mitris, Menelo, kishte shumë-shumë desh, një kope të tërë. Ai është moravas. Dhe ja ku vjen tek ai një pasanik dhe zgjedh një tufë të vogël me desh. Vjen një tjetër dhe gjithashtu merr ca. Vjen dhe i treti dhe njëllaj merr... Kështu plaku Mitris e humbi gjithë tufën e tij. Tani ai nuk ka më desh. Nuk ka më asgjë. Tani ai ruan qiellin. Ai është budalla. E kuptove, Menelo? Jo?

— E kuptova, Kristaq. Pasanikët ia morën gjithë deshtë, e bënë të luajë mendsh dhe tani, në vend të deshëve, ai kullot yjet. Kështu?

— Kështu.

Unë mërzitëm. Godas me grusht tokën.

— Po pse, njerëz ishin ata që lejuan të keqen, Kristaq? Po pse, njerëz ishin?

— Njerëz, Menelo, njerëz, — e-he-he!

Shumë shpesh, në vend që të tregonim histori të ndryshme, luanim «biz»! Lojë tepër interesante. Njëri prej nesh duhej të mbulonte sytë me dorën e djathtë, kurse pëllëmbën e majtë ta vendoste në sup. Të tjerët, me një gëzim të egër, vërtiteshin rreth tij si bletët. Dikush e godiste në pëllëmbë dhe të gjithë menjëherë thërritnin «biz». Ai që rrihej, duhej të merrte me mend se kush e kishte goditur.

Kur mërzitëshim së lojturi «biz», i fejuari Kristaq ia merrte këngës.

Vera ishte e mahnitshme; ajo po na luante mendsh.

Dhe aty ia nisnim këngës, si të mundnim. Kristaqi ia merrte këngës së vet, me kapën përmbi sy, kurse të tjerët këndonin si ua donte qejfi — dhe në kor, dhe vetëm.

— Kristaq! Ej, Kristaq! Dëgjo, hajde të këndojmë këngën e Stankës, këndo, — e luste ndonjë nga përzierësit, duke tundur këmbën.

Kristaqi aq donte:

*Çohu, çohu, çohu, Stanka, dhe çil derën.*

*Ej, ti, çohu, çohu, çohu Stanka, që të dalë dielli!*

Të gjitha i kishim ne atje — edhe muzikën, edhe përrallën, edhe lojërat, lojëra të zhurmshme, njëlloj si ato që i luajnë shkollarët fshatarë.

Edhe strallin e Jovanisit, edhe këngën e Kris-  
taqit të fejuar, edhe «bizin» — gjithçka e zbuku-  
ronte ajo natë vere. Vetëm arixhiu flinte në vetmi  
të plotë, si një zog, që kishte fluturuar nga vende  
të huaja. Mua më vinte keq për të, dhe do të doja  
ta strehoja në zemrën time. Por s'kisha ç'të bëja: i  
trembesha lëkurës së tij.

Po, unë trembesha se mos më zinte sëmundja e  
nxirjes së lëkurës. Kuqoja më këshilloi të merrja  
masa menjëherë.

Kryepunëtori qëndronte mënjanë nga lojërat  
tona. Nuk bisedonte me asnjë, nuk luante «biz». Du-  
hani ishte i vetmi argëtim i tij. Pasi pinte një rën  
cigare, ai e vinte bishtin e ndezur në qafë të çiz-  
mes dhe, pasi dridhte tjetrën, e ndizte me të parën.  
Këtë e bënte që të mos harxhonte më kot eshkën.

Në qoftë se natën arrinte të më vinte re mua  
midis të rriturve, ai më hakërrohej me zërin e tij  
kumbues:

— Ej, ti, marsh në gjumë!

Unë ngrihesha duke ndukur buzët.

— Pa hë! Hajde këtu! I kujt je ti, pa më thuaj!

Unë as gëk, as mëk.

— U-uh, ti! — qeshte ai duke shtuar të sharat.

Kurse unë kthehesha me neveri dhe i jepja ku-  
surin, duke i treguar prapanicën, dhe ikja.

Prapa më ndiqnin të sharat. Unë shtrihesha në  
mbulesat e ashpra dhe shtroja fierin.

Kokën e kisha plot me këngë, tregime e «biza»

Unë i largoja nga mendja të gjitha një rën pas  
tjetrës, duke dremitur nën batanijen time të vjetër  
prej leshi. Unë kam shumë qejf të shkoj te çobani  
plak, që kullot tufën e yjeve, t'i uroj atij shëndet

të mirë dhe t'i them se unë jam në anën e tij. Pse? Më vinte keq që ai kishte humbur tufën e tij, apo i kisha zili ato që kishte tani? Vetëm se kisha dëshirë të madhe të shkoja tek ai. Tregonin se ky plak i mbaruar, që kishte lindur në fushat me lumenj të bardhë, kishte ardhur në tokat maqedonase dhe pas-taj peshkaqenët e pasur e rrënuan. Çdo natë ai zbriste nga Tehova — një fshat i përhimtë, që mbështetej tutje, në breg — qëndronte në fushë e kulloste «deshtë» e tij.

Në ato orë, e përsërit, do të doja ta takoja.

Dhe ja ku sot, kur tullaxhiu më i fundit pastroi hundën e tij dhe shkoi për të fjetur, unë, mengadalë dola nga rrobat, eca tutje dhe u drejtova nga ko-drat.

Përreth, duke buitur, rrëshqasin gjarpërinjtë e ujit. Po, jo, unë nuk ua kam frikën! Mua më kanë thënë se gjarpërinjtë, gjarpërinjtë e mëdhenj, të quajtur xhelatë, e kanë për zakon t'ua presin rru-gën njerëzve dhe, në qoftë se nuk ua di gjuhën, ata mund të të mbajnë në mes të rrugës deri nesër në mëngjes. Po unë e dija gjuhën e tyre. «Bulluras!» — ju thotë juve gjarpri. «Biminas!» — duhet t'i përgjigjeni ju. «Ma dorëzo mua kështjellën!» — ju thotë ai dhe pikërisht këtu është gjithë hileja! — «Merr gjithë qytetin», — i përgjigjeni ju dhe — na! — i hidhni atij një copë djathë.

«Kaloni!» — mërmërit egërsira dhe nga tërkuzë kthehet në karro. Kurse ju shkoni më tej.

«Fërt!» — dëgjohet një zhurmë e lehtë në gë-mushat. Po nuk është gjarpër, por zog. E, ç'jetë të çuditshme që bëjnë dhe këta zogjtë e natës! Isha ulur njëherë në mbrëmje dhe vritja mendjen për

këtë punë. E pse u kanë vënë atyre sy në ballë, gjersa nuk u duhen? Hajde jepu peshqve këmbë, e ç'do të bëjnë me to? Gjarpërintë, po, ata rrojnë më mirë. As këmbë s'të kanë, as krahë, as edhe telashe. Kanë vetëm cipën e lëkurës dhe ata zvarriten në qejfin e tyre...

Unë dola në lëndinë. Tani fyelli dëgjohej më afër. Rrugës hasa një gomar, që po e kalonte natën në fushë — atë e kishin harruar atje — dhe po numëronte yjet. Ai rrinte mendueshëm, shumë mendueshëm.

Shkoj më tutje. Shtyhem mes natës në drejtim të tingullit të fyellit të plakut Mitris. Ja më së fundi dhe çobani. I mbështetur me kokën mbi brucën e kthyer si jastëk, ai rri shtrirë dhe kënaqet me pasurinë e vet, duke i thurur lavde fjalësh të arta. Kur më sheh mua, vë gishtin te buzët, ma bën me shenjë «sh-sh....» dhe e fut fyellin në këllëf.

— Si është puna, gjysh?

— Sh-sh.... qetësi, mos i tremb!

— Cilët?

— Qengjat.

Dhe më tregon yjet.

Po, unë i shikoj. Mijëra yje ndritin në qejfin e tyre, në kullotën qiellore.

Ata kullotin, plaku akoma vazhdon ta mbajë gishtin te goja.

— Të tutë janë?

— Po të kujt tjetër.... Ulu këtu afër të të tregoj për secilin prej tyre. E shikon atë që është drejt mbi kokë? Ja, atë leshdrudhin? Bukuroshi! Edhe atë tjetrin, që ecën mbi qumështin e dërdhur? O, ajo është delja që ka më shumë qumësht. Të gjitha që

shikon përreth janë pëlleja ...Bagëti të bekuara...  
Aa-ap! Psh-psh-psh! Ah, ti je përsëri, Kopsonura! E,  
si më vështron, sikur do të tymosësh! Mosmirënjo-  
hëse! Pa!

— Cila, gjysh?

— Ja, ajo e paqethura, që po zbret shpatit. Do  
që të ndahet mënjanë nga kopeja. A — ah, ti, e  
prapë!

— Ajo në cep?

— Po-po! Oh, ti... të marrtë e mira!...

— Gjysh....

— E?

— Mua më kanë thënë se ti je nga Tehova.  
Pse nuk i kullot atje, po vjen këtu, kaq larg?

— Atje më pengojnë malet, bir, ja pse. Prej  
andej nuk shihet e gjithë kopeja.

Ai mbështetet më mirë dhe ofshan ngadalë.

— A kanë shumë qumësht, gjysh?

— Po pse, si ta merr mendja ty, po të mos ki-  
shin shumë do t'i kullotja unë!

— Po atje lart, kush e pi gjithë atë qumësht,  
gjysh?

— Kush? Engjëjt, kush tjetër!

— Engjëjt?....

— Pse, kush kujton ti? Po, bir, fëmijët e en-  
gjëjve e pinë. Pat, Gjose, kthehu prapa, e mallk....

— Ai e trembi me grusht yllin e pabindur, pastaj e  
goditi me gur. Ai e tregonte veten si të zemëruar,  
por sytë e tij shprehnin kënaqësi dhe ngopje nga  
pasuria që kishte në qiell.

— Ja, shiko. — foli ai përsëri, — tani atyre po  
u ecën mirë shëndeti.



Ai më tërhoqi nga vetja për të zënë vend mirë dhe axori fyellin e tij.

— Ti biem pak... Sido që ta vërtitësh, po nuk bëri punën e vet fyelli, bagëtia nuk vë shëndet.

Disa herë ai e vërtiti gjuhën nëpër qiellëz dhe, duke marrë frymë me zor, nisi t'i binte. Në kënetë gjithçka ngriu. Nëpër fytyrën e nxirë nga dielli të plakut përshkëndriti mirësia. Heshtën edhe gjarpërinjtë e ujit.

Kur ai pushoi së luajturi me fyell, në sytë e tij, thua se ishin copra yjesh, zunë të shndritin pikëza shikëlqimtare. Ai tregoi «deshët» e tij...

— I shikon?...

Dhe u shtri në kurriz që t'i admironte më mirë. Një orë të mirë qëndroi ai ashtu, tretur në ëndrrat e arta të çmendurisë së vet. Unë u ngrita mengadalë për t'u larguar. Por doja të saktësoja dhe diçka tjetër, të sqaroja dhe një diçka, që dhe shpirti im të mbushej me gëzim, që dhe unë të mund të bëja një gjumë të qetë fëmënor, pa halle, siç flinte ky plak i çmendur...

Unë u përkula pak dhe e tërhoqa atë për bruce.

— Gjysh!

— Çfarë, i dashur?

— Asgjë. Natën e mirë!

— Hajde këtu! Ti deshe të më pyetje për diçka, ë? Pyetëm, mos u tremb. Nga gjyshi druhesh? Ç'janë këto budallallëqe?

— Doja të të pyetja...

— Pyetëm, pyetëm!

— Doja të të pyetja, mos ka midis engjëjve

ndonjë djalë jo të pashëm? Ai s'është i këtushëm,  
nuk e di gjuhën....

— Më?

— Edhe atij njëlloj i japin qumësht?

— Po, natyrisht! Ti pse merakosesh për të?

— Si thua, a i japin qumësht?

— Po ti, si kujton, mos e lënë të vdesë urie?

Si e quajnë mikun tënd?

— Shyqyri.

— Shyqyri?... Turk është?

— Turk...

— Shko, i dashur, mos u merakos dhe fli i qetë.  
Shokun tënd atje lart e ushqejnë si vezir. Dëgjomë  
mua.

— Falemnderit, gjysh. Falemnderit!....

Unë vrapova dhe qava midis kallamishtave. Kur-  
se yjet më ndriçonin rrugën. Në qiell ka plot qu-  
mësht, ai u mjafton gjithë fëmijëve, edhe turqve,  
edhe grekëve.

## KAPITULLI I DHJETË

Këtë të shtunë vendosa të mos shkoja në qytet. Unë doja të punoja edhe këtë të diel, edhe gjithë javës tjetër dhe vetëm pastaj të kthehesha në qytet me xhepin plot.

Po për këtë duhej kursyer. Nisa të ndiqja sistemin e Jovanisit (domate, specë, patëllxhane) dhe barku im kërciste, më gërryente nga puna e lodhshme dhe uji i lumit.

Njëherë, kur u përkula mbi lumë për të pirë, unë pashë në fund të lumit ca qenie të vogla, që u ngjanin omarëve, që cimbinin copra buke. Unë i thirra Kristaqit:

— Kristaq!

- Ç'ke?
- Hajde të shikosh ç'qënie të çuditshme!
- I kam parë. Janë gaforre.
- A hahen?
- Ëhë!
- Po pse nuk i gjuan?
- Sepse nuk i ha. Nuk më pëlqejnë.
- Po si i kapin, Kristaq?
- Me duar.
- Si kështu, me duar?
- Shumë thjesht. I nxjerr duart nga xhepi dhe i fut në ujë. I nxjerr gaforret, i hedh në zjarr, pastaj i merr dhe i ha.
- Po sikur të të pickojnë?
- Ato nuk të pickojnë, po të hanë.
- Gishtërinjtë?
- Jo, bukën.
- Po sikur të mos kenë bukë?
- Gaforret.
- Kë?!
- Gaforret.
- Po çfarë mbetet?
- Gaforret.
- Po ato hanë njëra-tjetrën?
- O-oh, e ç'budalla që më je ti! Nuk e di. Shko pyet mësuesin!

Diçka i ka ndodhur këtij sot. Ndodh që vë mbi vesh një degëz dhe këndon gjithë ditën... Kurse tani rri-rrri dhe pështyn mbi baltë. Dhe mërmërit: Nëna ime... nëna ime» ... «Ç't'i ketë ndodhur vallë?

Përzierësi i shëmtuar, miku i tij më i afërt, më tha se Kristaqi ka një brengë të madhe në shpirt.

- Sëmundje është kjo? — e pyeta unë.
- Edhe sëmundje... edhe jo sëmundje...
- Si kështu, sëmundje, apo jo?
- E vogël, do t'i kalojë.
- Ç'i ka ndodhur? Hajde ta pyesim.
- Ai nuk ta tregon.
- Pse nuk e thotë?
- Ka brengë, prandaj nuk e thotë.

Kështu, për herë të parë unë mora vesh se «brenga» është një sëmundje, për të cilën është bërë zakon të mos flitet.

Sëmundje të çuditshme kanë këta tullaxhinjtë.

— More, — i drejtohem përsëri unë përzierësit, — a ka bar për këtë sëmundje?

— Çfarë bari?

— Ja, bar... mjekim.

Përzierësi nisi të kruante qafën. Ai nuk po kuptonte.

— Ja, e di, një gjë e tillë, — përpiqem unë t'ia sqaroj. — e hidhur, atë e pinë dhe shërohen.

— A, ilaçe ....mjekim....

— Epo! Ilaçe! Po pse, nuk ka ilaçe për të shëruar brengën?

— Hëm... nuk e di. Jo.

E, ç'bela! Dhe kjo i duhej Kristaqit, të sëmurej nga një sëmundje e tillë, për të cilën nuk ka as ilaçe! Ç'fatkeqësi!....

Unë po e vështroja së largu Kristaqin, duke u përpjekur që ta kuptoja sëmundjen e tij. Sytë i ishin ndryshuar krejt.

Këtë e vura re. Ato nuk ishin më sytë e tij. Më parë Kristaqi i kishte sytë të kaltër, të qartë si qielli, të ngrohtë. Kurse tani i kishte të egër dhe

të ftohtë, si rruaza. Kishe frikë bile dhe t'i afroheshe Ata sy besoj se nuk do të më njihnin dot. Keq... Kurse unë sapo e kisha mësuar mënyrën se si t'i zija gaforret. Po, këtë mënyrë e kisha shpikur unë vetë. Si t'ia tregoja atij këtë? Sytë e tij si rruaza do të më largojnë tutje. Prandaj unë as që iu afrova.

Po në mbrëmje ndodhën ca gjëra. Një njeri që po kalonte rrugës kaluar mbi gomar, papritur u kthye nga kumaxhinjtë. U afrua dhe pyeti:

— Ku është Kristaqi?

— Ja ku e ke, — u përgjigj përzierësi dhe tregoi me dorë mikun tim, i cili ishte ulur, mbështetur në një furrë të shuar, dhe ndukte gishtërinjtë, i menduar.

— Ej, ti! — i thirri i porsaardhuri.

— Hë?... — i përgjigjet Kristaqi dhe sytë e tij bëhen edhe më të ftohtë.

— Merre këtë, — thotë i porsaardhuri. — E ke nga Rinka.... — Dhe fut dorën në torbë për të nxjerrë diçka prej andej.

Po Kristaqi nuk priti më. Ai u sul drejt fshatarit, e zbriti nga gomari dhe gati sa s'i mori frymën, sikur ai të mos ishte ngutur të nxirrte nga torba atë që kishte sjellë.

Atëherë ne të gjithë e pamë se ç'ishte ajo. Trëndafil. Përreth çdo gjë sikur u bë më e shndritshme. E shkreta Rinka!... Ajo nuk dinte të shkruante dhe ja ku i kishte dërguar Kristaqit trëndafil! Çfarë dhurate e bukurl...

Kristaqi u shërua papritur. Sytë e tij u ngrohën përsëri.

— Gënjeshtar! — iu hakërrova unë përzierësit.  
— Ti the se për sëmundjen e Kristaqit nuk ka ilaçe. Po kjo ç'është? Hë?

— Ka! — u përgjigj me gëzim përzierësi.... Ai u gëzua aq shumë, saqë ishte gati t'i bënte copa të gjitha tullat.

Dhe, megjithëse mua nuk më mësoi njeri si t'i gjuaja gaforret, unë vetë e gjeta mënyrën se si duheshin zënë. Këputa një kallam, ia qërova fletët dhe ia mpreha majën, aty vura një copë bukë dhe e lëshova në ujë. Dorën tjetër e mbaja gati. Sapo gaforrja përpiqej ta kapte bukën me këtrë, unë — fap, e tërhiqja. Atë ditë zura shtatë copë. Po mua më duhej të zija njëzet, që t'ia çoja gaforret Siikës dhe t'i thosha: «Këto janë për ty». Dhe të mbushesha me krenari.

Unë i mbështolla gaforret në shami dhe fjeta. Kurse gjatë natës ato ngordhën të gjitha. M'u duk sikur më vdiq diçka përbrenda vetes. Këtë lajm të hidhur ma solli Kristaqi.

— Ej, Menelo, çohu! Gaforret e tua ngordhën.

Ah, këto gaforret nuk patën fare durim. Tani unë as që mund t'i haja ato — Kristaqi nuk ma këshillonte një gjë të tillë.

— Nuk bën t'i hash, Kristaq?

— Jo, sepse ato ngordhën.

— Po si hahen ato?

— Kur i sajdisin të gjalla.

Në këto fjalë, ai i hodhi gaforret në lumë.

Metoda ime ishte e papërshtatshme, duhej patjetër të shpikja një tjetër. Mua m'u kujtua Pjetër-biska, që hodhi pas barakës një poçe të thyer, në të cilën më parë përziante fasulet. Unë e lava atë,

e mbusha me ujë dhe atje vura gaforret e zëna. Kështu ua shpëtoja unë jetën atyre. Ndodhte që ngordhte ndonjë e dobët, po që se unë harroja t'ia ndërroja ujin.

Java e dytë po mbaronte. Gaforret në poçe u shtuan. Por, njëllor si katërmbëdhjetë ditë nuk bëjnë pesëmbëdhjetë, ashtu dhe në poçen time nuk futej më tepër as edhe një gaforre. Kishte ardhur tamam koha për të ikur.



## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Erdhi e shtuna. E çuditshme ishte dhe kjo e shtunë. Bile e gjithë java ishte një përtace e keqe. U zvarrit duke u shkundur si një dyzetkëmbësh, kurse në bisht i varej e shtuna. Dhe dielli që kishte sjellë këtë të shtunë, ishte aq përtac, saqë dukej sikur e kishte tërhequr me tërkuzë.

Po sidoqoftë deshi dielli, apo jo, javës i erdhi fundi.

Të gjithë ata që kishin ndër mend të shkonin në qytet, atë ditë punuan gjithë ditën, pa pushim, pa «shabash» — siç kishte urdhëruar padroni. Kjo ishte në dobinë tonë. Ne njëloj do të punonim në

kohën e drekës, me qëllim që ta mbaronim punën më parë se të perëndonte dielli.

Por diçka po më mundonte që nga mëngjesi. Jo uria. Ajo «diçkaja» ishte padroni ynë, Pjetër-biska. Gjatë gjithë ditës ai as edhe një herë nuk i çeli sytë. Që të ishte i sëmurë, as edhe njërit prej nesh nuk i shkonte ndër mend, askush prej shokëve të mi nuk shqetësohej për këtë.

Dje ai u kthye nga qyteti, i shëndoshë si një ka. Ai kishte shkuar për të tërhequr paratë. As edhe njërit prej nesh nuk i tha as «mirëdita», as «tungjatjeta»! Hyri në barakë, numëroi dhe rinumëroi paratë larg syve të njerëzve, pastaj doli jashtë, u shtri dhe dremiti me një gjumë prej të vdekuri.

Sot në mëngjes ai i çeli sytë për një çast, na numëroi ne, përsëri i mbylli sytë dhe dremiti me një gjumë prej derri, thua se nuk kishte fjetur një jetë të tërë.

Mizat shëtitnin fytyrës së tij, duke i thithur dhjamët. Kohë më kohë ai shfrynte si kuajt dembelë dhe i largonte ato. Po ato përsëri ktheheshin, edhe më të ashpërsuara. Pjetri pështyu dhe u dha liri të plotë atyre — hani sa të doni. Ai flinte paq, duke tërhequr gjumin, ashtu siç thith me kënaqësi çibukun pashai.

— Po dhe kjo nuk po e davariste frikën time. Unë vendosa të shkoja te Kristaqi, që i dinte të gjitha.

— I sëmurë është ai? Është i sëmurë rëndë, ë, Kristaq?

— Kush — foli me neveri Kristaqi. — Biska? Po pse, sëmuren ndonjëherë derrat?

— Po pse ka kaq kohë që po dremit?

— Ha! Ai është i kënaqur! Sepse ka marrë shumë para. Është rritur në treg çmimi i tullave. Një dhrahmi copa.

Tani unë mbeta i kënaqur.

— Kështu? Kjo është një gjë e mirë. Domethënë se ai do të na paguajë më tepër.

Duke dëgjuar bisedën tonë, tullaxhinjtë tundnin kokën pleqërisht, duke shprehur dyshimin e tyre.

— Mos u mpreh, — tha Jovanisi dhe shkeli me këmbë pështymën.

Unë e tërhoqa Kristaqin për mënge.

— Hajde të bëjmë zhurmë, ta zgjojme atë, ta provojmë në është i sëmurë.

Jovanisi më vështroi që poshtë syve.

— Ai është shëndoshë e mirë, zevzek, mos ki frikë! — tha ai me të rreptë.

— Ti ke të drejtë, xha Jovan... Po megjithatë, hajde t'i kërcasim kallëpet, teneqetë. Ta verifikojmë. E çfarë do të humbasim?

— Ha-ha-ha! — qeshën përreth. — I shkreti jabanxhi, ti je fare budalla. Po pse, ky derr do të zgjohet nga zhurma? Ai do të flejë akoma më mirë.

— Po çfarë mund ta zgjojë atë, xhaxhi?

Ai nuk u përgjigj. Vetëm se i përfshiu me një vështrim të qetë dhe të ashpër të pranishmit, si një strateg i madh.

— Çfarë?

Tullaxhinjtë ia ngulën sytë në mënyrë pyetëse atij.

— Shabash!') — tha prerë Kristaqi.

---

1) Pushim.

Të gjithë ngrinë në vend, thua se presa e bris-  
kut rrëshqiti mbi grykën e secilit. Unë prita se  
ç'do të ngjiste më tej. Vëmendja e të gjithëve ishte  
përqëndruar te Pjetri, te hunda e tij, që ziente  
si tigani në zjarr. Por nuk kaloi as edhe një minutë,  
kur papritur heshtja u prish.

— E-e! — mërmëriti egërsisht i sëmuri. — Pu-  
noni! Punoni.....

— E shikon, o budalla? Fërt!... — Tani ai u  
thirri tullaxhinjve: — E-e! Punoni!

— Budalla!... — thanë dhe gjithë të tjerët.

Dhe përsëri ia nisën punës. U përkula dhe unë  
mbi kallëpin tim, duke e ndier veten si një qen  
të rrahur.

Tullaxhinjtë kanë të drejtë. Ata e njohin për  
bukuri biskën e tyre. Ia dinë mirë të palarat.

Unë u përkula edhe më thellë. Fytyra e fëlli-  
gur e baltës gjithashtu dukej se më përqeshte:  
«Budalla!»

## KAPITULLI I DËMBËDHJETË

Dielli po ecte ngadalë në formë rrethi, si rrota e arabasë, që e tërheqin buajt e përgjumur.

Stomakët tanë kishin kohë që thërritnin «shabash», po askush s'po vendoste të shkonte te shelgu dhe t'i binte bidonit. Fjala është fjalë: drekë sot nuk duhet të ketë. Kush do të shkojë në Vodenë, duhet ta mohojë «shabashin». Tullaxhinjtë e mbajnë fjalën e dhënë.

Ata mund të dërrmohen, por fjala e dhënë mbetet në fuqi. Këta miqtë e mi e kanë zemrën të pastër, prandaj janë dhe tullaxhinj...

Çdo mesditë të shtune ata mbeteshin të uritur. Biska ishte i papërkulur. «Në qoftë se ata do të ha-

në, — arsyetonte padroni, — do të dembelosen dhe nuk do t'ua zëjë syrin puna. Ariu i uritur natyrisht që nuk vallëzon, po dhe i ngopuri gjithashtu.... fle. Të uriturit punojnë më egërsisht». Këtë regjimin e tij — nuk e di se si e kanë të tjerët — po unë nuk kam forca ta duroj.... Vodena! Mua më duhej të duroja. Përndryshe, ç'kuptim kishin tërë ato plane që kisha në kokë? Pse kisha grumbulluar gjithë ato gaforre të zëna në lumë?

Mua po më dridheshin gjunjët....

Dhe në një çast i lashë të gjitha mënjanë... Edhe planet, edhe udhëtimin.

— Shabash, — thashë unë i dërrmuar. E hedh kallëpin mënjanë dhe drejtohem nga hija.

— Ej, muhaxhir! — thërret biska.. — Ç'punë ke atje?

— Shabash, — i them unë. — Do të bëjmë shabash....

— Ti nuk do të shkosh në Vodenë?

— Jo.

— Mirë...

Dhe përsëri u shtri në kurriz. Ai kishte ngrënë dhe tani po treste ushqimin.

Unë u lava në lumë dhe nisa të haja.

Por, pa arritur akoma t'i shtroja para vetes zarzavatet, pa e kapërcyer akoma kafshatën e parë të bukës, u dëgjua zëri i nevrikosur i padronit:

— Ej, muhaxhir!

— Çfarë?

— Puno!

Unë ia ngula sytë si një budalla, pa kuptuar gjë.

Atëherë ai u ngrit, iu afrua bidonit për t'i rënë.

— Puno! — thërret ai prerazi. Dhe, duke e parë se unë përsëri nuk po e kuptoja, më fut në hundë gishtërinjtë e tij të fëlliqur: — Dy e gjysmë!

Po, ai ka të drejtë. Rregulli është rregull: dy e gjysmë është mbarimi i punës.

«Shabashi» vazhdon një orë. Unë nuk pushova as edhe pesë minuta.

Po ç'rëndësi kishte kjo për biskën? Ai bënte programin e vet.

Unë futa në gojë një copë të madhe dhe u ktheva në punë. Tullaxhinjtë ishin memec, si peshqit..... Papritur, njëri prej tyre zgjati dorën dhe mori një copë baltë. E shtrëngoi fort. Në grushtin e tij ajo shndërrohet në gur. (Ku do ta hedhë?)

Jovanisi, me një goditje të kazmës, rrokullis në pellg një lëmsh të madh balte. Kristaqi nxehet, nxehet më shumë. Sytë i përshkënditin... (Diçka do të ndodhë, po ç'do të ndodhë?)

— Mjaft! — këlthet ai si një egërsirë. Dhe e hedh tutje lopatën rreth nja pesëdhjetë metra!

— E — ej! — thërret ai. — Dreka!

Të gjithë i hodhën tutje me zhurmë veglat; kjo ishte si një goditje në shpinë për biskën.

— Dreka! — thirrën këmbëngulës të gjithë tullaxhinjtë.

Si do të veprojë tani ai derr? Ai u kthye, vështroi... Dhe papritur atë e mbërtheu një gjumë i thellë, ai gërhiste në mënyrë të tillë, sikur nuk kishte fjetur pesë net rresht (dhelpra!...)

Ne shkuam grup në lumë, duke u kollitur si për t'i dhënë rëndësi vetes. Pasi u lamë, shkuam te te-

shat tona, nën strehën metalike për të ngrënë. Dhe aty diçka ndodhi në kantierin tonë. Dhjetër fshatarë të lodhur e të rraskapitur me trastat kra hëve dolën që matanë rrugës, kapërcyen trasenë dhe u ndalën para barakës së biskës. Ne ngrimë në vend.

Biska po i ndiqte me sy ata që poshtë vetë llave të tij të ngrysurat.

Njëri prej të ardhurve, më i forti, i kaloi tjerët dhe ndaloi përpara padronit.

— Çfarë do? — e pyeti Pjetri.

— Punë....

Biska kridhet në gjumë. Të gjithë presin, duk mbajtur frymën.

— Nuk ka! Nuk ka!....

Fshatarët i kthyen kurrizin dhe ne i pam se sa të gërmuqur dhe të lodhur ishin ata.

Papritur biska ngrihet me rrëmbim, sikur t shtynte era, dhe vrapon nga bidoni. Rrëmben shk pin dhe me gjithë forcën e tij prej derri e god atë.

— Filloni punën! — thërret ai me një zë t egër.

Ne vështruam njëri-tjetrin. Vështruam kurr zet e përkulura që po largoheshin.

— Ej, - ej! — çirret biska dhe afrohet nga disa hapa. — Tani ka ndonjë që do të hajë? Do ndonjëri të hajë?

— Jo, — përgjigjemi ne. — Dhe kthehemi n punë.

Pas një ore, nga lodhja nisën të na errësohe sytë. Vapa, siç dukej, kishte lidhur marrëveshje me biskën. Dielli digjte si ujërat termale të Pozz



rit. Djersa e nxehtë kullonte prej nesh si lëngu i mishit në hellin e skuqur. Dielli lartësohej, hidhte gjilpëra të zjarrta në lëkurën tonë dhe përsëri fshihej në qiell, duke bërë sikur s'kishte punë me asnjë.

Dielli djeg, kurse ti punon, punon, si një mekanizëm sahati. E kurdisim atë një herë në ditë dhe ai punon gjithë ditën....

Kurse atje, mbi një degë të lartë, është kambana jonë, është bidoni i vajgurit; goditje pas goditjeje na e numëron ai jetën tonë.... dhe ndryshohet së bashku me të.

Baltë, baltë, kurse dita është e madhe. Baltë, kurse dita është e gjatë. Baltë dhe vetëm Pjetri është i kënaqur!

## KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Petër-biska numëron. Afrohet e shtuna dhe a bën numërimin. Pasi i ngre fitimet e majme, bisk i çon ato në barakë dhe nis të numërojë. Sytë e t të fryrë nuk çelen dhe ai i ngre vetullat me gisht. Ai numëron...

Pas njëfarë kohe, kur neve na sosit fare durimi, ai nis të thërresë njerëzit njërin pas tjetrit, që t'u bëjë pagesën.

— Jovanis Cepkenxhi! — thërret ai.

— Hop! — përgjigjet Jovanisi. E lëshon me zhurmë lopatën përtokë, fshin duart e fëlliçura për rrobash, merr paratë, i fërkon për mjekre dhe

thotë: «Birinxhi». Pastaj zberthen xhokën dhe i vë paratë në xhepin e brekusheve.

Erdhi dhe radha ime.

— Muhaxhir, — thirri Petri.

Unë u afrova. Në gjunjët e padronit ndodhej një fletore e fëlliqur, të cilën ai po e studionte me një pamje të rëndë. Unë u përkula, duke u përpjekur të shihja se ç'germa po nxirrte derri. Po nuk mora vesh gjë. As germa, as shifra. Vetëm ca shenja qesharake, nga ato që lënë pulat në pisllek — kryqe, pika... E ç'germa!

— Kështu, — foli ai dhe pështyu lapsin.

Për të nxjerrë shënimin, atij iu desh të pështynte gjashtë herë lapsin. Më së fundi, pasi e rumbullakosi me lapës shenjën ku tregohej emri im, ai e futi dorën në një shtambë të thyer (arka!), nxori që andej shumën e llogaritur, i numëroi edhe tri herë të tjera dhe i hodhi paratë në pëllëmbën e tij të gjerë.

— Merri, — dhe m'i dha mua. Unë i mora. Po, sapo u ktheva për të ikur, biskës diçka iu kujtua dhe më thirri përsëri.

— Ej, muhaxhir! — thirri ai. — Dëgjo, më jep këtu tri dhrahmi.

Ja, ç'punë dreqi!

— Pse?

— Ti je larguar nga puna tri herë!

— Unë?

— Jo, prapanica jote! Nxirri tri dhrahmitë!

— Unë nuk jam larguar, Petër. Unë kam shkuar të pi ujë.

— Të pish? Po pse, ishte bërë pushimi?

— Jo.

Çfarë mund t'i thosha? Unë ia ktheva të tri dhrahmitë.

— Kalo, shpejt. Dhe thirr tjetrin.

Gjaku i hipi në kokë Kristaqit.

— Magjar<sup>1)</sup>, — mërmëriti ai nëpër dhëmbë.

Pas një ore të gjithë u qetësuan. Veglat e punës pushonin, të mbështetura në murin e barakës, si fëmijët, të cilët kanë vallëzuar jashtë masës. Kristaqi se ku u zhduk. Po ja ku erdhi përsëri. Ç'burrë i mirë! Ai shkoi për gjueti. Dhe u kthye me duar plot.

— Menelo! Unë të kam sjellë gaforre!

— Po unë kam. Një poçe plot.

— Pa he, t'i shikojmë.

Ai fut dorën në poçe, nxjerr prej andej dhjetëra gaforre dhe i zëvendëson me të tijat.

— Ato akoma janë të vogla, — thotë ai, — unë po i çoj te nënat.

Shkoi dhe i hodhi gaforret në lumë — le të kërkonjë nënat e tyre.

Njeri i çuditshëm është ky Kristaqi....

Unë u bëra gati për rrugë, si një udhëtar me përvojë. Me torbën krahëve dhe me poçen në rrjetë.

Të gjithë i dhanë lamtumirën njëri-tjetrit: «Qofsh shëndoshë». Të gjithë buzëqeshnin si fëmijët, duke e fshehur buzëqeshjen nën mustaqet — kush i kishte ato, mustaqet... Vetëm fëmijët nuk kishin ku ta fshihnin buzëqeshjen e druajtur, megjithëse ata do ta donin një gjë të tillë.

Secili shkoi në rrugën e vet. Disa andej nga del dielli, të tjerët në jug. Mua më mundonte diçka:

---

1) Kërric.

ku do të shkonte arixhiu? Duhej gjetur ai, që të shkonim bashkë, dhe atëherë ai, dashur padashur, do të fjalosej me mua. Unë shkova te vendi i tij në kallamat, por atje s'gjeta njeri. Arixhiu kishte shkuar kushedi se ku, kishte ikur përgjithmonë. Ai u tret si një flutur e vogël, që nuk tërheq njeri. Ai mori me vete torbën e vet plot me gjëra të vjetra dhe zemrën e vet plot hidhërim... Ai iku dhe nuk do të kthehet më.

Kristaqi më shoqëroi deri në rrugë. Udha e tij ndodhej në anën tjetër.

— Hajde, Menelo, gjithë të mirat! Të dielën fli mirë dhe të hënën hajde me forca të reja.

Unë u nisa mengadalë për rrugë, duke kënduar këngë dhe duke tundur, si të ishte rakeçake, poçen me gëforre.

M'u kujtua se në gjysmën e rrugës ndodhej një burim me ujë të ftohtë. Ishte tamam koha që ta lagia fytyrën që më ishte zhuritur, si të kisha për-typur spec djegës.... Ja më së fundi ku mbërrita!

## KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Nuk isha vetëm unë që po nxitoja për te burimi. Dikush po dukej që atje larg. Një djalë i zeshkët rrinte mbi një gur si një kërcu. Arixhlu! Në fillim u tremba. Mua m'u kujtuan frikësimet e kuqos. Po sikur papritur të infektohem nga sëmundja e lëkurës? Po, pasi arsyetova si duhej, unë mendova se kjo nuk ishte e tmerrshme. Sepse, në fund të fundit, lëkura e zezë nuk është zgjebe. Por, që të qetësohesha përfundimisht, më duhej të sqarroja edhe diçka tjetër. Lëkura e zezë në vetvete nuk më trembte dhe aq shumë. Pse, lëkura e zezë nuk është lëkurë? Ishte diçka tjetër që më frikësonte. Si e shikon botën arapi? Ja çfarë do të doja të dija me

përpikmëri. Po, kjo më trembte me të vërtetë mua. Ta shikosh gjithçka të zezë si blozë! Miellin të zi, dëborën të zezë. Siikën të zezë.

Unë u përkula për të pirë, i sfilitur nga etja kapitëse. U dhashë të pinin dhe gaforreve. Papritur gjithçka m'u ftoh përbrenda nga mendimi i frikshëm: po sikur aty përpara meje të kishte pirë arixhiu? Po tani ishte vonë. Ç'ishte për t'u bërë, u bë. Unë vështrova duart e mia... Ato ende ishin të bardha. Do të nxihen, besoj, më vonë.

Aty pranë u dëgjua një zhurmë. Arixhiu u ngrit mengadalë dhe u nis për rrugë.

— Shyqyri!... (Unë fola kështu? Si më doli kjo fjalë? Po ç'ishte për t'u bërë, u bë. Ajo që u tha, nuk mund të kthehej).

Arixhiu u kthye. Desha ta qetësoja atë me ndonjë shenjë ose gjest. Por nuk më erdhi asgjë ndër mend. Vetëm se qesha. Ai m'u përgjigj po në atë mënyrë. Ne nuk dinim ç'të bënim më tej dhe vazhduam të qeshnim. Por dikur unë duhej t'i jepja fund kësaj dhe të flitja. Përndryshe arixhiu do të shkonte rrugës së vet dhe unë nuk do ta shihja. Domethënë duhej gjetur ndonjë mënyrë. Duhej gjetur patjetër.

— Qëndro! — i thirra unë dhe ndala dhe vetë. — Pse po ikën? — e pyeta me një ton të butë sa munda. Dhe përsëri qëndrova. Arixhiu e lëshoi trastën përtokë dhe nuk dha asnjë përgjigje. Domethënë ai buzëqeshi — kjo ishte njëfarë përgjigjeje.

— Pse po ikën, Shyqyri? — i thashë unë me një zë më të fortë. — Pse po ikën? Shiko, po unë jam miku yt... arkadash. Më lër të ta shtrëngoj dorën. Hajde! (Ne i shtrëngojmë njëri-tjetrit dorën). Unë

picërrova sytë. E shkreta dora ime, ç'do të ngjasë me të!) Më jep dorën, Shyqyri! (Le të ndryshojë dora ime e djathtë nga e majta. Kur të rritem, do të mbaj dorashka).

Arixhiu më shikonte me shpresë dhe tmerr, si qeni të cilit i zgjatin bukën dhe ai nuk e di nëse do t'ia japin ose do ta godasin. Ai deshi ta zgjaste dorën, po në çast e tërhoqi mbrapsht. Në fund të fundit ai mori vendim. Ai gjithashtu mbylli sytë dhe fshihi pëllëmbën. (Çudi, ajo ishte e bardhë!)

— Tungjatjeta! — tha ai. Dhe buzëqeshi.

Dhëmbët i kishte të bardhë, si lule maji.

— Ku po shkon, Shyqyri?

Atij i pëlqen ky emër. Kushedi? Mbase ai kujton se Shyqyri do të thotë vëlla. (Po pse vallë, nuk ka këtë kuptim?).

— Po iki, — tha ai dhe buzët iu drodhën.

— Ku po shkon?

Ai mbledh supet.

— Nuk e di... Po iki.

— Po shtëpi, a ke?

— Jo...

— Po nënë, babë, motër?

— Jo, jo, jo...

Një mendim i rëndë, si reja, na pllakos dhe na shtyp të dyve. Fletët e pemëve na kujtojnë flutura, të ngjitura për gëmushë. Unë ofshava.

— Shkojmë... Po! Këtë po ta them unë, Shyqyri, shkojmë...

Unë e tërheq atë për bërryli.

Arixhiu hesht dhe mban veshët hapur. Pastaj zëri im depërton në zemrën e tij. Ai përkulet dhe merr trastën. Ne ecim pranë e pranë, si nikoqirë të



pavarur, të cilët shkojnë në shtëpitë e tyre dhe çojnë rrogën. Unë, me poçen hedhur mbi sup. Arixhiu, me ca lecka hedhur krahëve. Po, siç dukej, ato lecka ishin të shtrenjta për arixhiun! Ai bënte ç'bënte dhe kthehej e shikonte prapa se mos i kishte rënë ndonjë copë...

Tani që ne po shkonim pranë e pranë, unë vura re se të dy me Shyqyriun kishim një shtat. Edhe ai i ka sytë si unë, në ngjyrë mjalti. Vetëm se lëkurën e ka pak të zeshkët, po vetëm fare pak.

Nisi një bisedë e këndshme, miqësore. Ne qeshnim dhe bënim gjithfarë gjestesh; ai seç më tregonte në një greqishte të çalë; unë i përgjigjesha në po atë mënyrë. Kjo na shkonte për bukuri.

Tani ne po flitnim duke i qarë hallin njëri-tjetrit. Ishte tamam koha që t'i bëja pyetjen që më shqetësonte shumë: do të nxihem unë, apo jo? Sepse pikërisht kështu më tha — dhe bile u betua — ai kuqoja: «Edhe ti do të bëhesh i zi!» Unë e ndalova Shyqyriun nën një pemë të madhe:

— Është e vërtetë?

— ?...

— Ajo që të thashë.

Arixhiu më shikonte si një kërcu i zbërdhulur, që ndodhet në mes të rrugës.

«Ajo që të thashë... Ah, po. Ti ke të drejtë, unë nuk të thashë asgjë». (Si ta them unë këtë? Dhe a mund ta them?)

— Është e vërtetë se edhe unë do të nxihem?

Supet e tij të dobëta përgjigjen: «Nuk e di».

— Ty, Shyqyri, kurrë... nuk të ka qëlluar deri tani të kesh shokë me një ngjyrë lëkure tjetër? Ja, si kjo imja.

— Jo.

— Pse?

Supet e dobëta përsëri përgjigjen: «Unë nuk kam faj».

— Domethënë, ti thua se nuk do të nxihem?

— Nuk e di...

Dhe papritur... nën kapelën e flokëve kaçurrelë të shpupuritur lindi një pyetje, së cilës do ta kishte vështirë t'i jepte përgjigje dhe vetë mësuesi.

— Në qoftë se ti do të nxihesh, pse atëherë nuk zbardhem dhe unë?

Po kjo ç'na qe! Me të vërtetë! Unë u gëzova. Unë sa s'luajta prej gëzimit! Papritur më lindi dëshira të vrapoja për te pema e rrëzuar, pranë së cilës ne po kalonim, ta çoja peshë atë dhe t'i tregoja, t'i tregoja asaj, që ta merrte vesh edhe ajo.

— Por...

Gëzimi im përsëri u zbeh. Plaga e vogël që kishte zënë vend në shpirtin tim, më pickoi rëndë.

Kjo është një gjë e mirë, po sidoqoftë, a do të ndryshojë ngjyra e lëkurës sime?

Unë e vështrova këmishën e tij tepër të fëlliqur. Ja, asaj po i dilte boja! Çfarë do të ngjasë? Por tani është vonë! Ashtu qoftë. Për gjithçka duhet vendosmëri. I zi, ashtu qoftë, i zi. Ç'të bësh? Se mos arapët ecin me kokën poshtë! Ja ku e keni Shyqyriun. Merrreni, zbardheni atë. Dhe ai do të bëhet një njeri i tillë, një helenas i vogël, si të gjithë, bile më i mirë! Me kaq mori fund, pikë.

Po sikur të zinjtë ta shohin botën të zezë, si i bëhet? Ja ku është halli.

Këmbët e mia ngecën në vend, megjithëse s'ki-

shte as edhe një shenjë balte. Dukej sikur më kishin bërë copa-copa dhe më kishin shpërndarë rrugës.

Shyqyri, Shyqyri, ç'hall i madh më ka zënë! Unë nxora shaminë e u përpoqa të ndal lotët. Ari-xhiu gjithashtu qante. Unë jam i zi e qaraman. Ai gjithashtu është i zi e qaraman. Të dy qajmë... Shamia u bë qull. Shamia ime... Shyqyri!!!

— Shyqyri, shiko, shiko këtu. Kjo shami, ç'ngjy-rë ka? Thuaj shpejt.

— Të bardhë!

— Ah, Shyqyri, arixhi, sa i bukur që je ti, sa bardhosh që më je.

Unë qaja nga gëzimi, si një fëmijë, i cili ka kohë që sorollatet pyllit dhe që papritur e gjen shtegun.

— Falemnderit, Shyqyri, falemnderit. Shumë shumë!..

Ne u përqaftuam dhe ecëm së bashku. Dy shokë arixhinj.

Shyqyriut iu zgjidh gjuha. Ai përfundimisht u bind se gjeti një shok dhe mund t'i tregonte atij gjithçka, pa i fshehur gjë dhe pa pasur frikë: për shar-jet e panumërta, për lëmshet që i vinin në fyt, se si silleshin me të atje, në gropën e baltës. Sytë e tij ngjyrë mjalti nuk mund t'i shikonin më ata nje-rëz dhe ai u arratis nga kënetat. Përndryshe, zemra e tij do të rëndohej nga hidhërimi.

«Pufte, pufte», — vetëm këtë fjalë dëgjonte me ditë të tëra... Çfarë i mbetej të bënte? Ai mbledhi leckat dhe ia mbathi prej andej me këmbët e tij të zeza.

Ku do të gjejë ai punë?

Dielli i kishte mbledhur fijet e tij nga të gjitha

arat, i mbështolli ato në një lëmsh dhe iku nga rru-  
ga malore. Qyteti ishte akoma larg. Po ne nuk kishim  
pse të nguteshim. Ne ecnim rrugës sonë pa u ngutur,  
ecnim pranë e pranë. Fit, fit, ia bënin në ecje, lehtazi,  
këmbët e zbathura të arixhiut.

Mua më duhej të vija veshin që të mund të dë-  
gjoja këtë zhurmë. Drita kishte mbetur prapa, ne  
po i futeshim natës si dy zogj që çajnë renë. Tani  
ishte vështirë të përcaktoje se ku ishte arixhiu. Ai  
dhe nata u tretën në një. Nata e zezë dhe djaloshi i  
zi.

Tani nuk dëgjoja më as hapat e tij — toka  
ishte e butë.

Që të bindesha se ai ishte afër meje, unë bëja  
ç'bëja, zgjatja dorën dhe e prekja.

Kur atje larg u duk qyteti, që po lundronte si  
zjarr pylli, më së fundi vendosa të bëja atë që kisha  
kohë që po e sillja nëpër mend: t'i jepja një kujtim  
mikut tim Shyqyri.

Mengadalë e me kujdes hoqa ose më mirë shqi-  
ta nga vetja ime xhaketën gri.

— Shyqyri, — drejtohem unë në errësi, andej  
nga mund të ndodhej arixhiu. — Na, merre. Unë atë-  
herë... (sytë e mi u mbushën me lot). Atëherë së ba-  
shku me festen unë desha të të jepja edhe këtë,  
por nuk arrita. Merre tani, Shyqyri, dhe kujtomë kur  
t'i gëzohesh të ngrohtit.

Atij, siç duket, i vjen rëndë. Përndryshe, pse  
nuk e merr?

— Merre, Shyqyri! (Kap me dorë ajrin). Shy-  
qyri! (Duart e mia kapin zbrazëtirën). Shyqyri, Shy-  
qyri...

Asnjë përgjigje... Qetësi... Vetëm shpati përkarshi më dërgoi mbrapsht jehonën, emrin e hidhur të mikut tim. Arixhiu i zi u tret, atë e gëlltiti heshturazi nata.

Kush ishte ai arixhi? Nëpër jetën time kaloi një shpirt i vogël, i trembur, i mbështjellë në një cipë të zezë. Pa emër, pa gjini... Ai lëkurëzi e përzjeu djersën e vet me atë baltën që e kisha përzier edhe unë, dhe ja, sot ra nata, e mbështolli me pelerinën e zezë dhe e çoi tutje.

Kush ishte ai arixhi? Unë nuk e pashë kurrë më, kurrë dhe asgjekundi. Vetëm netëve, kur bredh i vetmuar, dëgjoj fërkimin e këmbëve të tij të zbatthura (fit, fit...) dhe shikoj hijen e tij, që ecën pranë meje, e njëjtë për nga madhësia me hijen e mikut tim të vrarë, Shyqyriut.



## KAPITULLI I PARË

Unë hyra në qytetin e kredhur në terrin e natës. Dhe menjëherë lindën telashe dhe halle të tjera. Në fillim Pejosi. Sahati ishte kujtimi i gjallë për Pejosit. Dhe pastaj diçka tjetër, që i shtyu mënjane të gjitha të tjerat.

Siika!

Rrugës takova postierin plak, veshur me shallvare. Ai tërhiqte pas vetes një gomar të ngarkuar me fruta dhe po më mbushte mendjen të blija dhurata, duke më përshkruar gëzimin që do të sillnin ato.

Unë e pyeta sa e jep okën e ftonjve dhe të shegëve.

— Një dhrahmi okën, — përgjigjet ai. Unë i dhashë dy dhrahmi për tri okë, por ai nuk pranoi. Ç'më mbetej të bëja? Meqenëse ai nuk pranoi pazar, m'u desh t'i hapja rrugë.

— Mirë, — thashë unë, — mirë. — Ai ia bëri me shenjë gomarit që të ndalonte, sajoi me gazetë dy qeska dhe i mbushi me ftonj dhe shegë. Pasi i mora qeskat, unë shkova drejt shtëpisë së Siikës dhe ndalova para derës së saj, sikur të isha plaku i Vitit të Ri, që kishte ardhur para kohe. I rashë një herë dorezës së derës, dëgjova «krk» pas dere.

E çuditshme ishte kjo shtëpi e Siikës! Sapo e ngre dorezën, menjëherë dëgjohet një tingëllimë e çuditshme, pastaj një zë gruaje. Pas pak një kokë e pakrehur u duk në dritare.

— Çfarë do?

Ajo është njerka e Siikës.

— Dua... unë kam sjellë këto...

— Çfarë?

— Këto... ftonjtë... shegët, gaforret...

— Kujt ia ke sjellë?

— I kam sjellë... këtu.

— Ku këtu?...

Ajo shfryu sa më njohu dhe menjëherë filloi të çirrej.

— Si?! Përsëri ka ardhur ky Krifi? Përsëri ka ardhur djalli i çalë? Qërohu këtej! Shporru, përndryshe do të zbres dhe do të ta thyej edhe këmbën tjetër!

Siikës, që i kishte dëgjuar të gjitha këto, nuk i durohej të merrte vesh se kush kishte ardhur dhe ajo gjithashtu e nxori kokën në dritare.

— Kush është, mama?



— Kush? — Ja kush, — u përgjigj njerka dhe me sa pati fuqi ia përmbledhi turinjve. Pastaj e kapi për zverku, e plasi në dhomë dhe një orë të tërë ia nxori shpirtin.

Unë rrija pas dere dhe dëgjoja. Në këto çaste s'doja gjë tjetër, veçse t'ia hiqja nga këtrrat asaj gruaje dorën e njollosur nga boja të Siikës dhe të vija në vend të saj timen. Dhe le të më torturonte pastaj ajo grua e ligë sa të donte.

Në mëngjes njerka iku. U vesh me një fustan të hekurosur gjithë ngjyra dhe shkoi në kishë. Tepër e dhënë pas fesë, ajo nuk linte as edhe një meshë pa vajtur.

Kështu, njerka e Siikës u vesh dhe iku.

I fshehur nën dritare, unë mezi e pritja atë çast. Tani do të dalë Siika dhe ne do të gëzohemi.

Njerka iku. Por aty për aty u kthye dhe e mbylli derën me çelës. Tamam sikur të ishim minj të kapur, ne u menduam për një kohë të gjatë si t'ia bënim dhe pastaj morëm vendim të prerë: e çelim me forcë të përbashkët dritaren.

Ne e vështruam me vëmendje njëri-tjetrin. E pyeta si i kishte punët me shkollën.

Asaj zunë t'i dridheshin buzët kur i kujtova këtë, por ajo u përpoq të buzëqeshte dhe tregoi se sa lot kishte derdhur, kurse tani ajo donte vetëm të buzëqeshte.

Unë thosha me vete me ëmbëlsi: «Siika... Siika...» Edhe sikur të mos dija as edhe një gjuhë, sikur të isha edhe shurdhmemec, unë njëlloj do t'i flitja asaj me ëmbëlsi!

Ajo lllomotiste me mua me dorën në faqe. Pas pak unë kuptova pse e bënte këtë: një e çarë e

madhe i ravijëzohej në fytyrë — gjurmë e thonjve të njerksës. Për t'ia lehtësuar dhembjen, unë i ofroja herë ftonj, herë shegë.

Pastaj i thashë se gaforret kishin ngordhur dhe ne të dy u hidhëruam për këtë.

Tani Siika nisi të tregonte për punët e saj. Ishte një tregim i dhimbshëm... Në shkollë, mësuësit ishin të ashpër, të rrihnin. Kurse në shtëpi e pritnin fukarallëku, sharjet, rrahjet. Gjithçka si më parë... Kur papritur hidhërimi i saj u këmbye me një gëzim të papërshkrueshëm.

Asaj iu kujtua më kryesorja! Gjëra të papara dhe të padëgjua! Pse, unë nuk dija gjë? Si kështu? Aty nuk ka as edhe një fëmijë që të mos e dinte këtë dhe të mos luante mendsh nga gëzimi. Jo vetëm fëmijët, por edhe të rriturit. Por fëmijët kishin luajtur mendsh fare. Nuk ka as edhe një djalë, as edhe një vajzë që të mos kishte braktisur mësimet. Siika dy herë nuk kishte shkuar në shkollë. Dhe këtë e kishte paguar shtrenjtë.

— Jo, Siika, unë nuk kam dëgjuar gjë.

Ajo ulet dhe m'i tregon të gjitha, duke iu marrë goja dhe duke i ngatërruar fjalët... Po, ka të tilla gjëra, të cilat nuk mund t'i shpjegosh.

Njerëzit e kanë harruar gjumin qysh kur erdhën këtu. Ata qëndruan te Kypri, tamam te lumi, nën ca çadra të mëdha. Ja atje.

— Po si shpjegohet? Çfarë është kjo? Unë nuk e di... Ca rrota të mëdha të kuqe! Ngjajnë me një gërryese toke. Në bosht është një zinxhir me kova nga ato që nxjerrin ujë nga pusi... Futesh në kovë dhe ty të ngrenë gjer në qiell. Dhe pastaj përsëri të lëshojnë...

— Po tjetër?...

— Lëkundës me litar çeliku. Ngjiten aq lart, saqë të ngrin zemra. Kuajt si t'i duash, me çfarëdo ngjyre, kuaj të mrekullueshëm që fluturojnë!

— Dhe të gjitha këto janë pa zot, Siika?

— Si pa zot? Ka ca njerëz që japin urdhra; ata janë të mbushur me florinj!

— Si kështu?

— Po pse vetëm kjo, pse kjo është e gjitha?

— Po pse, çfarë tjetër?

— Ti ke parë gra me krahë? Jo? Po të tilla ka, po, po. Ato janë engjëj, vetëm se më të mirë nga engjëjt e kishës, sepse ato dinë të thonë «falemnderit» dhe «mirë, falemnderit», kur i pyet. «Si jeni?»

— Vërtet?

— Vërtet, vërtet! Ja dhe diçka tjetër: janë ca kokë pa qafa dhe pinë cigare! Ose, rri njeriu në karrige dhe gëlltit zjarr. Kurse një tjetër, të cilin e mbajnë për dore, pështyn kallamishte! Një legen plot pështyu! Pastaj ka dhe ca zogj, — ata i bëjnë të sajojnë lloj-lloj gjërash. Pastaj dhe majmunët gjithashtu pinë cigare.

— Me të vërtetë?!

— Më vdekshin të gjithë! Po kjo s'është gjë!

— Si, s'është gjë?

— Ja, dëgjo. Si thua ti, a mund të futet një shtëpi në një arkë?

— Jo.

— Futet, si jo.

— Një shtëpi e tërë, me të vërtetë shtëpi?

— Thua se vetëm një shtëpi? Male, lumenj, qytete. U-u, shumë qytete, trena, anije, gomarë, kuaj. Ç'të duash!

— Si kështu? Dhe ju të gjitha këto i patë me sytë tuaj?

Jo, vetë ajo mbase nuk i ka parë. Po shumë vajza betoheshin se i kishin parë.

— Po si kështu? Si?

— Vështron në një xham dhe qytetet vetë vijnë dhe ikin. vijnë dhe ikin.

— Me të vërtetë?

— Me të vërtetë, posi!

— Të lozësh mendsh! Dhe sa duhet paguar për ta shikuar qytetin?

— Një dhrahmi.

— Për të lozur mendsh!

## KAPITULLI I DYTË

Gjithë mëngjesin, sa s'kishte ardhur ende Siika tek unë, në kohën që kishte braktisur mësimet, unë shikoja ëndrra me sy hapur: ngjitesha lart, në qiell, dhe zbritja me anë të rrotave me kova. Një flakë, që e kishte gëlltitur dikush, më digjte të përbrendshmet...

Po më tepër nga të gjitha më habiti shfaqja e qyteteve. Si mund të futeshin ato në një arkë? A ia vlente t'u besoje fjalëve të shoqeve të Siikës, megjithëse ato kishin bërë be e rrufe? Sepse unë nuk jam një viç, që mund të gëlltit gjithçka që mund t'i servirin gocat.

Pas drekës, njerka e Siikës u shtri të flinte. Ishte një çast i përshtatshëm për t'ia mbathur. Siika doli fshehurazi nga shtëpia dhe erdhi te xhamia, ku po e pritja unë. Ne fluturuam si të ishim me krahë, për te Kypri.

— U-u-u, — gjëmonin fëmijët nën tenda. Kurse karrocet kërcitnin dhe kuajt punonin me sa fuqi kishin. Ca gjyrykë, që u ngjanin atyre të kovaçëve, kishin sajuar një muzikë më vete, por askush nuk u kushtonte vëmendje. Të gjitha qenkëshin të vërteta! Njerëzit akoma po gëlltitnin zjarrin — sa të pangopur ishin!

Mbi një tryezë të gjatë ishin ngjitur dy vetë. Njëri, që po mbante në dorë një shportë me lesh të papunuar, nisi të ushqente tjetrin. Spektatorëve u dhimbsej fatkeqi, që ushqej me lesh. Por tjetri ishte i kënaqur, saqë lëpinte gishtërinjtë.

Pasi e ushquu atë, njeriu e hodhi tutje shportën dhe i ra kambanës. Salla ra në qetësi.

— Zotërinj dhe zonja! Kini mendjen. Leshi që sapo hëngri ky zotëria, tani do të thuret. Ai ka në bark një fabrikë, e cila do të përpunojë prej leshit fije. Tani mund të ndezim një cigare. — Ai nxori nga xhepi një cigare, e ndezi dhe e hëngri.

— Akoma, akoma! — thërritnin njerëzit dhe zemrat e tyre hidheshin përpjetë me vërtik.

— Qetësi, qetësi!... Mos u nxitoni, përndryshe do të plakeni shpejt. Dhe tani ky leshi duhet ngjyrosur. Çfarë ngjyre pëlqeni ju, ë?

— Të kuqen! — thirri një xhaxha, që ishte ulur pranë meje.

— Jo, të verdhën!

— Hesht! Unë dua të kuqen!

— Mirë, mirë, mos u grindni!... Fabrika jonë i përmbush të gjitha dëshirat. Do ta ngjyrosim në dy ngjyra — gjysmën të kuqe, gjysmën të verdhë. Mirë?

— Mirë — thërritnin njerëzit. Ne, fëmijët, zgjatnim qafat me sa fuqi kishim, për të mos na shpëtuar gjë.

Zilja ra përsëri.

— Kështu pra, ju jeni gati? Pritni. Sapo ju të numëroni gjer në tre, filli do të tërhiqet! Gati? Fillojmë: një, dy, tre...

— Oj - oj - oj, çfarë katrohure që u bë! Nga goja, si të ishte një curril që po rridhte nga çezma, dilte filli i leshit. Zgjatej e zgjatej i dredhur, leshi i skuqur, i bojatisur. Shporta u mbush plot.

— Hë, a jeni të kënaqur? — pyet njeriu me zile.

— Të kënaqur!... Po ai nuk do të hajë më?

— Do të hajë. Po përpara ne duhet të mbledhim paratë për vajin. E kuptoni, besoj, fabrika duhet vajisur.

Njeriu nxjerr nga sirtari i tryezës një pjatancë të artë.

— Sa të mundni, — thotë ai dhe grumbullon monedhat. Pagan të gjithë. Bile dhe Siika e hodhi një monedhë bakri jeshile.

Ne më në fund u larguam prej andej. E çuditshme, sidoqoftë, ç'u duheshin atyre njerëzve të pasur monedhat tona? Megjithatë, askush nuk ishte në gjendje të na e shpjegonte.

Ne shkuam më tutje. Andej nga ishin kuajt, rro-

tat dhe kafshët, që po bënin gjimnastikë. Në kalim  
e sipër i hodhëm një sy dhe zogut të zgjuar

— Gardalina-fallxhore! — na e paraqiti atë  
i zoti i zogut.

Përreth tyre ishin grumbulluar kureshtarët. Për  
një monedhë, zogu të tregonte fatin.

— O xhevahir! — i thërriste i zoti. — Tregoji  
fatin kësaj zonje. Ashtu, bravo, të lumtë! Kurse tani  
përshëndete atë zonjën, ajo të pagoi. Ashtu, bravo!  
Afrohuni të gjithë, gardalina-fallxhore do t'ju tregojë  
fatin që ju pret! Ç'zog i zgjuar!

Cap-cap dhe zogu kap me sqep një copë letër nga  
grumbulli dhe ta jep në dorë. Kurse ti lexon dhe  
merr vesh se ç'do të të ndodhë. Te gardhi i tendës  
po qante Safka, një fqinjë e Siikës. Çfarë ka ajo që  
qan? Na del se zogu i dha asaj një lajm të keq dhe  
ja ku ajo mbushet me lot të hidhur.

«Budallaqe! — doja t'i thosha. — Si është e mu-  
ndur që ky zog i mrekullueshëm të të bëjë keq ty?»

Siika më tërhoqi për xhakete. Shkojmë. Së shpej-  
ti ne duhet të kthehemi në shtëpi dhe s'kemi parë  
akoma qytetet. Duhet të nxitojmë, përndryshe do të  
na dalë huq. «Llukas Papapanajotakopullos, panora-  
matopios» — ishte shkruar mbi arkën e zbukuruar  
me shirita, pasqyra, panorama dhe gjithfarë zbu-  
kuresh të tjera.

Pronari i arkës ishte më i zgjuari nga të gjithë  
njerëzit, që na kishte takuar të shikonim. Më i kul-  
turuari. Dhe më krenari. Ai kishte plotësisht të drejtë  
për këtë. Unë, të them të drejtën, kujtoja se do të  
takoja ndonjë të çmendur. Dhe me të vërtetë, ishte  
e çuditshme se si nuk kishte lajthitur ai prej gjithë  
këtyre çudirave.



— Ju keni ardhur të shikoni Evropën? — pyeti ai kur na vuri re. — Po, që të bëhemi miq (unë për pak sa nuk qava nga mallëngjimi: një njeri i tillë po na ofron miqësinë!) o të dashurit e mi, — vazhdoi Llukasi, — që të miqësohemi, pa më jepni këtu paratë...

I çuditshëm ishte ky Llukasi. I pasur, më i pasur nga gjithë mbretërit e përrallave të gjysheve, dhe ja ku po lakmon dhe monedhat tona.

— Zini vendet! — thirri Llukasi, duke u kollitur. — Fillojmë. Llukas Papapanajotakopullos, që i ka rënë botës përçark, do t'ju tregojë gjithë botën për një dhrahmi dhe do ta gëzojë zemrën tuaj. Tregojuni këtë dhe të tjerëve. Shkojmë, allons!').

Ai shtypi butonin. Dhe çfarë thoni ju? Përpara syve tanë u shpalos një qytet i artë, shumë më i mrekullueshëm nga ata të përrallave. Llukasi na e «rekomandoi».

— Dhe kështu, zotërinj, ju po shikoni Vienën, qytet i madh. Në limane ju shikoni vaporët. Gjiret përçafohen njëri me tjetrin, zotërinj është një det i mrekullueshëm, nuk ka fund gjëkund. Akulli lundron. Gjithandej muzikë, vallëzime dhe shumë gjëra të tjera. Viena, siç e quajtmë, zotërinj, është qytet i Austrisë, mbretin e saj e quajnë Franciskos Jezus. Fund.

Tani, zotërinj, ju po shikoni Parisiusin, një qytet përrallor, me oborre madhështore, që quhen bulevarde. Ju po shikoni gra të veshura me rroba luksoze — më të bukurat e botës. Pajtonë, tramvaje. Ato rrëshqasin si mbi sapun. Ja kulla e lartë për të parë

---

1) shkojmë (frëngj.)

hajdutët, — prej tyre ka shumë në Parisius. Fund.

Këtu, zotërinj, ju po shikoni Totokion. Mal prej nga rrjedh rrëshirë e kështu me radhë. Ka sa të duash pemë qershie, po kokrra nuk bëjnë. Mëndafsh, kambana, fenerë letre. Njerëzit nuk kanë llafe. Hanë të ulur në gjunjë. Janë shumë fetarë — çajne barkun e tyre. Zoti i tyre është lakuriq. Nga goja lëshon tym dhe të tjera. Fund.

Tani, zotërinj, përpara jush ndodhet Roma. Te këmbët ka shumë pëllumba. Ata mund t'i ushqesh me dorë — janë shumë të shtruar. Nëpër çati ka shumë glasa. Ja teatri, ku egërsirat e tmerrshme copëtojnë të krishterët; ato janë shumë të egra. Mbreti i tyre e ka trupin sa një tapë. Prijësi i tyre është turk, atë e quajnë Musulim.<sup>1)</sup> Jetën japin për makaronat. Fund.

Këtu, zotërinj, ju po shikoni Marsejën, një qytet me limane, rrëmujë e kështu me radhë. Mbi qytet është një urë e lartë për të parë qytetin — ai është shumë i bukur. Ca ganxha djallëzore i ngrenë përpjetë vaporët. Digë për të luajtur, gjueti e peshkut dhe kështu me radhë. Njerëzit gjithmonë bëjnë gostira. Dembelë dhe gënjeshtarë. Fund.

Këtu, zotërinj, ju po shikoni Venecien — qytetin e pushimeve. Ai lundron në ujë. Pajtone, rrugë dhe të tjera si këto, janë të kredhura në ujë. Varka të bukura me hundë të përkulura. Ato vishen në vend të këpucëve. Njerëzit janë komikë, me thika të mëdha, këndojnë shumë. Siç thamë, zotërinj, Venecia është një qytet me kupola. Fund.

---

1) Këtu autori tallet me diktatorin e Italisë fashiste, Musolinin.

Tani, zotërinj, ju po shikoni Athinën tonë, qytetin e Elladhës së vjetër. Njerëzit këtu janë dinakë. Kolonat, mermeri — të gjitha janë shumë të vjetra. Të gjithë nxitojnë për t'i parë. Akropoli me mbretër, vajza e kështu me radhë. Palikarët nuk kanë turp, rrinë ashtu si i ka pjellë e ëma. Perikliu, Sokrati, Dhimosteni, Themistokliu — të gjithë janë të lashtë. Tempulli. Ora diellore tani nuk punon. Kavakallonët, Elimpioni, Qeramikosi — atje kanë varrosur të vdekurit. Erëra. Dhiogjeni me fanar, shumë i çuditshëm. Ju presim, ç'urdhëroni? Falemnderit. Fund.

## KAPITULLI I TRETË

Ne ishim si në ëndërr. Bile, edhe sikur papritur të gjëmonin daullet, ne nuk do të zgjoheshim, të ngurosur nga entuziazmi në vendet tona. Ne ishim kredhur në përrallë dhe nuk deshëm të ndaheshim prej saj.

Të vërtetën kishte thënë Siika, që aty mund të lozje mendsh kur të doje. Kjo ishte me të vërtetë çmenduri. Bile dhe për të pirë ne nuk donim, megjithëse shëtitem për një kohë të gjatë. Ne as që u kujtuam për këtë. Pse, kohë për të pirë ishte?

Vazhdonim të shëtitim nëpër qytetet e Llukasit. Ç'qytete të çuditshme që ishin!... Po si ishin vendosur në arkë? Vetëm Llukasi kishte fuqi ta bënte këtë.

Sytë e Siikës sot u bënë krejt të rrumbullakët. Dhe kjo për shkak të atyre zogjve, trenave, rrotave, kuajve fluturues, grave me krahë, njerëzve, gëlltësve të zjarrit... Sado e lartë të jetë arsyeja njerëzore, ajo do të errësohej prej tyre, kështu që s'ke ç'të thuash për ata që janë të varfër nga trutë.

Ne donim të largoheshim, por nuk na bënë këmbët. Edhe sikur të na kishin lidhur pas kuajve, nuk do të lëviznim që andej. Dhe sikur të mund të na shkëputnin prej karrigeve, sikur të na çonin dhe të na mbyllnin në kasolle, njëlloj, parafytyrimi ynë do të mbetej aty. Aty, në Kypri, pranë njerëzve të artë, në krahët e përrallës.

Por gjithçka e ka një fund. Papritur nisën të binin me rrëmbim zilet dhe dy shërbyes me shufra nisën të shkonin tutje-tëhu, duke nxjerrë njerëzit përjashta.

— Largohuni! Shkoni nëpër shtëpi! Për sot mbaruem. Marsh!

Ç'njerëz të ashpër! Urdhëro, të lutem! «Marsh këtej!» — sikur Kypri të jetë i tyre, personal. Ata kujtojnë se atyre gjithçka u lejohet, meqë kanë shufra nëpër duar.

— Ti akoma nuk je bërë gati? — i çirren ata Siikës. — Fshiji hundët dhe qërohu.

«Ndyrësirë!» — siç thoshte zoti Avgerinos. Domethënë se po të jesh i vogël, me ty mund të sillen si të duan.

Mori fund muzika e fshehur në prapaskenë. Kovat mbetën varur atje lart, tamam në qiell. Kuajt ndaluan. Njeriu që hëngri leshin, hoqi kapelën me kordhele të arta, u mbështet në mur, fshiu djersën dhe ndezi një cigare. Ai ishte shumë i lodhur dhe

i trishtuar... ai ishte lodhur shumë... Dhe të gjithë u trishtuan, të gjithë e ndjenë lodhjen.

Llukasi nxori nga arka një copë djathë dhe një simite dhe, si të ishte ujk, e gëlltiti njëherësh. Urdhëro, të lutem!... Vetëm shikojeni se ku e vë ai bukën dhe djathin. Xhelati! Tani të gjitha qytetet do të mbanin era djathë! Xhelati!

Kurse ne i dashuruam aq shumë ato qytete...

Dhe ja tani, ne ecim buzë lumit dhe i shikojmë ato përsëri. Qytetet e arta reflektohen në ujë. Ja dhe oborret e larta, «bulevardet», siç i quajnë ata. Kullat, urat, pemët e qershive... dhe çfarë se! Jo të tilla si të Llukasit, në to rriten qershi. Ecim tamam buzë lumit. Qytetet e shndritshme notojnë në të...

## KAPITULLI I KATËRT

Në punishten e baltës, unë gjeta ndryshime të mëdha. Të gjitha kishin marrë pamje tjetër. Para së gjithash Kristaqi. Ai kishte ardhur i rruar taze, me një palë çorape të reja.

Kryepunëtori kishte sjellë me vete duhan të grirë dhe i ishin shtuar dy mballoma në gjunjë.

Furrтари kishte sjellë një copë rrobë velash, të cilën do ta lidhte në vend të futës, që të ruante pantallonat. Rezervat e ushqimit të Jovanisit ishin pasuruar me tranguj.

Dhe vetëm Pjetër-biska kishte mbetur njëlloj si më parë. Ai rrinte në vendin e mëparshëm i palë-

vizshëm, si një copë trug, dhe vështronte këmbët e tij të fëlliqura.

Dhe puna eci në rrjedhën e saj të zakonshme; si më parë, të gjithë tymosnin duhan të dredhur; kryepunëtori, si gjithmonë, rrinte në postin e tij, kurse Jovanisi gërhiste...

Kështu rridhnin ditët njëra pas tjetrës, kalonin javët, këmbëshin njëra me tjetrën. Deri atë ditë, kur ia dha shiu, për të cilin folëm në fillim.

Dukej sikur shiu priste diku pas malit, sa të fshihej dielli dhe ai të mund të hidhej në sulm. Po dielli i pamerak, që s'dinte gjë, nuk shqetësohej fare dhe bile nuk po ngutej të perëndonte. I nevrkosur, shiu shpërtheu në mesditë dhe e mbyti kënetën tonë. Në atë kohë, në fshatin fqinjë bëhej një dasmë. Asnjëri prej nesh nuk shkoi atje.

Atë ditë, aty pranë nesh, kaluan dasmorët të hipur në kuaj, zbukuruar me gjithfarë shamish ngjyra-ngjyra dhe me shishet e rakisë nëpër xhepa. Kalorësit rrëkëllenin gjithë qejf nga pak raki dhe, duke u hedhur përpjetë gjithë hare, i lëshonin me vrap kuajt e hazdisur.

Kristaqi i shikonte ata që pas togut me baltë dhe zemra i drithërohej. Duke i përcjellë ata me sy, ai u krodh në punë si ndonjë egërsirë.

Dielli i mesditës, armiku më i keq, na i digjte kokat pa mëshirë. Jovanisi nxori nga torba një peshqir të endur në shtëpi, fshiu djersën me të dhe e hodhi mbi baltë. Po përnjëherësh u mbulua përsëri nga djersa dhe përsëri u fshi. Dhe, kur u mat ta bënte këtë për të tretën herë, ra çanga për pushim. Të gjithë kumaxhinjtë u sulën në lumë dhe, duke shfryrë, u krodhën me kokë në ujë. Unë



kisha parë njëherë se kështu vepronin dhe buajt. Furrтари tha se një vapë e tillë nuk paralajmëron asgjë të mirë.

Duke rrudhur sytë, ai vështroi diellin, qiellin dhe tha në mënyrë të vendosur:

— Do të bjerë shi!

Ne ia thamë këtë Pjetër-biskës, po ai as vetullën nuk luajti. Mizat vërtitëshin si re përreth kokës së tij dembele.

— Dielli përvëlues s'paralajmëron asgjë të mirë!  
— i thamë atij.

— Ashtu qoftë, — u përgjigj ai.

— Do të digjemi të gjithë!

— Ashtu qoftë... — përsëriti ai.

— Do bjerë shi! — e paralajmëroi kryepunëtori.

— Jo, — kundërshtoi biska dhe dremiti përsëri.

Megjithatë, fatkeqësia trokiti. Trokiti ashtu siç e pritnim, në kundërshtim me fjalët e Pjetrit.

Retë i nxorën hundët përmes shkrepave madhështore malore, u zgjatën, mbushën gjithë hapësirën qiellore, u shkëputën prej andej dhe fluturuan pingulth poshtë.

Furtuna na zuri si zogj të squllur. Se i hodhëm tutje veglat e punës dhe u strukëm nën çatitë prej llamarine. Pjetër-biska shpërtheu si kongjijtë e zjarrit. Dhe i mallkoi njerëzit tanë gjer në shtatë breza.

Ne rrinim në pritje të mbarimit të kësaj furtune; — dhe asaj qiellore dhe të Pjetrit.

Po Pjetri sa vinte e shpërthente akoma më fort:

— Ej, ju atje! Qenër! Gomerë! Hë, shpejt, shpejt! Hidhni llamarinat mbi tullat!... Ah, gomarë!

Ai na urdhëroi t'i mbulonim tullat me llamarinë (Oh, kockat tona, bile edhe tullat ishin më të lumtura nga ne).

— Jo! — u dëgjua një zë që poshtë teneqeve.

Unë vështrova në atë drejtim nga u dëgjua zëri. Ai i përkiste një krijese të vrenjtur, të errët e të sëmurë, përzierësit të zbehtë, i cili dukej se ishte krijuar vetëm për të punuar dhe për t'u kollitur. Ç'ndodhi me të? Të gjithë u kthyen nga ai.

— Jo! — thirri ai edhe më fort dhe fytyra iu nxi më tepër.

— Ah, ja ç'qenke ti!

— Jo! — thirri Kristaqi.

— Jo! — u dëgjua edhe një zë tjetër. Edhe i treti.

— Jo!

— Jo!

— Jo!

— Jo! — thirra dhe unë.

Kurse shiu gjëmonte, fërshëllente e qante. Dhe aty ndodhi diçka e padëgjuar. Biska, ai gjumashi, gur varri, zgjohet nga gjumi i tij i flashkët dhe çirret si një gomar, të cilit po i veshin patkonj me hekur të skuqur. Ai shkoi në mes të sheshit dhe aty për aty nisi shfaqja. Çfarë shfaqjeje se!... Ai qante, kërcënonte, shkulte flokët, kërcente, ngrinte pantallonat, po askujt nuk i shkonte ndër mend t'i dhimbsej. Që poshtë strehës ku rrinim, ne po admironim kërcimin e tij.

Po ai shumë shpejt e mori vesh ku ishte pika jonë e dobët.

— Hë — ë! — këlthiti ai, i burrëruar nga thirraja e vet. — Ju, qenër, të shtunave merrni dhrrah-

mitë, ë? Dhrahmi do merrni, ë? Ja, këtë do merrni!  
— dhe na tregoi bërrylin. — Do t'i merrni dhrahmitë  
të shtunën!

Ishte e qartë: ose ne do t'i mbulonim tullat me  
llamarina, ose asnjeri prej nesh nuk do të merrte të  
shtunën as edhe një grosh.

Ç'të bënim? Njëri pas tjetrit shkuam dhe i ven-  
dosëm llamarinat, uleshim ku të mundeshim nën shi,  
të mjerë, si dhe vetë fati ynë. Shiu i rrëmbyer rridhte  
si lumë, duke përmbytur fushat e përbaltura nga  
uji. Kohë më parë, kur ndodhte që binte shi, gjyshja  
më thoshte: «Qielli qan». Ah, gjyshe, po ai sot u  
shkri fare.

Ai i përmbyti të gjithë ata që, sipas mendimit  
të tij, duheshin përmbytur. Të gjithë rrjepacakët,  
të gjithë të pastrehuarit. Ata që nuk kishin fare  
strehë, dhe më fort ata që nuk kishin as edhe një  
çati llamarine ku të futnin kokën për t'u mbrojtur  
nga shiu.

Shiu rridhte. Lumenj, detra uji përhapeshin  
mbi tokë, në përpjekje për ta mbytur atë.

Ne ishim ngurosor mes oqeanit ujqor, që na kishte  
përmbytur. Diku ndodhej stacioni hekurudhor, diku  
jehonte sirena e lokomotivës, që tani po tretej larg  
me gjithë fërshëllimën e vet.

Aty nuk kishte njeri tjetër përveç nesh. Diku  
duhej të ndodheshin njerëz, po ku — askush nuk e  
dinte. Ne ishim si në një barkë, që furtuna i kishte  
rrëmbyer lopatat.

Vetëm biska nuk përzihej në fatin tonë. I kyçur  
në barakën e vet, ai vazhdimisht numëronte, numë-  
ronte, numëronte... Ç'i duhej atij nëse argatët e vet  
ishin përzier e bërë një me baltën. Ishin shtrirë me

fytyrën mbi dhe, vinin vërdallë si të mundnin. Kristaqi u afrua tek unë, me duart e çapëlyera si të një dege peme, për të më mbrojtur nga shiu.

Vetëm ai dhe Jovanisi mbaheshin më këmbë. Të tjerët ishin përzier me dheun. Përzierësi i sëmurë i ngjante një lëkure të vjetër të shtruar në korridor... Një plaçkë e vjetër, që nuk i hynte në punë asnjëri. Askush nuk thoshte as edhe një llaf, nuk luante vendit. Ishim ngulur fort në tokë, si të ishim gozhdë ujore. Vetëm më të rrallë ndonjëri hidhte vështrimin nga baraka e biskës. Dhe kërcëllente nofullat.

Për të lëvizur sa më shpejt, shiu ia shaloi erës që erdhi nga malet. Ky kalorës vraponte me vruillin e një të marri.

Ai fluturonte mbi kalin e vet, fluturonte deri sa pa përënduar dielli. Ra nata, shiu ia la vendin asaj, kurse vetë u largua tutje. Atëherë dhe ne u ngritëm, të ngjashëm me ca lecka të harruara nën shi.

Jovanisi dhe Kristaqi fshinë zverkun. Diçka u kishte mbirë në kokë, diçka po përtypnin me mend.

Dhe papritur e vendosën, por pa provuar ndonjë ndjenjë gëzimi.

«Hajde! — i dha urdhër Kristaqit Jovanisi, duke shkuar dorën mbi ballë. — Shkojmë, jepi», — përsëriti ai me rreptësi për t'i mposhtur lotët. Kristaqi po kundërshtonte.

Sytë e tij ishin veshur me një rrjetë të dendur — i vështron ata dhe të parafytyrohet thertorja. «Shkojmë! — e thërret përsëri Jovanisi. — Shkojmë, de!...» «Ps-s! — mërmërit Kristaqi. — Nuk mundem, nuk mundem».

Atëherë Jovanisi ma bën me shenjë mua. «Si do të vejë puna me muhaxhirin? — pyesin sytë e tij. — Ç'do të bëhet me muhaxhirin?» Ra heshtja. Dhe papritur... «Hajde!» — thotë me zë të lartë Kristaqi dhe ata drejtohen për diku.

Ku po shkojnë ata? Askush nuk e di. Por pas pak e morën vesh të gjithë. Me sopata në krahë, ata u drejtuan nga lumi. Në heshtjen e natës jehuan goditje të mbytura. Shelgun... Shelgun tonë, krenarinë tonë, kambanelin... Shelgun, mbi rrënjët e të cilit ne kridheshim, ku ne ngroheshim në diell dhe thanim rrobat, shelgun, mbi të cilin Jovanisi varte torbën e vet dhe me degët e të cilit furrtari bënte kurora, shelgun tonë, mikun tonë po e bënin copa-copa...

Ne ishim të gjithë të pranishëm në fundin e tij. Diçka u këput te ne. Njerëz kishte boll, kurse shelg një. Ne ishim mësuar me të. Që atëherë që ishte zhdukur arixhiu, ai kishte zënë vendin e tij në zemrën time. Tani atë e prenë...

Pjetër-biska, i ulur në qoshen e vet, dyshoi për diçka të keqe. Dhe, në mesnatë, me një pamje prej të çmenduri u sul drejt e te ne, ashtu si ishte, pa pantallona. Duke u afruar, pa u ndier, te druvarët që po pritnin, ai i mbërtheu për dore me një forcë të tillë, që nuk e priste njeri. I inatosur, ai po i përtypte në mënyrë të tillë fjalët, duke lëshuar pështymë, saqë s'mund ta kuptoje se çfarë donte. Nga një derr i butë, ai u kthye në një derr të egër. Kristaqi e shporri tutje atë, ashtu si bëjnë me një mushkonjë. Po biska u qep përsëri. Atëherë Jovanisi foli me të butë me Pjetrin... Ashtu siç dinte të fjalosej ai njeri i mirë dhe i urtë që në fëmijëri. Shpirti i tij ishte llagar. I mrekullueshëm ishte ai. Biskës iu

ngatërruan fjalët, si të ishte mes gëmushave. Po të gjithë në këtë botë e kanë një fund. Ndoshta ngaqë Jovanisi ishte qullur krejt, kurse Pjetri ishte krejt i thatë, ose nga që të gjithë përreth dridheshin si ca kuaj të munduar, vetëm për një çast gjithçka u përmbys. Zemra e Jovanisit u çka, mjalti i shpirtit të tij shkriu. Ai e hodhi mënjanë sopatën dhe e mbërtheu Pjetrin për mes.

— Ah, ti! — shpërtheu ai. — Ah, ti! Ti nuk e ke provuar shiun, ë?

— Jo, — u përgjigj Pjetri, duke e shqyer gojën si një budalla.

— Epo, atëherë... — Të gjithë po pritnin se ç'do të thoshte Jovanisi. — Atëherë provoje! — dhe e krodhi paq në lumë.

Biska këlthiste dhe hidhej si një këlysh, që e hedhin në rezervuar. Ne i dhamë mundësinë atij të këlthiste dhe të luftonte me rrjedhën. Jovanisi fërkoji duart, tamam ashtu siç veprojnë druvarët, dhe përsëri e kapi sopatën.

Kur ata të dy mbaruan punë me shelgun, ne vajtëm atje, i mblodhëm drutë dhe i sollëm para sheshit. Pasi vendosëm drutë, ne pritëm që dikush t'u vinte zjarrin. Edhe për këtë u kujdesua Jovanisi. Në barakën e biskës ai shqeu një arkë të thatë dhe e solli te sheshi. Si fitil i shërbeu një leckë e vjetër, që e kishte marrë në barakë, i fryu zjarrit dhe vuri dru.

Sa i bukur dhe ndjellëmbël ishte ai zjarr! Prej nesh dilte një avull i dendur, si tymi i oxhakëve të shtëpive fshatare. Po gëzim ne nuk po ndienim. Diçka po na mundonte, na e gërryente zemrën, ashtu siç ndodh kur nis të hash mishin e pjekur të një

kafshe, të cilën ti e ke dashur dhe e ke rritur me duart e tua.

Prej nesh dilte avull. Ne tymosnim, tymosnim dhe dridheshim. Fytyrat tona të kujtonin peizazhet e zymta, të ndriçuara keq nga hëna... Ose gurët e malit, nëpër të cilët rrëshqitnin shkëlqime flakësh, që kishin shpërthyer në pyll. Ne shtruam poshtë brucat — le të thaheshin dhe ato. Zjarri çante napën e errët të natës.

Jovanisi ndezi një cigare. Në qeskën e tij të lëkurtë, duhani ruhej i thatë. Pastaj ai vuri në zjarr dhjetë copë specë të njomë për t'u pjekur dhe, kur ato u poqën, u dha të gjithëve nga një. «Falemnderit», — shqiptoi secili i ngazëllyer. Falemnderit, Jovanis... Po bukë nuk kishim. E gjitha ishte lagur, e gjitha ishte përzier me baltë. Dhe ne hëngrëm specë pa bukë.

Në atë çast, te grupi ynë u afrua me frikë padroni, i lagur gjer në palcë, dhe, i poshtëruar, kërkoi zjarr. Askush nuk i tha atij: «ngordhsh, derr i fëlliqur!», — nuk e zboi njeri. Jovanisi i liroi atij një vend pranë vetes dhe e gostiti me specë. Kurse padroni, pasi u tha pak, shpërtheu i zemëruar, duke iu drejtuar Jovanisit.

— Jovanis Cepkenxhi! Në mëngjes të qërohesh prej këtej!

• Të gjithë u kthyen nga Jovanisi.

— Mirë, — u përgjigj qetësisht Jovanisi. — Mirë...

Në zemrën e secilit prej nesh zuri vend një i ftohtë therës.

Pjetër-biska, i squllur dhe i mundur, akoma po na mbante në thonjtë e tij.

«Do të të flak nga puna!» — thotë ai dhe ti s'ke ç'i thua. «Mirë». — i përgjigjesh. Në kuletën e tij të fëlliqur ndodhet buka jote.

Jovanisi largohet, mbledh qetësisht rraqet e veta, i palos në rregull ato, i lidh lëmsh dhe përsëri afrohet te zjarri. Ai përshëndoshet me ne, me secilin në veçanti. Ndahet vëllazërisht, krenar dhe burrëror.

— Asgjë, asgjë, — thotë ai. Kjo do të thotë: «S'ka gjë, djema, mos u mërzitni, nuk është kushedi gjë e madhe».

Më erdhi edhe mua radha. Unë isha i shqetësuar — a do të gjente rrugë të vinte gjer tek unë ky zot i madh? Po, natyrisht. Ai jo vetëm që po ndahej me mua duke më dhënë dorën, po më fërkoj bile dhe kokën me përkëdheli.

— I shkreti djalë, — tha ai dhe shtoi, pasi heshti: — I shkreti magjar! — Unë e kuptova se ç'nder i madh ishte kjo për mua dhe fërkova gjurin.

— Magjar, — përsëriti ai me një zë çuditërisht të ngashëryer.

Dhe me hapa të mëdhenj afrohet te Pjetri.

— Të largohem, thua, ë? — e pyet ai prerazi.

— Largohu. — përgjigjet Pjetri.

Jovanisi bën përpara. Ndërgjegjja e tij është e qetë.

— Hop-la! — këlthet ai. E hedh biskën mbi kurriz, shkon nga lumi dhe e hedh blumb e në lumë. Pastaj fshin duart dhe largohet. Ai dalngadalë tretet në errësirën e natës.

Të gjithë shkojnë për të fjetur. Vetëm një njeri qëndron ende pranë zjarrit. Dremit dhe thahet. As edhe njerit prej nesh nuk i vjen keq për të.



## KAPITULLI I PESTË

Në mëngjes, thirrjes së çangës ca iu përgjigjën me gatishmëri, të tjerët me zor, kurse unë nuk iu përgjigja fare. Unë nuk kisha forca të lëvizja. Digjesha i tëri. Ethet po më torturonin, unë po digjesha si një thimjan i thatë. Isha shtrirë nën çatinë prej llamarine dhe digjesha si në zjarr. Kumaxhinjtë vinin tek unë, më vinin dorën mbi ballë dhe, duke fërkuar mjekrën:

— E-eh, i shkreti, — thoshin ata, — i shkreti djalë! — dhe shkonin në punë.

Kristaqi, me këmbët e mbledhura, rrinte pranë meje i dërrmuar. ngaqë nuk mund të më vinte në ndihmë.

— A ke kininë? — i pyeste ai të gjithë ata që afroheshin.

— Jo. — dëgjohej përgjigjja e hidhur.

— Uthu!!

— Dhe uthull nuk kemi, — përgjigjeshin ata akoma më me hidhërim.

Përzierësi i mirë, i ngrysur, shqeu gjysmën e xhepit të vet, e lagu shukun në ujë dhe nisi të ma vinte në kokë.

Në darkë rashë në harresë. Kushedi sa ngjarje ndodhën atë natë... Po në mëngjes, kur agoi, të gjithë vunë re se Kristaqi ishte zhdukur. Dielli po ndriçonte cepin e qiellit, po vetë akoma nuk po dukej. Përzierësi, me xhepin e shqyer, u afrua tek unë dhe, me një greqishte të çalë, nisi të më ngushëllonte me përkëdheli. për të më bindur të duroja:

— Duro. Menelo, duro, mik, Kristaqi do të kthehet dhe do të të shërojë. Duro, djalosh, Kristaqi shkoi të marrë doktorin. Në Masllovo ka shkuar Kristaqi, duro, djalosh, e-ch...

Ai rrinte pranë meje, me këmbët e mbledhura, duke kërkuar me zor fjalët përkëdhelëse dhe duke vendosur pa u lodhur në ballin tim leckë të njoma: xhepin e lagur. Po ja ku erdhi Kristaqi, bërë qullë nga djersa. Pasi e largoi leckën, ai më vuri faqen e vet tek imja.

— Ujë. — iu drejtua ai prerazi përzierësit. Tjetri vrapoi në lumë dhe e lagu përsëri xhepin.

Kurse unë digjësja, digjësja...

— Eh, ti, i shkretë. Duro, pëllumb, duro. Do të vijë doktori dhe do të të shërojë; duro. Menelo, duro...

Ai e humbi fare toruan.

— Ja tani, tani do të vijë doktori.

Dielli digjte po aq pa mëshirë si dhe dje.

Ra mesdita. Doktorin nuk erdhi. «Mirë e pësove», — thashë unë me vete. Punëtorët hanin drekë atje tuje. Ata përgatitën qull me tul buke, me ujë dhe kripë dhe më ushqyen.

Kristaqit dhe përzierësit u iku oreksi (ashtu thanë ata dhe të dy mbetën pa ngrënë).

Pasdreke, kumaxhinjtë vinin tek unë me radhë. Vetëm Pjetër-biska dhe kryepunëtori nuk e morën mundimin. Bile dhe mërmëritnin nëpër dhëmbë, nga që unë nuk punoja dhe po i pengoja të tjerët.

Ra mbrëmja. Doktorin nuk u duk gjëkund. Kristaqi për pak sa nuk po qante.

Në agim të ditës tjetër, me këndesat e parë, ai iku përsëri — në fshatin tjetër, për një doktor tjetër.

Biska, kur vuri re mungesën e Kristaqit, nisi ta mallkonte atë me ç't'i vinte ndër mend, duke sharë njëkohësisht dhe përzierësin, ngaqë ai bënte ç'bënte dhe vraponte tek unë për të më lagur ballin dhe të më thoshte një fjalë të mirë.

Po përzierësi nuk i kushtonte vëmendje bis-kës dhe, kur dëgjonte rënkimet e mia, çdo herë vraponte tek unë i shqetësuar për të më ngushëlluar dhe për të freskuar kompresën.

— Duro... Tani do të vijë Kristaqi me doktorin, tani... Së shpejti, i dashur, së shpejti.

Kur ai niste të më ngushëllonte me fjalë përkëdhelëse, duke derdhur lot, të përzier me baltë mua më bëhej një lëmsh në grykë. Më hipte inati dhe shkrihesha në lot.

## KAPITULLI I GJASHTË

Dielli ishte ngjitur dhe digjte atje lart, në qiell.... Ai përvëlonte gjithçka përreth. Dhe në qiell nuk kishte asgjë që të mundë ta zbuste atë. Retë kishin që dje që ishin shpërndarë dhe tani qielli ishte krejt i pastër. Bile as edhe një zog nuk po fluturonte që të na freskonte pak me rrymën e ajrit, shpërndarë prej flatrave të tij.

Në vendin e punës pritnin vdekjen time. Kristaqi nuk po dukej gjëkund. Ai, siç dukej, nuk po e gjente doktorin. Kurse atje i kishim varur shpresat: pa ndihmën e doktorit s'më mbetej gjë tjetër veçse të vdisja. Kumaxhinjtë përkuleshin mbi mua dhe më vështro-

nin me keqardhje. «Eh, mor i shkretë...» — thoshin ata. Më vinin dorën mbi ballë dhe ofshanin:

«Ah, Kristaq, ah...»

Dita zvarritej mengadalë, si një gomar i ngarkuar rëndë. «Ysh-ysh» — e ngasin atë fshatarët, po megjithatë mezi ecën. Tani unë isha krejt i sigurt se do të vdisja. Dhe, po të mos vdisja, do të piqesha në diell. Përzierësi, me xhepat e shqyer, papritur lëshoi lopatën në baltë dhe u fsheh pas grumbullit të tullave. Dikush shkoi të shikonte se ç'ndodhi me të. Dhe u kthye i zymtë.

— Ç'i ndodhi atij, xhaxha? — pyeta unë.

— E... Asgjë. I dhembin sytë.

— Sëmurë është?

— Ëhë!

— Po ai para pak kohe ishte shëndoshë si molla!

— Kurse tani u sëmur.

— Ndoshta po qan!

— Jo!... O-oh!...

Pse mos ta thonë se po qan? Unë do ta kuptoja se po vdisja dhe do të qetësohesha.

Ai qante për mua dhe në këtë mes nuk kishte asgjë të keqe.

Dielli ishte ngritur në zenit.

I nxirë e i pjekur nga dielli, Trepseja — Trepse Llukovoi — «doktori», mbërriti tamam në mesditë. Një djalosh i shëndoshë, i ngarkuar me instrumente «shkencore». Në brez i varej një torbë me paketa, mbushur me ilaçe. Në njërën kishte gurë të rrallë, në tjetrën qymyr, në të tretën rrëshirë pishe, në të katërtën eliksir kedri. Barna, miksurë, helme. Farëra, copra lëkure.

Pantallonat i kishte të mbështjella me peshqir të punuar në shtëpi. Në krahë kishte hedhur ca brirë bualli dhe një shishe vaj. Në vesh kishte vënë një laps të zi të trashë dhe një tubet të vogël prej lëkure.

Shkollë ai nuk kishte bërë, por bënte ca punë, që i linte njerëzit pa gojë.

Kumaxhinjtë kishin mbetur pa gojë nga këto «shpikje» shkencore. Trepseja ecte krenar, me pamje të rëndë. Pas i vinte hija e tij, që i bindej qorrazi dhe që i ngjante një lepurushi, që ishte ngatërruar në këmbët e Trepse. Edhe Trepseja, edhe hija e tij, qëndruan para së ndarës sime. Trepseja u kollit. Pastaj më vështroi me ca sy zhbirues. Unë e kapa atë vështrim dhe e pashë nga koka gjer te këmbët.

Trepseja u vrenjt.

— Oj, oj, oj! Ujë, shpejt ujë! Atij po i digjet koka! Ujë! Koka po i digjet fare nga të nxehtët.

Trepseja vështroi përreth. Vështrimi i tij i flakëruar ndaloi mbi ujin e trashë të fëlliqur nga balta, në të cilin tullaxhinjtë zhyenin duart në pushimin e drekës. Ai mbërtheu govatën dhe ma hodhi ujin drejt e në fytyrë. Mua më zuri tmerri. Trepseja u përkul mbi mua dhe më vështroi me inat me sytë e tij të rrumbullakët. S'arrita dot të marr as me mend se ç'procedura të tjera do të vazhdonin, kur m'u zu përsëri fryma: «doktori» më squlli përsëri mirë me ujë të ftohtë.

Unë nisa të thërritja — dukej qartë se ata kishin vendosur të ma merrnin shpirtin. Unë rrokullisesha në tokë, i bija kokës me grushte. Aty përsëri më squllën për të tretën herë. U ngrita gati

për të kafshuar ndonjërin, Trepseja qeshte me zë të lartë:

— Shikojeni, pa shikojeni, u shërua!

— Bravo, Trepse! — thërritnin tullaxhinjtë. (Si ishte e mundur ai drej Llukovo të lindte një djall të tillë doktor!)

— E patë se ç'mjek jam unë? — çirrej Trepseja.

Unë e vështrova grindavecin që vërtitej rreth meje, me gojën të çapëlyer.

Hodha sytë tutje, andej nga pemët e stacionit, nga doktori, dhe i lëshova lotët çurk.

— Pse më merrni në qafë? Çfarë ju kam bërë, xhaxhi? Xha Trepse, mos më vrit mua!...

— Ha-ajde këtu, shejtan! Mos u tremb, mor budalla.

Ai më zgjati dorën, duke u përpjekur të më kapte. Tani mbetej vetëm lumi... Ishalla të shpëtoja. Po ai ishte i paaritshëm. Mua po më merrej fryma, po më pritshin forcat. Trepseja më zuri në çapin e tretë dhe, më ngriti në ajër si të isha ndonjë zog.

— Eh, ti, zevzek!... Ti je fare budalla. Unë do të të shëroj, o kungull! Do të të bëj trimosh.

— Ti do të më shërosh mua?... Vërtet? A mundesh të më shërosh, xha Trepse?

— Pse, si kujtove ti! Do të bëhesh i fortë si një buall!

Trepseja kërkon të gjejë një vend të thatë dhe më vendos drejt në tokë. Pastaj çpërvësh dorën lesh-tore, e fut në torbën e ndotur dhe nxjerr prej andej një shishe litërshe. Shishja është e mbushur me një lëng të zi si rrëshirë! Ai e përziën fort atë. Pastaj m'i kap nifullat me gishtërinjtë e tij të mëdhenj, ma vë në buzë shishen dhe nis të më shkundë lën-

gun e saj. Unë vetëm se dëgjoj se si përzihet ilaçi në gojën time dhe pres nga çasti në çast të shtrihem përmbys. Ilaçi i Trepes më shkrin në gojë dhe më djeg. Ai mban një aromë të keqe gjineshtre.

— Nuk du-u-a! Mjaft-ton... Do të mby-ytem!...  
— çirrem unë, duke u përtypur.

— Prit, prit, djalosh!

Doktori zbraz dozën e nevojshme sipas tij dhe më mbulon nga koka gjer te këmbët me batanije.

— E, ja! — thotë ai i kënaqur dhe më përkëdhel me dorë, që do të thotë «shërohu». Dhe largohet.

Unë u krodha në harresë, humba ndjenjat. Më mbërtheu një gjumë i thellë, i rëndë. U përpoqa të luftoja me të, i mblodha të gjitha forcat, por më së fundi, u dorëzova.



## KAPITULLI I SHTATË

Mëngjesin tjetër u zgjova së bashku me zogjtë. Mbi lumë ishte shtrirë mjegulla. Një re akoma më e dendur e kishte mbuluar kryepunëtorin, i cili po tymoste i ulur këmbëkryq. Unë e ndieja veten më mirë. «Ilaçi» i Trepes bëri çudira. Gjithsesi ai më shëroi. Vërtet se nuk më bëri as kreshnik, as buall, siç mburrej Trepseja, po sidoqoftë më ngriti në këmbë.

Ky fakt ra në sy menjëherë. Thirrja e kuqos: Krifi u shërua!» — e zgjoi Kristaqin, i cili po flinte paq, duke gërhitur ëmbël.

— Ashtu thua, pa betohu!

— Për besë!

Kristaqi e hodhi tutje brucën dhe erdhi pranë meje. Sa u gëzua ai! E preku me dorë ballin tim dhe thoshte duke u kthyer nga kumaxhinjtë:

— E shikoni? E shikoni?

— Të lumtë, Trepse! — thirri njëri prej punëtorëve, bashkëfshatar i Trepse, dhe përdrodhi mustaqet.

Të gjithë e përkrahën mendimin se Trepseja ishte një mjek i vërtetë.

— Dëgjo, Menelo... Fli akoma dhe dy - tri ditë, mblidhe veten, — më këshilloi miqësisht Kristaqi. Iu binda Kristaqit dhe fjeta edhe dy ditë.

Të shtunën, të gjithë do të shkojnë në qytet. Të gjithë, të gjithë. Bile dhe Pjetër-biska; atij i duhet të marrë paratë tek arkëtari dhe të paguajë tullaxhinjtë.

Kristaqi punonte duke mërmëritur diçka nëpër dhëmbë. Ai e kishte javën e fundit që po punonte. Ai nuk do të kthehej më këtu. Pas një jave do të martohej dhe do të mbetej në fshat. Me porosinë e të atit, ai kishte ftuar përzierësin. Në mesditë, Kristaqi u afrua tek unë, duke fshirë gojën.

— Nisemi bashkë, — tha ai dhe buzëqeshi i gëzuar, dhe me ëmbëlsi.

Erdhi darka. Kristaqi më mori në kurriz dhe më çoi në stacion.

Unë rrija galiç mbi kurrizin e Kristaqit. Ai po përpiqej të më thoshte diçka, të më vërtetonte se ai donte të më nguliste në kokë diçka të re. Më tregonte për diçka të panjohur. Unë ia mbështolla qafën me duar dhe po ndieja se si ngrihej dhe ulej lugthi i tij.

— Kështu, i vogli im, ja si janë punët. Kur të rritesh, të bëhesh zot shtëpie, unë do të vij tek ti në Athinë të pimë raki... Do ta shohim, a do të jesh ti në gjendje të më njohësh mua, punëtorin Kristaq? Do ta shohim, do të më gostitësh t'i mua, apo do të thuash: «Qërohu këtej, zbatharak! Unë nuk të njoh!» Do ta shohim!...

Ndërkohë që fliste kështu, Kristaqi u ngjiti te kodra. Përpara syve tanë u shpalos një mal i tërë me tulla. Dikush kishte qëndruar atje dhe po përshëndeste me dorë. Edhe unë gjithashtu tunda dorën. Dhe pashë se si ai njeri fshiu me mëngë sytë. Përzierësi... Përzierësi, shoku im i mjerë, i pastrehë... Mirupafshim. Qaj, mos ki turp. Po pse nuk po e shikon se si miku yt i vogël edhe ai po qan? Kushedi vallë, a do të takohemi?

— Më dëgjon, Menelo?

— Po, po, Kristaq.... Kristaqi im.

— Mos u tremb nga asgjë. Mos ua ki frikën një-rëzve të këqij. Pse? Sepse të gjithë të këqijtë janë frikacakë. Po qe se dhe ti je i keq, atëherë trembu, por trembu nga vetvetja!

Dhe kështu, ne mbërritëm në stacion!

Kristaqi u largua për pak kohë dhe u kthye me një letër të trashë në dorë. Ai e vendosi atë në xhep dhe e përçëndroi vështrimin në atë drejtim, nga duhej të vinte treni. Ai i largohej vështrimit tim dhe po e shante trenin për vonesën. Po, me gjithë të sharat e Kristaqit, treni gjithsesi po vonohej. Kur u mërzit së vonuari, ai erdhi. Kristaqi bëri të kthehej nga unë, po në çast i largoj sytë dhe nisi të vështronte retë dhe qiellin. Kurse duart e tij po përkëdhelnin kokën time. Pastaj ai, papritur, më lëmoi

flokët, më mbërtheu dhe më ngriti te shkallët e vagonit. Rrugë të mbare... Treni levizi vendit... Kristaqi pushoi së vështruari retë dhe une pashë se si sytë e tij u mbushën me lot.

Treni përshëllen i xhindosur. E të Kristaqin atje, në platformë, dhe nisem për rrugë. Ai rri në vend dhe ma bën me dorë. Ajri mbashet me përshëllima, me re avujsh, pluhur. Prej syve rrjedhin lot të hidhur...

Treni çan malin, kalon nëper të, del në liri, përsëri krijhet në të, e shpon atë, përshëllen — dhe ja ku ai përsëri është i lirë.

Treni, duke shfryrë, rrëshqet nëpër kordonin e hekurt. Duke vjellë tym me përshëllima, ai tremb kaçubet, që po e vërejnë atë nga anët e rrugës. Ai ecën si i çmendur, duke përshëllyer kërcënueshëm.

Të ishte kohë tjetër, edhe unë do të çmendeshin nga gëzimi, do të sulesha te dritarja dhe do të përshëndetja botën duke tundur duart, do të përshëndetja kaçubet, pemët, retë. Por tani ... Pasi të shfrynte disa herë, treni do të më shkarkonte në stacion me trastën në dorë. Siika, ndoshta, nuk merakoset më për mua, mbase nuk më pret fare, kurse njerka e saj do të jetë egërsuar akoma më keq dhe gjithsesi do të na ndalojë të takohemi.

Në mbrëmje atje, në kënetë, njerëzve do t'u mungojë një njeri dhe do të rrinë të mërzitur. Kristaqi me përzierësin ndoshta do të rrinë ulur diku pranë e pranë dhe do të tymosin në heshtje cigaret e tyre të këqija.

Pastaj, kur t'i mbarojnë cigaret, ndoshta do të fillojnë të flasin. Njëri prej tyre do të nisi të shkulë barin me gishtërinj, duke mos e ditur as vetë pse,

tjetri do të rregullojë jakën, e cila papritur e pakujtuar do t'i dalë se është e ngushtë... Kurse së largu mbi ta do të tretë vështrimin me mos përfillje hëna e zverdhur dhe e ftohtë.

Njëri do të pëshpëritë: «Hajde», — dhe do të çohet. «Hajde», — do të përgjigjet tjetri dhe gjithashtu do të ngrihet.

Do të çohen, do të ndahen sikush në punë të vet... Do të shkojnë të rrinë secili në vetminë e tij.

Treni i afrohet qytetit; së bashku me të po afrohet dhe nata. Fenerët ndriçojnë linjën, me qëllim që treni të rrëshqasë mbi të me besim të plotë. Kur arriti afër arrës, treni lëshoi fërshëllimën. Pastaj përsëri fëshëlleu te çisterna e naftës dhe, pas tri minutash, iu afhua stacionit. «Fr-r» — gërhi treni dhe ndaloi.

Hamejtë, si tufa karkalecësh, u sulën për te vagonët. Unë i kalova me shkathtësi dy-tre prej tyre dhe dola në rrugë. Në këtë orë të mbrëmjes, rruga e stacionit ishte mbushur plot me njerëz të veshur mirë. Sikur unë të lëvizja me torbën time përmes turmës, njerëzit ose do të më hapnin rrugë, të frikësuar se mos i fëlliqja, ose do të talleshin me mua. Prandaj, kur arrita gardhin, mora rrugën për në qytet monopartil.

Iu afrova banesës sime dhe çela derën. Në hundë m'u përplas era e rëndë e banesës së braktisur. Përkundraill, në shtëpinë e Siikës, ishte errësirë. Domethënë, atje gjithashtu nuk kishte njeri, në shtëpi mbretëronte nata. Në errësirë mezi zbardhëllonin perdet e dritares. Në qoshkun e ngushtë ishte shkretëtirë dhe qetësi. Çpështjellimi kishte marrë fund. Nënati i kishin tërhequr prej kohësh fëmijët nga

rruga. Vetëm në oborrin liqinjë po piqnin kuleçë dhe po qante një fëmijë.

U çel një dritare e ndriçuar, dikush pështyu në rrugë dhe dritarja u mbyll përsëri. Pas pak u errësua dhe ajo. E fikën dhe furrën. Fëmijën e përkundën.

Një djalosh me këmishë nate doli në ballkon, bëri punët e veta dhe shtoi të flinte. Në një kasolle blegëriu një dhi.

Përpëliti krahët një pulë, që u rrëzua nga koteci. Pastaj.... Pastaj gjithçka heshti...

## KAPITULLI I TETË

Ditën tjetër unë dola më herët në rrugë dhe për gjithçka pyeta një plak, që po fshinte me kujdes hundët.

— Siika? — ia bëri ai. — Të gjithë kanë ikur. Kanë shkuar në fshat.

— Në ç'fshat, gjysh?

— Pse, si, mos ke ndër mend dhe ti të shkosh atje. Në Cerkovjan kanë shkuar.

Unë e dija se ku ndodhej ai fshat. Po të ecësh si duhet, për gjysmë ore mund të mbërrish atje. Po fillimisht duhen fshirë këpucët dhe duhen ndërruar rrobat.

Të parën kisha mundësi ta bëja. Unë shkova në pazar dhe lustraxhiu Vasillaqis, një djale jabanxhi, veshur me xhup, m'i pastroi këpucët. Për sa i përket kostumit, atij i duhej të priste dhe një vit. Dhe, sado që zemra mezi ma duronte këtë, unë shkova me rrobat e vjetra. Ndalova pak, vetëm sa për të parë në dyqanin e galanterisë. Byzylykë, rruaza, varrese. Unë zgjodha një... unazë. Me gur të kaltër. Në oren katër hyra në fshat. Dëgjova tingujt e daulles që po luanin në një dasmë.

Khëng — xhëng — xhëng. Xhëng — xhëng — xhëng.

Unë mora guxim menjëherë, u nxeha, u mbusha me gëzim. Në kokë më mbinë fjalë të bukura, më rreshtoheshin në vargje kënge dhe, duke ecur rrugës, unë i fërshëlleja ato nën goditjet ritmike të daulles, që më shoqëronte hapat.

— Tam — tam — tam. Tam — tam — tam...

Gjithëcka në fshat ishte pastruar, gjithëcka shkëlqente. Kurse njerëzit dukeshin pa telashe.

Shtambat me verë shkonin tutje-tëhu, si të ishin kërcenjtë në bankën e marangozit.

— Sarap!

— Sarap!

— ~~Sarap!~~ — thërritnin të gjithë. Dikujt iu kujtua emri turqisht i verës — sarap — dhe kjo fjalë kalonte gojë më gojë.

Në sheshin e gjerë, të pastruar me kujdes, vallëzonin në tri rrethe. As që më shkonte ndër mend se vendësit e urtë dhe cerkovianasit mund të ishin valltarë kaq të apasionuar. Veçanërisht kryeplaku! Ai thërriste, kërcente si t'i kishte këmbët me susta, vërtitej me furi dhe, me një krenari prej djaloshi, i



binte gjoksit. Këta numra e ngrinin peshë gjithë rrethin e valltarëve. Kurse muzikantët po shkriheshin nga tingujt që nxirrnin dhe gati sa s'kërcenin përpetë.

— I-i-ah-ah! — bërtiste daullexhiu dhe s'po i zinte këmba vend nga qejfi.

Arixhiu, që po i binte fyellit, e ngrinte këngën e vet në qiell. Edhe fytyra e tij e djersitur, edhe gërneta ishin drejtuar nga dielli, njëlloj si sqepi i mëllenjës që po këndon. Punën më të madhe, më të hollë e bënte gjajdexhiu. Për të mos e lodhur veten, ai e kishte vendosur kacakun prej lëkure qengji të fryrë mbi gjunjë dhe e bënte atë të kërciste si duhej. Kjo ishte diçka për t'u çuditur! Tingujt dilnin nga lëkura e qengjit diku, që poshtë këmbëve. Qejfliu i gjajdes, duke e shtrënguar atë pas vetes, e bënte të blegërinte, kurse vetë admironte valltarët. Kur zëri i lëkurës së qengjit dobësohej, gjajdexhiu, i përkulur mbi të, i frynte përsëri, sikur po e kafshonte në qafë, dhe qengji niste të lëshonte tinguj me një forcë të re.

Gjë tjetër e çuditshme ishte rrethi i valltareve gra. Dukej sikur në oborr kishin sjellë një shirit nga lëndina e majit dhe ja ku ai lëvizte, duke u lëkundur. Prijësja e valles i jep dorën e majtë tjetrës që e pason sipas rrethit, kurse në të djathtën, të përkulur në bërryl, mban shaminë shumëgjyvrëshe. Tani njëri prej djemve — vëllai i saj, kushëriri ose fqinji — shkon te gjajdexhiu dhe, pasi e lag me pështymë monedhën, ia ngjit atij në ballë.

Pak më tutje vallëzojnë fëmijët. Po Siika? Derisa ajo nuk ndodhej në dy rrethet e para, ku mund të ndodhej?

Po, unë nuk u gabova, ja ku është ajo! Vallëzon më shumë nga të gjithë dhe më mirë nga shoqet.

Nga djemtë binte në sy Dhrosiadhisi, i biri i një tregtari të pasur, që banonte aty pranë nesh. Ai nuk vallëzonte, nuk bënte asgjë. Ai mbahej aq me të madh, sa njerëzit nuk ia ndanin sytë.

Siika kryeson vallen. Gërshetat e saj tunden sa andej-këtej. Ja tani, nga çasti në çast, ajo do të më vërë re mua dhe hopla! — do të kërcejë përpjetë nga gëzimi. Po ajo nuk po më shikon. Ajo është kredhur në vallëzim. Ajo e ka mendjen që të mos ngatërrojë ritmin e vallëzimit, që të mos ia arrijnë shoqet.

— Bravo, Siika! — e përshëndetën atë.

Ah, kështu! Dhe unë marr vendimin. E ç'vlerë ka për mua një dhrahmi?

Me një pamje krenare e nxjerr atë nga xhepi dhe e lë që ta shohin të gjithë. Të gjithë duhet të dinë se këtë e bëra pikërisht unë. E mbaj atë me dy gishtërinj (unë kisha parë se si vepronin të rrëzimit) dhe e hedh pa kujdes para këmbëve të gajdexhiut. Atij i qeshi fytyra, njëlloj si dhe daullexhiut, po unë nuk i kushtova vëmendje. Pëpritur, vallëzimi u ndërpre.

...Dhrosiadhisi, ai kopuku i lagjes sonë, që e mbante veten për kushedi se çfarë, i afrohet gajdexhiut dhe — një, dy — i ngjit në ballë dy monedha prej argjendi, fringo të reja, kurse dhrahminë time ma hedh te këmbët. Unë ngriva i tëri. Përkulem, ngre monedhën time, e shtrëngoj atë në dorë dhe e rras thellë në një qoshe të nxehtë të xhepit tim. Me qëllim që ajo të mos mbetet e fyer. Që mos të ankohet. M'u zu fyti, m'u bë një lëmsh

në grykë. I mbledhur si rabecka në dimër, unë ulem mbi një degë peme të thatë, në mes të arës. Ç'të ftohtë që provova papritur!

Po dielli? Ai u duk sikur ishte mbuluar me një shirit. Pastaj gajdja, si ndryshoi ajo?! Tingujt e saj, që tani i ngjanin një çjerrjeje prej qengji, që po e therin, vinin deri aty prej së largu, nga thellësitë.

## KAPITULLI I NËNTË

Nata bie me të shpejtë në shpatet e maleve. E mbështjellë me mbulesë të zezë, ajo hyn në qytet. Mbi një gur rri një plakë, vë veshin e dëgjon se si këndon lumi. Unë ndaloj pranë saj dhe kollitem. Ajo zemërohet, ngaqë unë i pengova dëgjimin.

— Afrohu më afër, — më thërret ajo. — Për ku je nisur? Dhe pse je aq i mërzitur?

— Unë po kërkoj punë.

— Punë? Këtu? Në lumë? Po pse, mos je bretkosë ti?

— Unë kërkoj punë. Nuk të kuptoj se ku e ke fjalën.

— Po unë të kuptoj se ç'po thua. Ndoshta ty të kanë rrahur rrugaçë! Ë?

Unë ika. Ajo vazhdonte të rrinte mbi gurin, duke u përpjekur të kapte sërishmi këngën e lumit. Po afrohej nata, në kori je dëgjoheshin bulkthet, duke prishur qetësinë e mbrëmjes.

Shtrëngoj kokën me duar, duke u përpjekur të shtrydh ndonjë mendim. Numëroj me mend gjithfarë profesionesh, njërin pas tjetrit.

A mund të bëhesh prift? Mësues? Sipërmarrës? Xhandar? (Po, ta lëmë këtë të fundit).

Megjithatë, ka ca punë, të cilat mund t'i kryejnë edhe fëmijët, por i kanë pushtuar për vete të rriturit. Shitës — unë e kam provuar vetë bukurinë e kësaj pune. Lustraxhi — duart i ke gjithmonë pis dhe s'fiton dot as për të blerë një copë sapun. Çoban — gjithë vitin të torturojnë duke të kthyer në skllav; të shajnë me ç't'u vijë nëpër gojë dhe të ushqejnë me ca thërrime.... Le ta lëmë dhe këtë. Mjafton. Punë të tjera nuk ka për fëmijët. Ku tjetër kam parë fëmijë? I kam parë ata në arka prej druri — të shtrirë së gjatë-gjerë, pa gojë, kredhur mes lulësh. Atë ditë, fëmija duket i rëndësishëm. Përreth njerëzit qajnë, i bien kokës me grushte, çirren. I përgjumur midis lulësh dhe tymit të thimjanit, ai duket i madhërishtëm dhe sfidues para të gjithëve. Po kjo festë nuk zgjat shumë. Përfundon madhështia, marrin fund ceremonitë, atë e lënë të vetmuar në dhe, pastaj për një kohë të gjatë e lënë pa e vizituar. Kurse atje, thellë nën dhe, bën ftohtë, gjithçka ngrin. Atje nuk ka as zjarr, as oxhak...

## KAPITULLI I DHJETË

Diçka e padëgjuar, e pakapshme për trurin ndodhi në qytetin tonë. (Ky vit është plot ngjarje të jashtëzakonshme). Ja, ka plot dy javë, që flasin vetëm për këtë gjë. Njëherë kafene, oborre, në lagjet e banuara nga jabanxhinjtë, — gjithandej flasin vetëm për një gjë. Bile dhe nëpër kisha. Gjithandej dëgjon: «z-z-z» — dhe me vete mendon: «Ja, ç'njerëz të mirë! «Po sikur t'i dëgjosh mirë, e kupton se ata i bien një avazi krejt tjetër.

Kanë kaluar pothuaj njëzet ditë dhe bisedat ende nuk kanë pushuar. Të rriturit flitnin për «Kryqëzatën e dytë», të rinjtë kishin hequr dorë nga bixhozi, nikoqiret gatuanin shkel e shko. Sa për fëmijët, s'ke se

ç'thua, ata llomotitnin mbarë e prapë dhe merrnin vazhdimisht zero në mësim.

Ky lajm mbërriti gjer në fshat. Tani më ra ndër mend se për këtë ishin dëgjuar fjalë edhe në punishten e argjilës, po, po. Më kujtohet se si kuqoja u përpoq të thoshte diçka për këtë punë, por ata e hodhën plluj, brenda në pellgun e fëlliqur dhe atij i iku dëshira për ta zgjatur më tej atë muhabet.

Kështu pra, kjo ishte e vërtetë. Unë isha i sëmurë dhe ditët e para nuk e vrava mendjen fare për atë punë, po dalngadalë edhe unë u bëra kureshtar.

Çudia ndodhi atje, kur kryqëzoheshin rrugët për në stacion dhe në Kypri, tamam përkundrejt vendit, ku uji i lumit turfullonte e zbardhonte në ca shku- ma si ishuj qumështi. Nga jashtë nuk kishte asgjë të jashtëzakonshme, ishte një shtëpi e madhe, e gjatë si një stallë, mbuluar me çati hekuri.

Sikur të mos e dije punën, mund të shkoje aty pranë dhe të mos ia ktheje sytë. Kështu thoshin se vepronin zakonisht. Vetëm banderola e varur aty (po të ishte sadopak me shkollë, edhe mund ta lexoje) të bënte të mendoheshe: «Kinimatovermion»<sup>1)</sup>. Gjys- mën e dytë të fjalës edhe mund ta kuptoje. Të gjithë e dinë se ç'është Vermioni: një mal i madh, në shpa- tin e të cilit është ngritur Vodena. Bile edhe plakat e dinë këtë gjë, megjithëse ato nuk e pranonin, që edhe malet tani kanë emra. po kjo është një punë tjetër. (Këtu nuk ka asgjë të çuditshme, po deshët më be- soni).

Brenda sallës së madhe, siç thonë, ka një tjetër më të vogël. Me karrige. Dhe një mur i saj është

---

1) Kinimatovermion — kinema (gr.).

i magjiishëm. Ai papritur çelet dhe atëherë... Mba-hu, o zemra ime! Në mesin e murit ndodhet një dritare, po, sa kohë kinimatovermioni është i mbyllur, ajo është e zënë me një perde të madhe.

Dhe tani dëgjoni si ndodh çudia. Dikush, diku (kjo nuk duket) fik dritën elektrike e çel perden dhe në dritare shpaloset një botë tjetër. Trena, dete, kuaj, njerëz — dhe jo si te Llukasi, po që lëvizin. Po, a mund të mos luash mendsh aty? Më i mrekullueshmi ishte një i ri me çizme, me pantallona prej lëkure, me një triko të thurur dhe me dy revolverë; ai bënte gjithfarë numrash dhe vodenasit u dashuruan pas tij, saqë ishin gati ta mbanin në duar. Atë e quanin Pjetër. Një kalorës i mrekullueshëm, boksier i prapë... Ai i paloste menjëherë njëqind kundërshtarë. Kapela e tij ishte aq e madhe, saqë tregtari i zarzavateve mund ta përdorte për bukuri në vend të shportës. Bukuria e tij u bë legjendë. Dhe prandaj atij ia falën kusuret, kur në fund ai rrëmbeu një bukuroshe.

Unë u bëra kureshtar të dija nëse ndokush kishte provuar të depërtonte në atë botë, kur ishte e çelur dritarja; mua m'u përgjigjën: «Jo». Mirë...

Dhe ja, njëherë unë u nisa për në kinimatovermion. Zemra më rrihte në gji si zemra e një zogu. Te hvrja rrinin njerëzit kureshtarë. Rrinin grupe-grupe dhe bisedonin me zë të lartë. Po unë nuk kisha kohë për llafe. Unë ngutesha të futesha sa më parë në sallë dhe të shikoja se c'ndodhte në dritare. Po pse atë djalin e quanin Pietër? Kjo ishte e vetmja gjë që ma prishte humorin. Nuk mund ta kuptoja aspak, pse atë e quanin niëlloj si biskën. A thua nuk u ngjend një emër tjetër për të?



Unë i bëra veshët pipëz. Qetësi... E çuditshme. Më kishin thënë se vodenasit fjaloseshin me zë të lartë me atë djaloshin, aq sa e pengonin të bënte punën e vet. Këto thirrje e bënin atë që të humbiste toruan. Kurse i shkreti Pjetër kishte shumë telashe. Atë gjithë kohën e ndiqnin, duke u përpjekur ta grabitnin ca bredharakë të këqij. Nganjëherë ata ngjiteshin fshehurazi, kur Pjetri flinte. O, nuk mund të thuhet me fjalë se ç'bënin vodenasit në përpjekje për ta zgjuar atë. Fillonte një lëmsh i vërtetë: thirrje, bërtitje, fërshëllima çjerrëse, përplasje karri- gesh. Banorët që kalonin nga stacioni, ndaleshin të pyetnin se ç'po ndodhte. Fatmirësisht, Pjetri zgjohej prej thirrjeve dhe i dërgonte horrat në djall.

Atëherë shpërthente rrëmuja në kinimatovermion, sepse çdo njeri përpiquej të vërtetonte se ishte pikërisht ai që mundi ta zgjonte Pjetrin.

Por ende pa u qetësuar spektatorët, Pjetrin e pllakoste një fatkeqësi tjetër. Kur ai shpëtonte prej kësaj fatkeqësie (dhe ai nuk kishte si të mos shpëtonte), e gjithë salla shpërthente nga të thirrurat. Gëzimi ishte aq i madh, sa që njerëzit u binin karrigëve me duar e me këmbë — duartrokitjet atëherë nuk ishin në modë.

Unë gjeta tri dhrahmi. Dy e gjysmë për lotrën, të cilën duhej ta mbaja në dorë, dhe gjysmën për mente. Pa mente, më mirë mos të hyje atje; muret, edhe ato do të qeshnin me ty. Porse, të hyja vetëm, nuk po guxoja, prandaj ndalova një kalimtar, që po shkonte për atje. Ai ishte një djalë jabanxhi, i veshur me gozhup të lëkurtë, një fqinji im.

— Kë po shkon të shikosh?

— Unë? Pjetrin.

— Atje është ai?

— Atje, atje...

— Po pse, në kinimatovermion asgjë nuk ndryshon, gjithmonë Pjetri po Pjetri?

— Eh, ç'po përrallis dhe ti!

— Pse?

— E si pse? Po pse, a mund të rrijë kinimatovermioni pa Pjetrin?

Le të ishte ashtu, po mua nuk po ma ngrohte zemrën. Unë do të doja të shikoja ndonjë gjë tjetër. Dhe rrija e pritja të dilte ndonjëri dhe të njoftonte se ç'po bëhej atje. Mbase do të më ndihmonte fati t'i shpëtoja të tri dhrahmitë.

Kur, papritur, nga salla shpërtheu turma. Sado e çuditshme që duket, fytyrat e shumicës prej tyre ishin të vrenjtura.

Njerëzit që po pritnin në rrugë e po shaheshin, u sulën tek ata të merrnin vesh të rejat.

— Nuk është Pjetri, — përsëritnin ata që po dilnin prej andej. Pështynin dhe iknin. Të gjithë ishin të inatosur, të çoroditur. Vodenasit ishin mësuar me Pjetrin, kishin ndër mend të lidhnin miqësi me të. Dy muaj ai ndenji me ta, ata akoma nuk e kishin vërejtur siç duhet. Dhe ja ku tani, kur ata kishin vendosur ta bënëin atë vodenas, bashkëqytetarin e tyre — në qytet ekzistonte një zakon i tillë — atë ua rrëmbyen.

Dikush bile, nga zemërimi, e hodhi tutje karri-gen, i hodhi të gjitha gjërat që kishte blerë. Pas pak u duk edhe fqinji im.

— Nuk është Pjetri, — tha ai i revoltuar.

Unë isha i kënaqur. Dëshira ime u plotësua — Pjetri nuk ishte më aty. Le t'ia zëjë vendin kush

të dojë atij — Vangjelisi, Dhimka, Jovani — njëlloj, kushdo qoftë. Për mua mjafton që nuk është Pjetri. Unë shkova te trashamania, që ndodhej pas dritares, dhe i dhashë asaj të dy dhrahmitë e gjysmë.

— Më jep një letër, po të mirë.

Pastaj i mbusha xhepat me fara dhe hyra brenda. Nuk arrita të ulesha, kur u bë errësirë dhe zotëroi një heshtje e thellë. Mund të thoshe se aty nuk kishte frymë njeriu të gjallë, po të mos dëgjohej kërcëllima që të kujtonte përtypjen e lopëve.

Në errësirë, duke mos ditur ç'të bëja, unë desha të lozja, kur dy duar të fortë prej fshatari më mbërthyen dhe më ulën me forcë në karrige.

Ra zilja. Perdja u çel. Dhe ja, në dritaren e çelur u shpalos qyteti i madh, i pasur, i bukur... I panjohur nga të gjithë. Por mua nuk më gënjeu dot. Unë e njoha atë përnjëherë, megjithëse aty pranë nuk kisha Llukasin që të jepte shpjegime.

— Parisius! — thirra unë. Dhe unë nisa të tregoja me hollësi për ato që dilnin në skenë: për kullën prej nga vrojtojnë vjedhësit atje ka prej atyre sa të duash — por një pickim i hidhur prej gjarpri ma qepi gojën.

— Psh-sh-sh!... — dëgjova t'ia bënin përreth. Dhe unë heshta. Heshta dhe nisa të shikoja i ngrirë dhe i dehur nga entuziazmi. Të shikoja me sy të kthjellët kinimatovermionin.

## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Dhe unë përsëri drejtohem për në Vlladovo. Eci, eci, por rrugës nuk i gjendet fundi. Anës tjetër të lumit, si të ishte një varg buallicash, zgjatej treni. Dhe ja ç'gjë e çuditshme që ndodh. Po të shkojë te përgjegjësi i trenit ndonjë trashalug me një monedhë joshëse qindëshe në dorë dhe t'i thotë: «A nuk më shpie gjer në Vlladovo?», tjetri përgjigjet: «Urdhëroni, urdhëroni, kaloni!». Po sikur atij t'i afrohet një jabanxhi i lodhur, i dobët, i cili edhe vend në tren pothuaj nuk zë, dhe t'i thotë: «Më gjeni ndonjë vend, zoti përgjegjës i stacionit, qoftë edhe mbi çati, dhe më çoni vetëm gjer në Vlladovo». — zoti shef i stacionit kujtohet për pozitën e vet dhe të jep një përgjigje të flohtë, therëse, si një thikë: «Ndalohet!».

E, ç'njerëz që janë!... Disa kështu bëjnë gjithë jetën, përsëritin po të njëjtën fjalë: «Ndalohet!» Rrinë pranë dyerve dhe e gjithë puna e tyre është të mbajnë në dorë një dërrasë me mbishkrimin: «Ndalohet!» Dhe, kur e shqiptojnë këtë fjalë, ata kujtojnë se e kanë bërë punën, fryhen si kacek dhe e mbajnë veten rëndë-rëndë.

Asgjë nuk më inatoste më shumë se kjo fjalë: «Ndalohet!» Unë kam parë shumë njerëz, bile edhe veten time e kam studiuar mirë. Sepse edhe unë njeri jam. Po, kudo që provoja të futesha, më kapte për jake kjo «ndalohet!» Unë kam parë se si ca fëmijë luanin me rërë dhe shkriheshin së qeshuri. Një lojë mjaft tërheqëse. Edhe unë u përpoqa të lozja, por hasa të famshmen «ndalohet!»... Mua m'u mërzit gjithçka, më erdhi në majë të hundës kjo «ndalohet!» dhe u përpoqa mos ta hasja kund. Unë e kuptoja se kështu janë ndërtuar gjërat në botë. Një rregull i padrejtë, i fëlliqur. Edhe unë e vendosa njëherë e përgjithmonë: kur të rritem, do të ndaloj patjetër këtë rregull. Kështu nuk do ta lë më. Fëmijët atëherë do të jetojnë ndryshe. Vetëm më lini të rritem, pa llafosemi pastaj.

Sot, duke u ngjitur kodrës zbathur, unë e përforcova më shumë këtë vendim. I kënaqur, po ecja disi më i gjallëruar. Sikur të më tërhiqte dikush për tërkuzë. Po... si të jetoja deri atëherë?

Këmbët e mia të holla si kallama ishin zverdhur nga sëmundja.. Edhe vetëm buka kushtonte shumë shtrenjtë.... kurse rruga ishte e gjatë.

Unë gjeta një shkop dhe e bëra atë si kërrabë. O, sikur të kisha një tren! Unë do ta kisha këmbyer tani urrejtjen me mirësinë dhe do të kërkoja të më

ndihmonte. Le të më gjente një vend në njërën prej rrotave të tij dhe le të vërtitesha dhe unë bashkë me të. Në gjithë botën besoj se nuk kishte djem, të cilëve u duhej kaq shumë treni sa mua. Po ku ta merrja se?

Trenat unë i kam studiuar për bukuri. Ua dija të gjitha huqet atyre. Duke jetuar për shumë muaj rresht në Vertekop, jo shumë larg stacionit, unë i sillja ndër mend ata nga i pari gjer tek i fundit, me të gjitha shenjat e tyre dalluese. E dija se si fërshëllente treni i mallrave, ai i Vitolës dhe ai i Selanikut. Të gjithë trenat.... Vetëm me njërin prej tyre unë nuk desha të njihesha mirë, për shkak të fodullëkut tij. Ai ishte një tren i gjatë, aq i rehatshëm, aq i rëndë, saqë, për të ndaluar te stacioni ynë, e quante për fyerje të madhe. Ai fluturonte si shigjetë pranë nesh, duke fërshëllyer, dhe pastaj gjarpëronte në luginë. Vetëm më të rrallë, kur linja ishte e zënë me ndonjë tren të fëlliqur mallrash, ai ndalonte në mes të grumbullit të qymyrit, duke nxjerrë tym, ashtu siç bëjnë zotërinjtë e rëndë, kur tymosin cigare. Unë nuk ia dija emrin atij — ai ishte shkruar frëngjisht.

Njëherë, kur treni ndaloi pranë grumbujve të qymyrit, unë nxora lapsin nga xhepi dhe, i ulur përkarshi, nisa të shkarravitja atë emër. Germa e parë ishte «E», pastaj «X», si e greqishtes, «P»-ja gjithashtu ishte e njohur për mua. Germa tjetër i ngjante «R»-së, vetëm me një gremb në bark — «R». Pastaj vazhdonte përsëri me «E». Më tej përsëri hasa në vështirësi: dy germa të njëllajta, që u ngjanin dy gjarpërinjve, që kishin kapur veten e tyre për bishti. Ja të tilla: «SS». Vetëm gjashtë germa «EXPRESS», — provo, të kam rixha, ta kuptosh.

Unë e vizatova këtë fjalë në letër dhe, pa treguar se ku e kisha gjetur, ua dhashë ta shikonin të gjithë. Po më kot — askush nuk mund ta lexonte atë fjalë! Më së fundi iu drejtova hallë Katerinës. (Ishte një gjë e mirë që ishte ajo dhe gjithsesi mund të ma bënte të njohur botën). Unë e gjeta atë duke ngrënë drekë. Ajo fshiu buzët, mori letrën, e shkundi, e nuhati....

— Ku e gjete këtë? — pyeti ajo e ngrysur.

— Ja atje, te treni që kalon me hundë përpjetë, pa e ndalur vrapin.

Hallë Katerina ma ktheu mbrapsht letrën.

— Unë nuk mund t'i kuptoj këto gërma si këmbët e pulës, por e di se si quhet.

— Si?

— Eksipire!

— Eksipire? Ja se ç'na qenka! Po ç'do të thotë kjo?

Katerina bëri sikur nuk dëgjoi gjë.

— Nuk e dini, o hallë? — këmbëngula unë.

Hallë Katerina nuk e përmbajti dot veten:

— Mos ka ndër mend zotëria juaj të më mësojë mua?....

— Po, sidoqoftë, ç'kuptim ka?

— Ç'kuptim ka? Ja çfarë.... Domethënë, që treni është për njerëzit e mëdhenj... Tren zotërinjsh. Ja ç'do të thotë. Hë, dhe tani mbathja andej nga erdhe.

Po, duhej të ikja. Por, gjersa e gjeta atë, pse mos të pyetja që të më shpjegonte edhe diçka tjetër? Një mundësi e tillë të paraqitet rrallëherë në jetë e jo çdo ditë.

— Hallë...

— Hë?

— Dua t'ju pyes për diçka.

— Pyetëm. Vetëm shpejt, sepse më duhet ta mbyllim sa më shpejt dyqanin.

— Kam kohë që e bluj këtë gjë në mend. Me ç'punë merret zoti?

Halla u bë sikur t'i kishin hedhur ujë të nxehtë në kurriz.

— Me ç'punë merret?

— Po, me se merret? Me asgjë?

Ajo m'i nguli fort sytë:

— Si me asgjë?! Ai punon, dhe ç'të punuar se! Ja se ç'të pjell mendja edhe ty!

— Po çfarë bën ai?

— Vë rregullin në botë.

Katerina fshiu djersën.

— Kështu... Po, a nuk më thoni, moj hallë....

— E ç'të të them tjetër?

— Desha të të pyes për punën e trenave. Edhe trenat ai i drejton?

— E kush tjetër, përveç atij?

— Epo, rregullin ai e paska të keq!

— Çfarë?

Hallë Katerina u hodh përperjetë si me sustë.

— O perëndi e madhe! — mërmëriti ajo, duke e përqëndruar vështrimin drejt qiellit. — Mos e dëgjo se ç'thotë ky budalla. Ai është i vogël, pa tru... Fale atë.

Dhe shtoi, duke m'u drejtuar mua:

— Pse i bie më qafë zotit?

— Po pse zoti e lejon zotin Avgerinos, atë bulla-fiqin, të zëjë vend në tren qoftë edhe për një gjysmë ore rrugë. kurse plakun Apostolos, atë thatanikun, e lë të eci më këmbë ngarkuar — u-u-u! — deri në Nausta?



Zarzavateshitësja më vështroi mua që poshtë vetullave me ca sy si të maces.

— Kështu, domethënë, perëndia edhe trenat i drejton!

— Oh, jo, o bir, — më kundërshton ajo me të butë. — Jo, për këtë unë nuk zotohem.

Dhe gjithë ditën ajo ndenji e ngrysur. Shumë. Më shumë, bile edhe nga unë...

Unë isha në gjysmën e rrugës. Prej aty zinte fill rruga që ngjitej përpjetë dredha-dredha. Perëndisë së ujit, siç dukej, i kishte ardhur keq për udhëtarët dhe në këmbë të malit kishte nxjerrë një burim, që ata të mund të freskoheshin. Uji i tij ishte i pastër si kristal, megjithëse aty kishte pirë dikur djaloshi zeshkan. Edhe unë, sic e dini, mbeta i bardhë. Tani papritur m'u kujtua kjo gjë. (E, ç'gënjeshtar që ishte dhe ai kuqoja!)

Unë laga një copë bukë në ujë dhe u ula tutje, mbi një gur, pikërisht mbi atë gurin, në të cilin dikur ishte ulur arixhiu. Unë rrija dhe haja bukë me oreks, duke lëpirë gishtërinjtë.

Pasi i dhashë fund bukës, piva përsëri ujë dhe bëra tutje rrugës. Një zog i uritur, kur vuri re se unë u largova, fluturoi për te guri dhe nisi të mblidhte thërrimet me nxitim. Ha, o mik, kushedi se ç'të ka përgatitur zoti atje lart në qiell.

Zogu hëngri. piu ujë dhe fluturoi. Rrugë të mbarë!

Tregoji, o Shvavri, perëndisë për punën e trenave.... Tregoji, qoftë edhe sikur të mos e dish gjuhën e tij. Jepi atij të kuptojë se neve, fukarenjve, na ka ardhur shpirti në majë të hundës.

## KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Në Vlladovo mbërrita në mesditë i vvarë shpirtërisht. Errësirë. Qetësi. Kumaxhinjtë rrinin të heshtur në diell dhe mijëra lutje nuk do t'i detyronin ata të hapnin gojën. Bile as të kollitëshin. Me gojë e mbyllura, vështronin njëri-tjetrin si të ishin të huaj. Kristaqi, Jovanisi, përzierësi — miqtë, të cilët mund të më përkëdhelnin dhe të më ngushëllonin, ishin larg prej këtu.

E kë të pyetja? Disa as që më njihnin fare. Të gjithë, siç dukej, i kishte pllakosur heshtja. Një kumaxhi, që nuk dinte as edhe një gërmë, diçka po shkruante në dhe, pastaj pështyu mbi atë që kishte shkruar, e fshiu me këmbë dhe zuri mjekrën me dorë.

— Pse nuk po bie çanga? — e pyeta unë.

- Nuk bie, — tha ai i vrenjtur.
- Po pse nuk ia mblidhni atij?
- Nuk mundemi. Ajo nuk do të bjerë më.
- Po pse, nuk mund të fillohet pa rënë ajo?
- Jo.
- Pse?
- Sepse, pa çangë — domethënë pa para!
- Si është kështu kjo punë?...
- E — eh.... si kështu, si kështu! Ja kështu, de.

Pjetri e mbylli dyqanin, sepse sipërmarrësi nuk jep më para. Pështyu duart, tha «pushim» dhe iku, pasi i mblodhi rraqet e veta. «Pushim», — përsëritën pas tij të tjerët, morën plaçkat dhe u larguan.

Shkoj më tej dhe shoh: Pjetër — biska rri në pozicionin e tij.

Në një përrallë, dikur kam lexuar për njerëzit e ngurosur. Të ngulitur në tokë, ata mendohen për diçka nën qiellin e hapur. Dhe ja, kjo përrallë u bë realitet. Biska - Pjetër - kreshniku flinte i qetë nën batanijen e vet, kurse ne, njerëzit e ngurosur, duhej ta zgjidhnim vetë fatin tonë në mes të rrugës. E, geni! Rri shtrirë dhe kundron gishtërinjtë me sytë e tij si prej kallaji. Mua më mungonte guximi t'ia prishja rehatin. I trembesha së vërtetës. Sikur ai ta çeli gojën dhe të thotë «pushim» — unë do ta humbitja. Ngriva në vend. Por, sidoqoftë, e vendosa dhe çela gojën:

— Pjetër... — pëshpërit unë si të jem në buzë të varrit.

Ai nuk më dëgjon. Ai fle. Ai nuk është njeri, ai është një buall që zhgërryhet në kënetë. Të duket se mjafton ta prekësh sadopak dhe të zhyhesh i tëri. Po mua nuk më mbetet gjë tjetër. Mua më duhet

ta zgjoj. Duke iu afruar atij, unë i bëra duart si bori dhe nisa t'i fërshëllej në vesh, si një vapor:

— Pjetë-ër!!

Këneta për një çast u lëkund dhe u dëgjua zëri i përgjumur:

— A-a-a?

— Pje-e-tër! — thirra unë përsëri, duke prekur me buzë flokët që i vareshin pas veshëve. Ai nuk lëvizi prej vendit, vetëm gërhati.

Ai i ngjante një njeriu që ka vendosur të mbytet dhe ka frikë se mos e pengojnë.

— Pushim? — pyes unë duke u dridhur si një fletë e zverdhur.

Me një dhëmbje në zemër po e shtrëngoja të vetmen monedhë pesëdrahamishe që më kishte mbetur në xhep.

Ai e tha fjalën e vet dhe kafshoi gjuhën.

— Pushim?

As edhe një zë. Të paktën të kishte lëvizur gjëkund një qengj që ta prishte qetësinë prej varri. Pjetri ishte kthyer njëherë e mirë në gur dhe s'kishte pse të shpresojë se mos fliste. Atë thujse e kishin lyer me baltë dhe e kishin lënë të thahej.

Unë ktheva nga qielli sytë e mbushur me lot. Për herë të parë e vura re se moti po prishej, se po dendësoheshin retë.

— Shabash!') — thirra unë.

Nuk u dëgjua as edhe një zë si përgjigje. As edhe një frymë njeriu.

---

1) Shabash — pushim (turq.)

## KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Një re e madhe u var mbi mua, si të ishte një skifter që sulet mbi prenë e vet. Pastaj u sul nga dielli dhe e errësoi atë. Nga mali fryu era dhe e shoi zjarrin diellor. Qielli u errësua tej për tej. Lumi u nxi. Vera po largohej, duke u fshehur në thellësi të shpellave. Po afrohej dimri. Së largu dëgjohej rrapëllima e trokthit të tij të rëndë.

Milingona, që u gjend zbuluar, u ngjit mbi kashtë. «Prit edhe pak, prit edhe pak, lëna të mbledhim kokrra!»

U kollit gjinkalla e ftohur: «Prit pak, më lër dhe ca sa të mbaroj këngën time!»

Hardhuca e gjelbër tundi putrat e veta: Prit edhe pak, më lër të mbaroj strehën!»

Por toka ishte e një mendimi tjetër: «Rregullohuni si të doni! — thërriste toka. — Buzët e mia janë tharë nga etja».

Fshatarët ndaleshin dhe shikonin retë. Vështrojnë lart, duke mbajtur kapelat në duar: «Qofsh fa-lë»...

Fluturat u fshehën nga frika.

Gjithçka: insektet, rrëshqanorët, zogjtë, — të gjithë ia kanë hyrë punës... Po ti, ç'më rri duar-kryq, o muhaxhir? Derri i mbiquajtur Pjetër u fsheh në strofkën e vet... Gjarpërinjtë e ujit u krodhën thellë në baltë (shelgu është prerë). Po ti ç'po bën, ç'pret, o jabanxhi?

Ti nuk ke askënd në këtë botë. Çohu. Gjithçka u shkatërrua, u palos nga rrotat vërtitëse... Arixhiu, Jovanisi, Shyqyriu... Çohu! Po ku do të shkosh, o ditëzi?...

Gjithçka ngrin përbrenda. Nesër do të trokasë dimri. Dyert do të mbyllen fort përpara erës dhe fukarenjve.

— Nuk kemi punë për harabela të tillë! (Kur-se harabelat do të flenë nën kornizat e veta).

— Të vdesim?

(Mua m'u kujtua Kristaqi... «Do që të vdesësh — urdhëro»).

Tullave nuk u lejohet kjo gjë. Nesër do të vijë kamioni që t'i ngarkojë dhe t'i çojë në qytet. Në pranverë me to do të ngrenë shtëpi, ku do të strehohen Dhrosiadhësit dhe do të pështyjnë nga lart poshtë. E kujt i duhesh ti? A vlen ti për të ndër-tuar shtëpi? Jo. Domethënë, hiq dorë nga çdo shpresë.

Unë isha ngopur me fatkeqësitë e mia. Nisi të më mbërthente gjumi. Por, pa arritur të mbyllja sytë, më zgjoi tingëllima e kambanës, që i ngjante ziles së shkollës. (Siç dukej, diku ishte shpallur pushimi.) Çel sytë... Në rrugën e sipërme përçapen një plak dhe një gomar. Gomari përpara, pas tij, duke u kollitur dhe duke çaluar, zvarritet plaku. Duke e mbështetur mbi shkop rininë e vet, ai përpiqet të eci me një hap me gomarin. Një plak i çuditshëm. Unë ngrita trastën time dhe i arrita ata.

— Sahati i mbarë! — tha plaku para se të arrija unë ta përshëndetja. — Ku po shkon, o djalosh?

Unë mblodha supet:

— Nuk e di... po shkoj...

— Ti nuk ke shtëpi?

— Jo.

— Nënë?... Baba?...

— Jo... jo... jo...

— Po çfarë ke ti?

— Asgjë...

— Oj!... Po kush të ushqen me bukë?

— Ja kush. — i them unë, duke zgjatur duart e dobëta.

— Ah...

Sikur ai të mundte të më ndihmonte! Por kishte vetëm një gomar, për të cilin kujdesej si të ishte një fëmijë.

Unë vështrova samarin bosh dhe mendova: «Pse ia ka vënë samarin gomarit plaku, gjersa as e ngarkon, as qepet në të vetë?»

— Pse ia ke vënë samarin, o gjysh?

— Ha! Po ti pse mban xhaketë?

— Që të mos ftohem.

— Ha-ha-! Ja dhe ai njëlloj... Ai është plak...

Gomari më vështroi disi shtrembër, i fyer dhe vazhdoi rrugën e vet. Plaku diçka i pëshpëriti në vesh, siç dukej, duke u mburrur, dhe gomari eci krenar. Unë vështroja i brengosur plakun, si të ishte shpresa e fundit.

— Gjysh... Mos di gjë ti ku ka punë për fëmijë?

Ai më vështroi me ëmbëlsi.

— Jo, — u përgjigj i ngrysur, — nuk e di...

Ne ecnim mengadalë, pa u ngutur. Të tre së bashku në rresht — rruga ishte mjaft e gjerë.

Gomari nuk kishte mbi samar as edhe një qi-me. I zoti e përkëdhelte dhe kujdesej për të si një nënë e mirë.

— Ty, mos të quajnë gjë Jovanis?

— Jo, Zllatan. Pse, si është puna?

— Asgjë... Kam pasur një mik të mirë, ai i donte shumë gomarët. Jovanis Cepkenxhiu! Tani ai është i papunë... Ka shkuar diku. Dhe Kristaqi, i fejuari.

Të gjithë shkuan.

Plaku qesh duke përpëlitur sytë me dinakëri.

— Ah, ti... Ah, ti, gënjeshtar, ti, aty pak më parë më the që nuk ke miq?

— Kam pasur të tillë. Po nuk do t'i shoh më. Ja, tani ka kaluar një javë që jemi ndarë; eh, ta dish ti si jemi ndarë! Po kjo është një gjë e mirë, që nuk do të mund të shihemi me ta... Pse? As vetë nuk e di pse... Nuk bën....

— Oj-oj-oj....

— Si është puna, o gjysh?



-- Oj-oj-oj. Ti, o djalë, ose je një njeri i madh, ose je një budalla i tëri, që s'e ke shokun. Hajde, shkojme të të shpie te miku yt, Kristaqi!

— Jo, nuk do vij.

— Oj-oj-oj...

Ne mbërritëm në Vlladovo. Prej aty zinte fill pjerrësia, që të çonte shumë thellë përpara. Në kupolën e kishës shkëlqente fytyra e diellit. Ishin rrezet që kishin kaluar përmes reve dhe kishin flakëruar floririn mbi kupolën e kishës.

— O gjysh, pa shiko andej nga kisha, akoma është verë, apo më bëjnë sytë?

Plaku vuri dorën si strehë mbi sy.

— Verë, verë....

Ne të dy e përqendruam vështrimin nga qielli. Atje akoma ishte verë. Vera i preku pakëz edhe zemrat tona. Bile edhe gomari i ngriti dy herë lart veshët.

Ne po zbritnim nga kodra. Përpara printe gomari, pas tij ne dhe pas nesh dielli. Kisha, me një copë verë në kupolë, mbeti pas malit. Në sfondin e pyllit të dendur po shkëlqente, si të ishte qumësht buallice i porsamjelë, ujëvara e Vlladovos. Ah, sa e bukur që është bota!... Por jo për fëmijët...

Ne u gjendëm në udhëkryq.

— Çk-çk. — e ndalon gomarin plaku.

Gomari vështron përreth, i bindet të zotit dhe ndalon. Thua se ka kohë që janë marrë vesh për këtë punë.

— Hajde, djalosh, — më fton plaku. — Unë do të shkoj në shtëpi, do që të vemi bashkë?

— Jo.

Gomari bëri djabatas.

— E ku do të shkosh?

— Unë... do të eci.

Ata bënë djathtas, ujqvarës. Gomari dhe Zani, të dy miqtë e mi të rrugës, u drejtuan për shtëpi. Të dy pleq. Ata kishin botën e tyre, hallat e tyre të pleqërisë, shprehitë e tyre. Të zënë dorë për dorë, ata po shkonin drejt varrit... Po unë? Çfarë të bëhet me mua? Lamtumirë, o pleq... Unë do të vij po u sëmura.

— Po, atëherë do të vij. Do të vij...

Unë u largova. Humba fare midis pemëve të rrugës. Ecja duke kërcitur këmbët mbi fletët e rrëzuara të pemëve. Mbeta i vetëm si dallëndyshja, që nuk kishte arritur të fluturonte së bashku me motrat e saj dhe të cilën e kishte zënë dimri. Edhe pak dhe do të sundonte nata. Unë dridhesha, si të isha qullur në mes të shiut. Dridhesha dhe ecja përpara...

— E ku do  
— Unë... do të  
Ata bënë djathu  
tani, të dy miqtë e n  
shtëpi. Të dy pleq. A  
e tyre të pleqërisë,  
për dore, ata po shk  
të bëhet me mua?  
vij po u sëmura.  
— Po, atëherë  
Unë u largova  
rrugës. Ecja duke k  
zuara të pemëve. M  
nuk kishte arritur të  
trat e saj dhe të cilër  
dhe do të sundonte r  
qullur në mes të shiu

**Menelaos Ludemis**  
është një ndër shkrimtarët e  
shqiptarë që ka shkruar tonë.  
Vepra e parë e tij është  
përmbledhja me regjime "Aniël  
nuk kanë zbritur". Në vitet e  
luftës antifashiste Ludemis  
shkroi mjaft vjersha e këngë,  
që u bënë himne të popullit  
greq. Përës së tij i përkasin  
edhe vëllimet, "Këngë për  
lininë", "Vezullimi i mëngjesit",  
"Ata që sollën veprat më të  
Një ndër veprat më të  
mira të Ludemisit është  
pikërisht "Retë dëndësohen",  
që vlerësohet si roman  
autobiografik. Në të trajtohet  
me mjeshtri tabloja realiste e  
viteve '40, atë e përbashkët për  
popujt ballkanik.